



REPubLIKA E SHQIPERISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR VLORË

Nr.Rregj.Them 706
Data e regjistrimit 24.07.2017

Nr.Vendimi 151
Data 27.03.2018

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR VLORË E PËRBËRË PREJ
GJYQTAR ALBERT SPIRO KRYESUES
GJYQTAR LAURENT FUÇIA ANETAR
GJYQTAR ARBANA SELMANAJ ANETAR

Asistuar nga sekretaria Xhuljeta Dinaj , më datë 27.03.2018 përfundoi në seancë gjyqesore çështjen penale me Nr.Rregjistri 706 që u përket :

KËRKUES Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë
Përfaqësuar nga prokurori Albert Kuliçi

OBJEKTI Gjykimi i procedimit penal Nr.169 viti 2017

TË PANDEHUR 1.Raimond Mëzi,i biri i Jakupit dhe Zybës,i datelindjes 25.03.1962,lindur në Durrës dhe banues në Vlorë, lagjia "15 tetori", me arsim 4 klasë,i martuar,i padënuar,hetuar dhe gjykuar me masë sigurimi "Arrest në shtëpi".

Gjykimi është zhvilluar pa pjesëmarrjen e të pandehurit
Mbrojtur nga av. zgjedhur Klarent Demiri
Në mungesë në shpalljen e vendimit.

AKUZUAR Se ka kryer veprat penale "Fallsifikimi i dokumentave" kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" që ka sjellë pasoja të rënda dhe në bashkëpunim parashikuar nga nenet 186/2 dhe 287/3 e 25 të Kodit Penal.

2.Lefter Gjergji,i biri i Theotaqit dhe Marias,i datelindjes 09.12.1958,lindur dhe banues në Himarë,Vlorë, me arsim të mesëm, i martuar,i padënuar,hetuar dhe gjykuar me mase sigurimi "Arrest në shtëpi".

Mbrojtur nga av. zgjedhur Alpin Aga

AKUZUAR

Se ka kryer veprat penale "Fallsifikimi i dokumentave" kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" që ka sjellë pasoja të rënda dhe në bashkëpunim parashikuar nga nenet 186/2 dhe 287/3 e 25 të Kodit Penal.

3.Enkes Hysendhima,i biri i Hysniut dhe Mbaresës,i datelindjes 21.01.1981,lindur dhe banues në Orikum,Vlorë, me arsim të lartë,beqar,i padënuar,hetuar dhe gjykuar me masë sigurimi "Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore".

Mbrojtur nga av. zgjedhur Arjan Isufi.

AKUZUAR

Se ka kryer veprat penale "Fallsifikimi i dokumentave" kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" që ka sjellë pasoja të rënda dhe në bashkëpunim parashikuar nga nenet 186/2 dhe 287/3 e 25 të Kodit Penal.

4.Blerina Dhrami (Brahimi),e bija e Besnikut dhe Vojsavës ,e datelindjes 19.05.1985 ,lindur dhe banues në Vlorë, lagjia "Bashkimi",rruga "Osman Haxhiu",pallati 1258 ,me arsim të lartë,e martuar,e dënuar,hetuar dhe gjykuar me mase sigurimi "Arrest në burg",në mungesë.

Në mungesë

Mbrojtur nga av. zgjedhur Edmond Dëma

AKUZUAR

Se ka kryer veprat penale "Fallsifikimi i dokumentave" kryer në bashkëpunim dhe nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin dhe "Shpërdorimi i detyrës"parashikuar nga nenet 186/3 dhe 248 të Kodit Penal.

5.Donika Besimaj,e bija e Syrjait dhe Tushes,e datelindjes 15.11.1960 ,lindur dhe banues në Vlorë, lagjia "15 tetori",rruga "Martin Camaj",,me arsim të mesëm,e martuar,e padënuar, hetuar dhe gjykuar me masë sigurimi "Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore" dhe "Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik".

Gjykimi është zhvilluar pa pjesëmarrjen e të pandehurës


Mbrojtur nga av. zgjedhur Edmond Dëma

AKUZUAR


Se ka kryer veprat penale "Fallsifikimi i dokumentave" kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë dhe "Shpërdorimi i detyrës"parashikuar nga nenet 186/2 dhe 248 të Kodit Penal.

Në përfundim pjesëmarrsit ne gjykim kërkuan:
Prokurori:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Raimond Mëzi**, për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të kryer më shumë se një herë, përmes përdorimit të dokumentit të falsifikuar dhe në bashkëpunim, parashikuar si vepër penale nga neni 186/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 4 (katër) vite burgim.
2. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Raimond Mëzi**, për kryerjen e veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, që ka sjellë pasoja të rënda dhe të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 287/3 dhe 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 18 (tetëmbëdhjetë) vite burgim.
3. Në aplikim të nenit 55 të K.Penal në bashkim të dënimeve, dënimin përfundimtar të pandehurit **Raimond Mëzi** me 21 (njëzet e një) vite burgim.
4. Gjykata në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, të ulë një të tretën e masës së dënimit të dhënë.
5. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Lefter Gjergji**, për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të kryer më shumë se një herë, përmes përdorimit të dokumentit të falsifikuar dhe në bashkëpunim, parashikuar si vepër penale nga neni 186/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 4 (katër) vite burgim.
6. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Lefter Gjergji**, për kryerjen e veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, që ka sjellë pasoja të rënda dhe të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 287/3 dhe 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 16 (gjashtëmbëdhjetë) vite burgim.
7. Në aplikim të nenit 55 të K.Penal në bashkim të dënimeve, dënimin përfundimtar të pandehurit **Lefter Gjergji** me 19 (nëntëmbëdhjetë) vite burgim.
8. Gjykata në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, të ulë një të tretën e masës së dënimit të dhënë.
9. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Enkes Hysendhima**, për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të kryer më shumë se një herë, përmes përdorimit të dokumentit të falsifikuar dhe në bashkëpunim, parashikuar si vepër penale nga neni 186/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 4 (katër) vite burgim.
10. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Enkes Hysendhima**, për kryerjen e veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, që ka sjellë pasoja të rënda dhe të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 287/3 dhe 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 20 (njëzet) vite burgim.
11. Në aplikim të nenit 55 të K.Penal në bashkim të dënimeve, dënimin përfundimtar të pandehurit **Enkes Hysendhima** me 24 (njëzet e katër) vite burgim.
12. Gjykata në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, të ulë një të tretën e masës së dënimit të dhënë.
13. Në aplikim të nenit 39 të K.Penal, të pandehurit **Enkes Hysendhima** t’i hiqet e drejta për të ushtruar profesionin e avokatit për një kohë prej 5 (pesë) vitesh.
14. Deklarimin fajtor të të pandehurës **Blerina Dhrami (Brahimi)**, për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të kryer më shumë se një herë, përmes përdorimit të dokumentit të falsifikuar, parashikuar si vepër penale nga neni 186/3 i Kodit Penal dhe dënimin e saj me 4 (katër) vite burgim.



15. Deklarimin fajtor të të pandehurës **Blerina Dhrami (Brahimi)**, për kryerjen e veprës penale "Shpërdorimi i detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe dënimin e sajë me 7 (shtatë) vite burgim.
16. Në aplikim të nenit 55 të K.Penal në bashkim të dënimeve, dënimin përfundimtar të pandehurës **Blerina Dhrami (Brahimi)**, me 11 (njëmbëdhjetë) vite burgim.
17. Gjykata në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, të ulë një të tretën e masës së dënimit të dhënë.
18. Në aplikim të nenit 35 të K.Penal, të pandehurës **Blerina Dhrami (Brahimi)**, t'i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej 5 (pesë) vitesh.
19. Deklarimin fajtor të të pandehurës **Donika Besimaj**, për kryerjen e veprës penale "Falsifikimi i dokumenteve", të kryer më shumë se një herë, përmes përdorimit të dokumentit të falsifikuar, parashikuar si vepër penale nga neni 186/2 i Kodit Penal dhe dënimin e saj me 3 (tre) vite burgim.
20. Deklarimin fajtor të të pandehurës **Donika Besimaj**, për kryerjen e veprës penale "Shpërdorimi i detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe dënimin e sajë me 4 (katër) vite burgim.
21. Në aplikim të nenit 55 të K.Penal në bashkim të dënimeve, dënimin përfundimtar të pandehurës **Donika Besimaj**, me 6 (gjashtë) vite burgim.
22. Gjykata në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, të ulë një të tretën e masës së dënimit të dhënë.
23. Në aplikim të nenit 35 të K.Penal, të pandehurës **Donika Besimaj**, t'i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej 5 (pesë) vitesh.
24. Në aplikim të neneve 190/1 dhe 391 të K.Pr.Penale, të deklarohet falsiteti i dokumenteve që i janë bashkuar fashikullit të gjykimin dhe të disponohet në lidhje me to, e konkretisht në lidhje me këto dokumente:
 - Të gjitha aktet e dosjes gjyqësore civile që i përkasin vendimit nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, bashkë me vendimin, të cilat të asgjësohen.
 - Vendimi gjyqësor civil nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i cili të asgjësohet.
 - Të dhënat e pasqyruara në Regjistrin themeltar civil të vitit 2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në lidhje me vendimin nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Pas kryerjes së këtij veprimi, Regjistri themeltar civil i vitit 2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të kthehet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.
 - Të dhënat e pasqyruara në numratorin e vendimeve civile të viteve 1999-2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në lidhje me vendimin nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Pas kryerjes së këtij veprimi, Numratori i vendimeve civile të viteve 1999-2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të kthehet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.
 - Të dhënat e pasqyruara në Indeks in e vendimeve gjyqësore civile të viteve 1999-2000-2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në lidhje me vendimin nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Pas kryerjes së këtij veprimi



- Indeksi i vendimeve gjyqësore civile të viteve 1999-2000-2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të kthehet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.
- Të gjitha aktet e dosjes gjyqësore civile që i përkasin vendimit nr. 2217, datë 29/12/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, bashkë me vendimin, të cilat të asgjësohen.
 - Të dhënat e pasqyruara në Regjistrin themeltar civil të vitit 2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në lidhje me vendimin nr. 2217, datë 29/12/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Pas kryerjes së këtij veprimi, Regjistri themeltar civil i vitit 2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të kthehet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.
 - Të dhënat e pasqyruara në Regjistërin themeltar civil të vitit 2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në lidhje me vendimin nr. 2217, datë 29/12/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Pas kryerjes së këtij, veprimi Regjistri themeltar civil i vitit 2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të kthehet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.
 - Të dhënat e pasqyruara në Numratorin civil të vitit 2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në lidhje me vendimin nr. 2217, datë 29/12/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Pas kryerjes së këtij veprimi, Numratori civil i vitit 2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të kthehet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.
 - Të dhënat e pasqyruara në Volumin e vendimeve të vitit 2003 që fillon nga vendimi nr. 1500, datë 23/09/2003 deri në vendimin nr. 1600, datë 07/10/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në lidhje me vendimin nr. 1568, datë 02/10//2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Pas kryerjes së këtij veprimi, Volumi i vendimeve të vitit 2003 që fillon nga vendimi nr. 1500, datë 23/09/2003 deri në vendimin nr. 1600, datë 07/10/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të kthehet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.
 - Të gjitha aktet e dosjes gjyqësore civile që i përkasin vendimit nr. 1568, datë 02/10//2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, bashkë me vendimin, të cilat të asgjësohen.
 - Të gjitha aktet dhe praktikën në lidhje me dhënien e vendimit nr. 168, datë 14/06/2006 të KVKKPronave Qarku Vlorë në emër të subjektit Theotoq Gjergji, të cilat të asgjësohen.
 - Të dhënat e pasqyruara në regjistrat publik pranë ZVRPP Vlorë, mbi bazën e vendimit nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
 - Të dhënat e pasqyruara në regjistrat publik pranë ZVRPP Vlorë, mbi bazën e vendimit gjyqësor nr. 2217, datë 29/12/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
 - Të dhënat e pasqyruara në regjistrat publik pranë ZVRPP Vlorë, mbi bazën e vendimit gjyqësor nr. 1568, datë 02/10//2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
25. Në bazë të nenit 36/b të Kodit Penal, të konsfiskohen dhe të kalojnë në favor të shtetit dhe të fshihen nga regjistri i ZVRPP Vlorë, produktet e veprës penale të "Falsifikimit të dokumenteve", të cilat janë nën masën e sigurimit të sekuestros preventive me vendimin nr.257, datë 30/01/2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, e konkretisht të:

- I- Pasurisë së paluajtshme prej 220 (dyqind e njëzet) Ha, të regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 421, datë 12/10/2012, ZK 1568, në emër të shtetasit Rajmond Mezi, me përshkrimin “Një sipërfaqe kullotë prej 220 ha, në vendin Karaburun sipas kufinjëve”, me kufij V-Deti; J-Qafa e Gjeshtës; P-Përroi i Dhimë Kushtës dhe L-Udha, si dhe të të gjitha pasurive të paluajtshme të ndara dhe derivuara nga kjo pasuri e mësipërme dhe të cilat janë regjistruar në regjistrin hipotekor pranë ZVRPP Vlorë, e konkretisht të pasurive të mëposhtme:
- a) Të pasurisë së paluajtshme 90 (nëntëdhjetë) Ha, të regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 350, datë 02/10/2014, ZK 1568, në emër të shtetasit Rajmond Mezi, me përshkrimin “Një sipërfaqe kullotë prej 90 ha, në vendin Karaburun të Vlorës”, me kufij V-Deti; J-Qafa e Gjeshtës; P- i zoti dhe L-Udha.
 - b) Të pasurisë së paluajtshme 130 (njëqind e tridhjetë) Ha, të regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 351, datë 02/10/2014, ZK 1568, në emër të shtetasit Rajmond Mezi, me përshkrimin “Një sipërfaqe kullotë prej 130 ha, në vendin Karaburun të Vlorës”, me kufij V-Deti; J-Qafa e Gjeshtës; P-përroi i Dh. Kushtës dhe L- i zoti.
 - c) Të pasurisë së paluajtshme 90 (nëntëdhjetë) Ha, të regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 362, datë 13/10/2014, ZK 1568, në emër të subjekteve “House of Arts” sh.p.k dhe “Digitalnetëorks” sh.p.k, me përshkrimin “Një sipërfaqe kullotë prej 90 ha, Karaburun-Vlorë”, me kufij V-Deti; J-Qafa e Gjeshtës; P- i zoti dhe L-Udha.
 - d) Të pasurisë së paluajtshme 130 (njëqind e tridhjetë) Ha, të regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 609, datë 15/12/2014, ZK 1568, në emër të shtetasit Artur Shehu, me përshkrimin “Një sipërfaqe kullotë prej 130 ha, në vendin Karaburun-Vlorë”, me kufij V-Deti; J-Qafa e Gjeshtës; P-përroi i Dh. Kushtës dhe L- i zoti.
 - e) Të pasurisë së paluajtshme 50.000 (pesëdhjetëmijë) metër katrorë, të regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 256, datë 23/03/2015, ZK 1568, në emër të shtetasit Artur Shehu, me përshkrimin “Një sipërfaqe toke kullotë prej 50.000 (pesëdhjetëmijë) metër katrorë, Karaburun-Vlorë”.
 - f) Të pasurisë së paluajtshme 50.000 (pesëdhjetëmijë) metër katrorë, të regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 260 të vitit 2015, ZK 1568, në emër të shtetasit Arjan Laci me përshkrimin “Një sipërfaqe toke kullotë prej 50.000 (pesëdhjetëmijë) metër katrorë, Karaburun-Vlorë”.
 - g) Të pasurisë së paluajtshme 125 (njëqind e njëzet e pesë) Ha, të regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 257, datë 23/03/2015, ZK 1568, në emër të shtetasit Artur Shehu, me përshkrimin “Një sipërfaqe toke kullotë prej 125 ha, Karaburun-Vlorë”
 - h) Të pasurisë së paluajtshme 10 (dhjetë) Ha, të regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 497, datë 01/10/2015, ZK 1568, në emër të shtetasit Artur Shehu, me përshkrimin “Një sipërfaqe toke kullotë prej 10 ha, Pika A, Karaburun-Vlorë”.
 - i) Të pasurisë së paluajtshme 10 (dhjetë) Ha, të regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 498, datë 01/10/2015, ZK 1568, në emër të shtetasit Artur Shehu, me përshkrimin “Një sipërfaqe toke kullotë prej 10 ha, Pika B, Karaburun-Vlorë”.
 - j) Të pasurisë së paluajtshme 10 (dhjetë) Ha, të regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 7, datë 14/01/2016, ZK 1568, në emër të shtetasit Thodhori Gjikhuri, me përshkrimin “Një sipërfaqe toke kullotë prej 10 ha, Karaburun Vlorë”.

- k) Të pasurisë së paluajtshme 10 (dhjetë) Ha, të regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 8, datë 14/01/2016, ZK 1568, në emër të shtetasit Thodhori Gjikhuri, me përshkrimin “Një sipërfaqe toke kullotë prej 10 ha, Karaburun Vlorë”.
- II. Pasurinë e paluajtshme prej 89 (tetëdhjetë e nëntë) Ha, të regjistruar në regjistrat publike të ZVRPP Vlorë, mbi bazën e vendimit gjyqësor të falsifikuar nr. 2217, datë 29/12/2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, si dhe të të gjitha pasurive të tjera të paluajtshme të regjistruara pranë ZVRPP Vlorë që rrjedhin prej pasurisë prej 89 Ha, që mund të kenë kaluar në emër të personave të tretë, një pjesë të të cilave janë evidentuar si më poshtë:
- a) Në kartelën e pasurisë me numër 41/63, vol. 15, faqe 69, ZK 8604, me sipërfaqe 13593,4 metër katrorë, e llojit pyll.
 - b) Në kartelën e pasurisë me numër 47/45/1, vol. 15, faqe 48, ZK 8604, me sipërfaqe 141725 metër katrorë, e llojit pyll, pasuri e cila vijon në volumnin 47, faqe 13 deri 15.
 - c) Në kartelën e pasurisë me numër 41/95, vol. 15, faqe 25, ZK 8604, me sipërfaqe 1314, 2 metër katrorë, e llojit pyll, pasuri e cila është tjetërsuar tek shtetasi Artur Shehu.
 - d) Në kartelën e pasurisë me numër 41/108/2, vol. 15, faqe 23, ZK 8604, me sipërfaqe 74364, 9 metër katrorë, e llojit pyll, pasuri e cila është tjetërsuar tek shtetasi Artur Shehu.
 - e) Në kartelën e pasurisë me numër 41/105, vol. 15, faqe 20, ZK 8604, me sipërfaqe 87766,6 metër katrorë, e llojit pyll, pasuri e cila është tjetërsuar tek shtetasi Artur Shehu.
 - f) Në kartelën e pasurisë me numër 41/104, vol. 15, faqe 19, ZK 8604, me sipërfaqe 29971,3 metër katrorë, e llojit pyll, pasuri e cila është tjetërsuar tek shtetasi Artur Shehu.
 - g) Në kartelën e pasurisë me numër 41/101, vol. 15, faqe 16, ZK 8604, me sipërfaqe 8292 metër katrorë, e llojit pyll, pasuri e cila është tjetërsuar tek shtetasi Artur Shehu.
 - h) Në kartelën e pasurisë me numër 47/47, vol. 15, faqe 10, ZK 8604, me sipërfaqe 34225,4 metër katrorë, e llojit pyll, pasuri e cila është tjetërsuar tek shtetasi Artur Shehu.
 - i) Në kartelën e pasurisë me numër 47/46, vol. 15, faqe 9, ZK 8604, me sipërfaqe 76662,1 metër katrorë, e llojit pyll, pasuri e cila është tjetërsuar tek shtetasi Artur Shehu.
 - j) Në kartelën e pasurisë me numër 41/108/1, vol. 15, faqe 8, ZK 8604, me sipërfaqe 54293,1 metër katrorë, e llojit pyll, pasuri e cila është tjetërsuar tek shtetasi Artur Shehu.
 - k) Në kartelën e pasurisë me numër 47/45/2, vol. 15, faqe 188, ZK 8604, me sipërfaqe 166188 metër katrorë, e llojit pyll, pasuri e cila vijon në volumnin 47, faqe 12 deri në faqen 14.
 - l) Në kartelën e pasurisë me numër 47/41/1, vol. 31, faqe 231, ZK 8604, me sipërfaqe 120164.3 metër katrorë, e llojit pyll, pasuri e cila është tjetërsuar tek shtetasi Gerian Kuka.
 - m) Në çdo regjistër/kartelë tjetër pasurie të paluajtshme të ZVRPP Vlorë, që evidentohen pasuritë që rrjedhin/derivojnë (drejtpërdrejt apo në menyrë të njëpasnjeshme) prej

pasurisë prej 89 Ha, me origjinë vendimin gjyqësor të falsifikuar nr. 2217, datë 29/12/2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

III. Pasuritë e paluajtshme të llojit “kullotë” me sipërfaqe totale prej 33 (tridhjetetë) hektarë, ndodhur në zonën kadastrale nr. 2863, në vendin e quajtur “Dhrale – Adhendra”, në fshatin Palase, Himarë, të regjistruara ne nenin 84, dt. 23.03.2012, të regjistrit hipotekor të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Paluajtshme Vlorë, me titull pronësie “Vendimin nr. 168, datë 14.06.2006, të Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Qarkut Vlorë”, si dhe të gjitha pasuritë që rrjedhin/derivojnë prej kësaj pasurie dhe që janë regjistruara në regjistrat hipotekor të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Paluajtshme Vlorë me të dhënat si mëposhtë:

- a) Pasuria e regjistruar ne nenin 84, dt. 23.03.2012, me sipërfaqe 33 hektarë¹.
- b) Pasuria e regjistruar në nenin 85, datë 03.04.2012, me sipërfaqe 33 hektarë.
- c) Pasuria e regjistruar ne nenin 193, datë 11.06.2012, me sipërfaqe 7.5 hektarë. Pasuria e regjistruar ne nenin 194, datë 11.06.2012, me sipërfaqe 7.5 hektare.
- d) Pasuria e regjistruar ne nenin 195, datë 11.06.2012, me sipërfaqe 2.5 hektarë.
- e) Pasuria e regjistruar ne nenin 196, datë 11.06.2012, me sipërfaqe 2.5 hektarë.
- f) Pasuria e regjistruar ne nenin 197, datë 11.06.2012, me sipërfaqe 13 hektare.
- g) Pasuria e regjistruar në nenin 350, datë 16.08.2015, me sipërfaqe 7.5 hektarë.
- h) Pasuria e regjistruar ne nenin 65, datë 01.03.2013, me sipërfaqe 5,000 m².
- i) Pasuria e regjistruar në nenin 714, dt. 14.08.2013, me sipërfaqe 5,000 m².
- j) Pasuria e regjistruar ne nenin 66, datë 01.03.2013, me sipërfaqe 70,000 m².
- k) Pasuria e regjistruar në nene 292, dt. 04.05.2015, me sipërfaqe 65,000 m².
- l) Pasuria e regjistruar ne nenin 293, dt. 04.05.2015, me sip. 5,000 m².
- m) Pasuria e regjistruar me nenin 20, dt. 03.07.2015 (Inskript).
- n) Pasuria e regjistruar me nenin 399, dt. 30.07.2015, me sipërfaqe 5,000 m².
- o) Pasuria e regjistruar në nenin 2, dt. 10.03.2016 (Inskript).
- p) Pasuria e regjistruar ne nenin 349, datë 16.08.2012, me sipërfaqe 2.5 hektarë.
- q) Pasuria e regjistruar ne nenin 706, datë 02.08.2013, me sipërfaqe 2 hektarë.
- r) Pasuria e regjistruar në nenin 14, dt. 08.06.2015 (Inskript).
- s) Pasuria e regjistruar ne nenin 707, datë 02.08.2013, me sipërfaqe 5000 m².
- t) Pasuria e regjistruar në nenin 767, dt. 03.09.2013, me sipërfaqe 5000 m².
- u) Pasuria e regjistruar në nenin 1112, dt. 17.12.2013, me sipërfaqe 2,500 m².
- v) Pasuria e regjistruar në nenin 1113, dt. 17.12.2013, me sipërfaqe 2,500 m².
- w) Pasuria e regjistruar në nenin 1115, dt. 17.12.2013, me sipërfaqe 2,500 m².
- x) Pasuria e regjistruar në nenin 380 dt. 18.11.2014, me sipërfaqe 2,500 m².
- y) Pasuria e regjistruar në nenin 40, dt. 03.02.2015, me sipërfaqe 5000 m².
- z) Pasuria e regjistruar në nenin 72, dt. 23.02.2015, me sipërfaqe 5000 m².
- aa) Pasuria e regjistruar në nenin 41, dt. 03.02.2015, me sipërfaqe 5000 m².
- bb) Pasuria e regjistruar në nenin 58, dt.17.02.2015, me sipërfaqe 5000 m².
- cc) Pasuria e regjistruar ne nenin 42, datë 03.02.2015, me sipërfaqe 12 hektarë².
- dd) Pasuria e regjistruar në nenin 320, dt. 01.06.2015, me sip. 15,000 m².

¹ Nga kjo pasuri derivojnë pasuritë e mëposhtëme.



- ee) Pasuria e regjistruar në nenin 321, dt. 01.06.2015 me sip. 10.5 hektarë.
- ff) Pasuria e regjistruar në nenin 15, dt. 08.06.2015 (Inskript).
- gg) Pasuria e regjistruar në nenin 347, dt. 08.06.2015, me sipërfaqe 15,000 m².
26. Në aplikim të nenit 190 dhe 224 të K.Pr.Penale, regjistrimet e kryera për numrin telefonik 067 20 60 444; numrin telefonik 069 58 64 034, numrin teleofnik 069 64 60 624, numrin telefonik 067 20 66 666, numrin telefonik 069 75 75 975, numrin telefonik 069 68 23 125, numrin telefonik 069 86 82 975 dhe numrin telefonik 069 96 63 394, të vendosur në përgjim me vendimin nr. 70 datë 24/05/2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të asgjësohen, pasi vendimi të marrë formë të prerë.
27. Në aplikim të nenit 190 dhe 224 të K.Pr.Penale, regjistrimet e kryera për numrin telefonik 069 47 58 570, të vendosur në përgjim me vendimin nr. 54 datë 29/04/2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të asgjësohen, pasi vendimi të marrë formë të prerë.
28. Në aplikim të nenit 190 dhe 224 të K.Pr.Penale, regjistrimet e kryera për numrin telefonik 069 26 83 730, të vendosur në përgjim me vendimin nr. 56 datë 05/05/2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të asgjësohen, pasi vendimi të marrë formë të prerë.
29. Në aplikim të nenit 190 dhe 224 të K.Pr.Penale, regjistrimet e kryera për numrin telefonik 069 26 83 730, të vendosur në përgjim me vendimin nr. 66 datë 19/05/2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të asgjësohen, pasi vendimi të marrë formë të prerë.
30. Në aplikim të nenit 190 dhe 224 të K.Pr.Penale, regjistrimet e kryera për numrin telefonik 069 91 07 123 dhe për numrin telefonik 069 53 39 365, të vendosur në përgjim me vendimin nr. 59 datë 11/05/2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të asgjësohen, pasi vendimi të marrë formë të prerë.
31. Në aplikim të nenit 190 dhe 224 të K.Pr.Penale, regjistrimet e kryera për numrin telefonik 069 48 77 305, të vendosur në përgjim me vendimin nr. 61 datë 12/05/2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të asgjësohen, pasi vendimi të marrë formë të prerë.
32. Shpenzimet proceduriale të kryera gjatë hetimit paraprak në shumën prej 360.000 (treqind e gjashtëdhjetë mijë) Lekë, si dhe ato të kryera gjatë gjykimit, t'u ngarkohen të pandehurve në mënyrë solidare.

-Av. mbrojtës i të pandehurit **Raimond Mëzi** :

1-Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit për veprat penale për të cilat akuzohet në bazë të nenit 388 pika "b" e K.Pr.Penale.

2-Nese gjykata e deklaron fajtor dënimin në minimumin që parashikon neni 186/2 i Kodit Penal dhe neni 287/1 i Kodit Penal dhe pezullimin e ekzekutimit të dënimit.

-Av. mbrojtës i të pandehurit **Lefter Gjergji**:

1 -Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit për veprat penale për të cilat akuzohet në bazë të nenit 388 pika "b" e K.Pr.Penale.

2-Nese gjykata e deklaron fajtor dënimin në minimumin që parashikon neni 186/2 i Kodit Penal dhe neni 287/1 i Kodit Penal dhe pezullimin e ekzekutimit të dënimit.

I pandehur **Lefter Gjergji-Jam** i pafajshëm.

Av. mbrojtës i të pandehurit **Enkes Hysendhima**:

Bazuar në nenin 388/1 germa "b" të K.Pr.Penale, kërkojmë prej Gjyqesës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, që të deklarojë të pafajshëm të pandehurin Enkes Hysendhima, për kryerjen e veprave penale të "Falsifikimi i dokumentave", dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale", e kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 186/2 dhe 287/2 i K.Penal, pasi fakti i kontestuar këtij shtetasi nuk përbën veprë penale.

I pandehuri **Enkes Hysendhima-Jam** i pafajshëm. Jam dakord me avokatin.

Avokati mbrojtës i të pandehurës **Blerina Dhrami** :

-Deklarimin e pafajshëm të të pandehurës për veprat penale për të cilat akuzohet në bazë të nenit 388/1 pika "b" e K.Pr.Penale pasi fakti nuk përbën veprë penale.

Avokati mbrojtës i të pandehurës **Donika Besimaj** :

-Deklarimin e pafajshëm të të pandehurës për veprat penale për të cilat akuzohet në bazë të nenit 388/1 pika "b" e K.Pr.Penale pasi fakti nuk përbën veprë penale.

Gjykata pasi u njoh me kërkesën për gjykim, provat bashkëgjitur fashikullit të procedimit penal, dëgjoi kërkimet përfundimtare të pjesëmarrësve në gjykim dhe e shqyrtoi çështjen në tërësi

VËREN

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka paraqitur kërkesën për gjykimin e procedimit penal Nr.169 të vitit 2017 në ngarkim të të pandehurve Raimond Mëzi, Lefter Gjergji, Enkes Hysendhima, të akuzuar se kanë kryer veprat penale "Falsifikimi i dokumentave" kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" që ka sjellë pasoja të rënda dhe në bashkëpunim parashikuar nga nenet 186/2 dhe 287/3 e 25 të Kodit Penal, Blerina Dhrami (Brahimi) e akuzuar se veprat penale "Falsifikimi i dokumentave" kryer në bashkëpunim dhe nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin dhe "Shpërdorimi i detyrës" parashikuar nga nenet 186/3 dhe 248 të Kodit Penal dhe Donika Besimaj e akuzuar se veprat penale "Falsifikimi i dokumentave" kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë dhe "Shpërdorimi i detyrës" parashikuar nga nenet 186/2 dhe 248 të Kodit Penal

Rezulton se nëpërmjet shërbimit postar datë 04.10.2017 është paraqitur kërkesë padia (në procesin penal) me palë:

PADITËS

Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga Avokatura e Shtetit
Përfaqësuar në gjykim nga Sokol Kamberi

TË PADITUR

1. Raimond Mëzi
2. Lefter Gjergji.
3. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

Vlorë.

PERSON I TRETË

Bashkia Vlorë



- OBJEKTI**
1. Deklarimi i pavërtetësisë (fallsitetit) të dokumentave... .
 2. Detyrimin për njohje prionar dhe kthimin në favor të shtetit shqiptar... .

BAZA LIGJORE Nenet 5 gërma”ç” dhe 14 të ligjit Nr.10018 datë 13.11.2008
“Për avokaturën e shtetit”, nenet 61,62 të K.Pr.Penale, etj

Para fillimit të shqyrtimit gjyqësor nga ana e të pandehurve, nëpërmjet mbrojtësve të tyre u kërkua të procedohej me gjykim të shkurtuar në bazë të nenit 403 të K.Pr.Penale, kërkesë e cila u pranua nga Gjykata, pasi mori dhe mendimin e prokurorit, për shkak se plotësohen kërkesat e neneve 405/6 e vijues të K.Pr.Penale pasi nga palët nuk pati pretendime në lidhje me pavlefshmëri të akteve dhe papërdorshmëri të provave dhe nga gjykata nuk u konstatuan akte të pavlefshme apo prova të papërdorshme dhe çështja mund të zgjidhet me gjendjen që janë aktet në fashikullin e procedimit përkatës duke garantuar një proces të rregullt ligjor dhe pa u cënuar dhënia e drejtësisë.

Gjithashtu në lidhje me padinë civile si mbrojtësit dhe prokurori kërkuan veçimin e saj.

Me vendimin e datës 10.11.2017 Gjykata vendosi:

“Lënien pa shqyrtuar të padisë civile (në procesin penal).

Dërgimin e saj Seksionit Civil pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë”

Nga shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështje penale rezultoi e provuar se:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, mbi bazën e akteve të procedimit penal nr. 128 datë 30/06/2016, të dërguara për kompetencë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Tiranë, ka rregjistruar procedimin penal nr.169 datë 27/01/2017, për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve”, “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuara nga nenet 186, 248 dhe 287/3 të Kodit Penal.

Sipas organit të akuzës nga tërësia e veprimeve hetimore të kryera dhe provave të administruara në kuadër të këtij procedimi penal, ka rezultuar e provuar se janë përfituar tre pasuri të paluajtshme me sipërfaqe totale 342 Ha, mbi bazën e dokumenteve të falsifikuara, si dhe janë kryer veprime juridike mbi këto pasuri, me qëllim fshehjen e origjinës së paligjshme të tyre.

Episodi 1: Regjistrimi i pronës me dokumenta të falsifikuara prej 220 Ha, në vendin e quajtur Karaburun, Vlorë.

Gjatë hetimeve paraprake është provuar se i pandehuri Raimond Mëzi, në bashkëpunim me të pandehurit Enkes Hysendhima, Donika Besimaj dhe Blerina Dhrami (Brahimi), ka

përfitur, regjistruar dhe tjetërsuar një sipërfaqe prone prej 220 Ha, në vendin e quajtur Karaburun, Vlorë, me dokumente të falsifikuara.

Provohet se dokumentet e falsifikuara mbi bazën e të cilës është përfitur kjo pasuri është e gjithë dosja gjyqësore që i përket vendimit gjyqësor civil nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Nga hetimi është provuar se kjo dosje gjyqësore dhe aktet e ndodhura në të janë tërësisht të falsifikuara, si dhe janë futur në kundërshtim me ligjin në arkivën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Për të fshehur këtë veprimtari të kundërligjshme, rezulton se të dhënat e pasqyruara në këtë dosje gjyqësore janë pasqyruar edhe në tre regjistra që ndodheshin të administruara në arkivën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Konkretisht janë pasqyruar të dhënat e kësaj dosje në Regjistrin Civil Themeltar, në Numratorin Civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në Indeksin e Vendimeve Civile të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, regjistra që ndodheshin të arkivuara në mjedise të ndryshme të arkivës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Gjithashtu provohet se edhe dosja fizike që i përket vendimit gjyqësor civil nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është sistemuar dhe arkivuar në vendin përkatës ku ndodheshin dosjet gjyqësore që i përkisnin muajit dhjetor të vitit 2000.

Veprimtaria e mësipërme është kryer nga e pandehura Donika Besimaj, e cila ka pasur në posedim të gjithë regjistrat e mësipërm. Pasi është realizuar veprimtaria e mësipërme e kundërligjshme, e pandehura Donika Besimaj, u ka vënë në dispozicion kopje të njësuar të vendimit gjyqësor civil nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, si dhe të akteve të kësaj dosje, të pandehurve Enkes Hysendhima dhe Raimond Mëzi. Këta dy të fundit, në bashkëpunim me të pandehurën Blerina Dhrami (Brahimi), mbi bazën e dokumenteve të falsifikuara të vëna në dispozicion nga e pandehura Donika Besimaj, kanë regjistruar në regjistrat publik pranë ZVRPP Vlorë sipërfaqen e pronës prej 220 Ha, pronë e cila është pasqyruar sikur është kthyer përmes vendimit gjyqësor civil nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Pas regjistrimit të kësaj sipërfaqe prone, rezulton se të pandehurit Enkes Hysendhima dhe Raimond Mëzi, kanë kryer veprime juridike mbi këtë pasuri, si ndarje dhe tjetërsime, me qëllimin e vetëm fshehjen e origjinës së paligjshme të kësaj pasurie.

Nga hetimi i këtij procedimi penal ka rezultuar se, më datën 19/11/2012 është pasqyruar fakti sikur ka aplikuar pranë Z.V.R.P.P. Vlorë, shtetasi Nesti Bifsha për regjistrimin e vendimit gjyqësor civil nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Bazuar në aktin e aktin e ekspertimit grafik nr. 7891, datë 11.08.2016, rezulton se vendimi i mësipërm dhe dosja gjyqësore janë tërësisht të falsifikuar. Mbi bazën e aplikimit të mësipërm, rezulton se në regjistrin hipotekor nr. 421, datë 12/10/2012 është regjistruar pasuria "Një sipërfaqe kullotë prej 220 ha, në vendin Karaburun (sipas kufijve), në emër të shtetasit Raimond Mezi. Në kolonën përkatëse është pasqyruar fakti se kjo pasuri është regjistruar mbi bazën e vendimit gjyqësor civil nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Provohet se kjo pasuri është regjistruar mbi bazën e dokumenteve të falsifikuara nga të pandehurit Raimond Mëzi, Enkes Hysendhima dhe Blerina Dhrami (Brahimi), në bashkëpunim me njëri tjetrin. Nga sekuestrimi i kësaj praktike rezulton se janë paraqitur dokumentet e mëposhtme:

- Aplikimi i shtetasit Nesti Bifsha, ku rezulton se ky aplikim është pranuar nga specialisti Andi Mone. Rezulton se ky aplikim është administruar në fotokopje pranë ZVRPP Vlorë, por nga këqyrja e këtij aplikimi rezulton se ky aplikim bën fjalë për lëshimin e vërtetimit nga dokumentet hipotekor për pronën që ndodhet në Dhërmi. Nga këto të dhëna del qartë ky aplikim është futur më vonë nga e pandehura Blerina Dhrami (Brahimi), kopje e të cilit është marrë nga aplikimi origjinal i shtetasit Nesti Bifsha. Kjo e dhënë provohet edhe për faktin se aplikimi është bërë më datën 19/11/2012, ndërsa prona është regjistruar më datën 12/10/2012, pra para se të paraqitej aplikimi. Rezulton se këto fakte ka deklaruar edhe shtetasi Andi Mone i pyetur në cilësinë e deklaruesit.
- Vendimi nr. 1360, datë 29/12/2000 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me gjyqtarë Thoma Nika, i cili mban shënimin e punonjës së arkivës dhe Kancelares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, shënim i pasqyruar më datën 01/04/2015.
- Mandat-pagese datë 01/04/2015.
- Shkresa nr. 1266 prot, datë 11/09/2014 e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, drejtuar ZVRPP Vlorë.
- Shkresa nr. 7853 prot, datë 05/09/2014 e ZVRPP Vlorë, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
- Vendimi nr. 1360, datë 29/12/2000 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me gjyqtarë Thoma Nika, i cili mban shënimin e punonjës së arkivës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, shënim i pasqyruar më datën 17/04/2012.
- Kërkesë padi e paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë nga shtetasi Rajmond Mezi.
- Vendimi nr. 100, datë 19/04/1996 i KKKP Qarku Vlorë në favor të subjektit Jakup Mezi, bashkë me planimetrinë.
- Notë transkriptimi në favor të Jakup Haxhi Mezi me numër rradhori 9, vol.12, datë 15/01/1943.
- Akt-dëshmi trashëgimie datë 09/08/1994, përmes së cilit është lëshuar dëshmia e trëshëgimisë për Jakup dhe Zybe Mezi.
- Akt-gjykimi nr. 270, datë 09/11/1939, me paditës shtetasin Ramadan Halimi.
- Dokumente arkivore të nxjerra nga AQSH F. 404, V. 1934, D.74, fl. 3 dhe AQSH F. 404, V. 1932, D. 36, fl. 227

Mbi bazën e aplikimit të mësipërm, rezulton se në regjistrin hipotekor nr. 421, datë 12/10/2012 është regjistruar pasuria “Një sipërfaqe kullotë prej 220 ha, në vendin Karaburun sipas kufijve”, në emër të shtetasit Rajmond Mezi. Në kolonën përkatëse është pasqyruar fakti se kjo pasuri është regjistruar mbi bazën e vendimit gjyqësor civil nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Rezulton se pasuria e mësipërme është regjistruar mbi bazën e dokumenteve tërësisht të falsifikuara.

Nga ana e organit procedues është administruar pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave Tiranë, dosja nr. 905 e vitit 1994, që përmban vendimin nr. 100, datë 19/04/1996 të ish-KKKP-së Bashkia e Qytetit Vlorë, në emër të subjektit të shpronësuar Jakup Mezi. Nga studimi i vendimit nr. 100, datë 19/04/1996 të ish-KKKP-së Bashkia e Qytetit Vlorë, rezulton se është vendosur: “1. Të njohë si ish-pronarë të kësaj pronë z. Jakup Mezi (trashëgimtarët e tij). –Mbi

një sipërfaqe truall e ndodhur në vendin "Sadra" lagjia "Isa Boletini", prej 4800 metër katrorë truall. –Mbi një sipërfaqe toke të tjetërsuar në truall prej 6600 metër katrorë e ndodhur në vendin "Aplemë", lagjia e Re. 1b. Të kompensojë sipërfaqen e truallit prej 5000 metër katrorë sipas disponibilitetit që do të ketë komisioni. 1c. Sipërfaqja e tokës së tjetërsuar në truall prej 6400 metër katrorë do të trajtohet me ligjin për tokën bujqësore".

Në funksion të hetimit është sekuestruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë e gjithë praktika e dosjes gjyqësore që i përket vendimit gjyqësor civil nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Nga aktet e kësaj dosje rezulton se shtetasi Raimond Mezi, ka paraqitur padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë me objekt anulimin e vendimit të KKKP. Si prova shkresore rezulton se është paraqitur vendimi nr. 100, datë 19/04/1994 ish-KKKP-së Bashkia e Qytetit Vlorë, i cili është njësuar me origjinalin pranë noterit publik Ylli Mehmeti. Përmes këtij vendimi rezulton se është vendosur: *"1. Të njoh si ish pronarë të kësaj prone z. Jakup Mezi (trashëgimtarët e tij). –Mbi një sipërfaqe kullote prej 220 ha e ndodhur në vendin "Karaburun", kufizuar në: Lindje Përroi i uji i njelm, Jug Qafa e gjashtës, Veri Deti, Perëndim Përroi i Dhime Kushtes".* Gjithashtu rezulton se është paraqitur edhe nota e transkriptimit në favor të Jakup Mezi, e cila është pasqyruar në rradhorin 9, vol 12, datë 13/05/1943. Kjo notë transkriptimi është paraqitur fotokopje e njësuar me origjinalin pranë noterit publik Ylli Mehmeti. Në këtë notë transkriptimi është pasqyruar se pasuria që shitet është kjo pasuri: *"Në vendin e quajtur "Karaburun" një kullotë dimërore për këtëqind kokë dhi, rreth 1900 (njëmijë e nënëqind) vreten që kufizohet: Lindje Përroi uji i njelm, Jug Qafa e gjashtës, Veri Deti, Perëndim Përroi i Dhime Kushtes".* Rezulton se si titull pronësie është pasqyruar fakti se ka shërbyer çertifikata notë transkriptimi e zyrës Ipotekave të Vlorës nr. 273 (dyqind e shtatëdhjetë e tre) datë 18 tetor 1934.

(Rezulton se në pjesën e brendshme të kapakut në fund të kësaj dosje është qepur një dëftesë komunikimi e cila qëllimisht është dëmtuar në ekstremitetet e saj me qëllim që të mos identifikohet se prej cilës dosje është hequr kjo dëftesë komunikimi).

Nga ana e organi procedues është administruar nota e transkriptimit nr. 273 e vitit 1934, në favor të Mynevere Danos, e cila ka shërbyer si titull pronësie për shitjen e pronës shtetasit Jakup Mezi. Rezulton se në këtë notë transkriptimi nuk flitet për pasurinë që ndodhet në vendin e quajtur "Karaburun" një kullotë dimërore për këtëqind kokë dhi, rreth 1900 (njëmijë e nënëqind) vreten që kufizohet: Lindje Përroi uji i njelm, Jug Qafa e gjashtës, Veri Deti, Perëndim Përroi i Dhime Kushtes, pra për pasurinë që ka blerë shtetasi Jakup Mezi.

Gjithashtu është administruar nota e transkriptimit e pasqyruar në rradhorin 9, vol 12, datë 13/05/1943 në favor të Jakup Haxhi Mezi. Rezulton se në këtë notë transkriptimi është pasqyruar shitja e pasurisë nga shtetasja Mynevere Dano tek shtetasi Jakup Mezi të pasurisë që ndodhet në vendin Anë e madhe, një vresht prej katër vreten tokë dhe dhjetë rrënjë ullinj. Rezulton se si titull pronësie për kryerjen e veprimit të shitjes ka shërbyer nota e transkriptimit nr. 273, datë 15/10/1934. Rezulton se shënimet në lidhje me shitjen e kësaj pasurie janë kryer edhe në notën e transkriptimit nr. 273 të vitit 1934.

Nga të dhënat e mësipërme rezulton e provuar se vendimi nr. 100, datë 19/04/1994 ish-KKKP-së Bashkia e Qytetit Vlorë, i paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, është krejtësisht i ndryshëm me vendimin nr. 100, datë 19/04/1994 ish-KKKP-së Bashkia e Qytetit Vlorë, të administruar pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave Tiranë. Për rrjedhojë vendimi

nr. 100, datë 19/04/1994 ish-KKKP-së Bashkia e Qytetit Vlorë, i paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe pranë ZVRPP Vlorë është i falsifikuar.

Pra, rezulton se mbi bazën e të dhënave dhe ekstremiteteve të vendimit të administruar pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave Tiranë është krijuar një vendim tjetër me të njëjtat ekstremitete në favor të subjektit Jakup Mezi, por duke falsifikuar të dhënat e pronësisë, e konkretisht duke pasqyruar fakin sikur komisioni ka njohur pronësinë e subjektit Jakup Mezi mbi një sipërfaqe kullote prej 220 ha, e ndodhur në vendin "Karaburun", kufizuar në: Lindje Përroi uji i njelm, Jug Qafa e gjashtës, Veri Deti, Perëndim Përroi i Dhime Kushtes.

Gjithashtu rezulton se edhe nota e transkriptimit e pasqyruar në rradhorin 9, vol 12, datë 13/05/1943 në favor të shtetasit Jakup Mezi dhe e paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë është një dokument i falsifikuar. Të dhënat e pasqyruara në këtë notë transkriptimi, pasqyrojnë të dhëna të rreme, pasi shtetasja Mynevere Dano nuk ka pasur në pronësi pasurinë e pasqyruar në këtë notë transkriptimi. Rezulton e provuar se nota e transkriptimit origjinale dhe e administruar pranë ZVRPP Vlorë, flet për shitjen e pasurisë që ndodhet në vendin "Anë e madhe", një vresht prej katër vreten tokë dhe dhjetë rrënjë ullinj. Pra, duke marrë të dhënat e kësaj note transkriptimi, rezulton se është krijuar një notë e re transkriptimi e falsifikuar, duke përdorur ekstremitetet e notës origjinale të transkriptimit, por duke falsifikuar të dhënat e pronësisë, e konkretisht falsifikimi qëndron në faktin se është pasqyruar sikur përmes kësaj note transkriptimi është shitur pasuria "Në vendin e quajtur "Karaburun" një kullotë dimërore për këtëqind kokë dhi, rreth 1900 (njëmijë e nëntëqind) vreten që kufizohet: Lindje Përroi uji i njelm, Jug Qafa e gjashtës, Veri Deti, Perëndim Përroi i Dhime Kushtes".

Provohet se falsifikimi i dokumenteve të mësipërme është realizuar nga i pandehuri Enkes Hysendhima në bashkëpunim me të pandehurin Raimond Mëzi.

Nga hetimi rezulton se në vendimin gjyqësor civil nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është pasqyruar fakti sikur është dhënë nga gjyqtari Thoma Nika, i asistuar nga sekretere gjyqësore Natasha Qejvani dhe Antigoni Meçaj. Ndërsa referuar procesverbaleve të seancave gjyqësore, rezulton se sekretare gjyqësore ka qenë edhe shtetasja Antigoni Meçaj. Rezulton se me vendimin nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është vendosur: "*Pranimin e padisë së paditësit Raimond Mezi. Anullimin e pjesës së vendimit të Kom.KK. Pronave Vlorë, nr 100, datë 19/04/1994 për pikën 1 të këtij vendimi duke vendosur kthimin në natyrë të sipërfaqes 220 ha, në vendin e quajtur Karaburun, me kufij: Veri-deti, Jug-qafa e gjashtës, Lindje-Proi i uji i njelmet, Perëndim-Proi i Dhime Kushtës (sipas skicave të ndodhura në dosje)*".

Bazuar në aktin e aktin e ekspertimit grafik nr. 7891, datë 11.08.2016, rezulton se vendimi i mësipërm dhe dosja gjyqësore janë tërësisht të falsifikuara.

Për këtë qëllim është thirrur dhe pyetur në cilësinë e deklaruesit, shtetasi Thoma Nika, gjyqtari në emër të të cilit është dhënë vendimi i mësipërm. Ky shtetas ka deklaruar se nuk ka nënshkruar vendimin nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, si dhe nuk ka nënshkruar në asnjë procesverbal që është administruar në këtë dosje gjyqësore. Sipas tij, në të gjithë dosjen gjyqësore nuk ndodhet asnjë shkrim apo nënshkrim që të jetë shkruar/nënshkruar prej tij. Në funksion të hetimit është pyetur në cilësinë e deklarueses

shtetasja Antigoni Meçaj, emri i të cilës është pasqyruar si sekretare gjyqësore në dosjen e konkretizuar me vendimin nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Kjo shtetase ka deklaruar se nuk ka nënshkruar vendimin nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, si dhe nuk ka shkruar/nënshkruar në asnjë procesverbal që është administruar në këtë dosje gjyqësore. Sipas saj, në të gjithë dosjen gjyqësore nuk ndodhet asnjë shkrim apo nënshkrim që të jetë shkruar/nënshkruar prej saj.

Rezulton se në dosjen e mësipërme gjyqësore është administruar edhe një fletë-thirrje, e cila mban nr. 673 Akti. Organi procedues ka sekuestruar në cilësinë e provës dosjen gjyqësore që i përket numrit 673 Akti. Rezulton se kjo dosje gjyqësore i përket vendimit nr. 1502, datë 23/09/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me gjyqtarë Lek Mehilli dhe me palë paditëse Ariste Kuqi dhe palë e paditur K.K.K Pronave të rrethit Vlorë. Nga këqyrja e kësaj dosje gjyqësore rezulton se ndërmejt fletëve 9 dhe 13, kanë qenë të qepura 3 (tre) fletë-thirrje, të cilat janë grisur. Provohet se njëra prej këtyre fletëthirrjeve është përdorur për tu vendosur në dosjen gjyqësore që i përket vendimit nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Rezulton se në pjesën e brendshme të kapakut në fund të kësaj dosje është qepur një dëftesë komunikimi e cila qëllimisht është dëmtuar në ekstremitetet e saj me qëllim që të mos identifikohet se prej cilës dosje është hequr. Ndërsa në pjesën e brendshme të kapakut në fund të dosjes që i përket vendimit nr. 1502, datë 23/09/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duket qartë se ka qenë kapur me kapse dëftesa e komunikimit të vendimit, por kjo dëftesë është hequr, duke lënë shenjat e saj në kapakun e dosjes. Nga kjo e dhënë del qartë se e pandehura Donika Besimaj, e cila ka pasur në administrim të gjithë arkivën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka hequr fletëthirrjet nga dosja gjyqësore që i përket vendimit 1502, datë 23/09/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke i administruar në dosjen krejtësisht të falsifikuar, që i përket vendimit nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Bazuar në aktin e ekspertimit grafik nr. 7891, datë 12/08/2016 të kryer në lidhje me këtë dosje gjyqësore rezulton se:

-Tek dokumentet e listuara (dhe të sipërcituara) në dosjen Nr.Vendimi 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, objekt ekspertimi:

1.-Dorëshkrimet e ndodhura në pjesën e sipërme të faqes së brendshme të kapakut të parmë të dosjes së sipërcituar objekt ekspertimi, nuk janë shkruar nga shtetasja Antigoni Meçaj, krahasuar me modelet respektive të paraqitura.

2.-Dorëshkrimet e ndodhura në faqen e pasme të dokumentit "Kërkesë padi", në emër të paditësit Raimond Mëzi, datë depozitimi 01.09.2000 në Gjykatën e Rrethit Vlorë (listuar me nr.1 në dosje) objekt ekspertimi, nuk janë shkruar nga shtetasja Antigoni Meçaj, krahasuar me modelet respektive të paraqitura.

3.-Dorëshkrimet e ndodhura në dokumentet e listuara me nr.13, 14, 15, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23 dhe 24 në dosjen e sipërcituar objekt ekspertimi: -janë shkruar nga i njëjti person; -nuk janë shkruar nga shtetasja Antigoni Meçaj, krahasuar me modelet respektive të paraqitura.

4.-Nëse tërësia e grup dorëshkrimeve objekte ekspertimi është shkruar apo jo nga shtetasi Thoma Nika, nga ana jonë për shkak të pamjaftueshmërisë së dorëshkrimeve modele krahasimi në emër të këtij shtetasi, nuk mund të konkludohet.

5.-Tërësia e nënshkrimeve (firmave) në emër të shtetases Antigoni Meçaj, të ndodhura në secilin prej dokumenteve të sipërcituara objekte ekspertimi: -Janë shkruar (nënshkruar) nga i njëjti person; -Nuk janë nënshkrime (firma) të shtetases Antigoni Meçaj, krahasuar me modelet respektive të paraqitura.

6.-Tërësia e nënshkrimeve (firmave) në emër të shtetasit Thoma Nika, të ndodhura në secilin prej dokumenteve të sipërcituara objekte ekspertimi; -Janë shkruar (nënshkruar) nga i njëjti person; -nuk janë nënshkrime (firma) të shtetasit Thoma Nika, krahasuar me modelet respektive të paraqitura.


7.-Nënshkrimi (firma) në emër të shtetasit Raimond Mezi, e ndodhur në rekuizitën "Paditës Raimond Mezi", në dokumentin "kërkesë padi", në emër të paditësit Raimond Mezi, datë depozitimi 01.09.2000, në Gjykatën e Rrethit Vlorë (listuar me nr. 1 në dosje) objekt ekspertimi, nuk përjashtohet mundësia të jetë nënshkruar (firmosur) nga shtetasi Raimond Mezi, krahasuar me modelet e paraqitura.

Bazuar në aktin e ekspertimit tekniko-grafik nr. 6495, datë 20/06/2017, të kryer edhe në lidhje me aktet dhe dokumentet që ndodhen në dosjen e mësipërme gjyqësore rezulton se:

- Secila prej shenjave të vulave në formën e katër rreshta mbishkrimesh, me tonalitet boje ngjyrë blu, me përmbajtje të njëjtë "Vertetohet Njësia - Me Originalin - Noteri - Ylli Mehmeti", të ndodhura në fletët me nr. 2, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11, në dosjen e sipërcituar objekt ekspertimi është e falsifikuar. Falsifikimi konsiston në përfitim të secilës prej këtyre shenja vulash nëpërmjet vizatimit me mjet shkruar me dorë.
- Secila prej shenjave të vulave rrethore me tonalitet boje ngjyrë blu me përmbajtje të njëjtë teksti: "Republika e Shqipërisë - Ylli Mehmeti – Noter - Vlorë", të ndodhura në fletët me nr. 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11, në dosjen e sipërcituar objekt ekspertimi është e falsifikuar. Falsifikimi konsiston në përfitim të secilës prej këtyre shenja vulash, fillimisht në përfitim në formë stampimi të rrethit të jashtëm të secilës prej tyre, e më tej duke vizatuar me mjet shkruar me dorë, rrethin e brendshëm dhe tërësinë e plotësimeve të tjera të përmbajtjes së secilës prej tyre.
- Shenja e vulës në formën e tre rreshta mbishkrimesh, me tonalitet boje ngjyrë blu, me përmbajtje teksti: "Vendimi Mori Form Te Prer - Kryesekretare - Teuta Gjika", e ndodhur në faqen e dytë të fotokopjes së dokumentit Vendim nr. 981 Akti, Nr. 1360 Vendimi, datë 29.12.2000, i gjyqtarit Thoma Nika, të kapur me kapëse metalike në kapakun e pasëm të dosjes me nr. Vendimi 1360, datë 29.12.2000, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë objekt ekspertimi është e falsifikuar. Falsifikimi konsiston në përfitim të kësaj shenje vule, nëpërmjet vizatimit me mjet shkruar me dorë.

Nga akti i mësipërm i ekspertimit dhe bazuar në të dhënat e administruara pranë ZVRPP Vlorë dhe Agjencisë së Trajtimit të Pronave Tiranë, rezulton e provuar se edhe aktet e administruara në dosjen gjyqësore që i përket vendimit gjyqësor civil nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, janë tërësisht të falsifikuara.

Nga deklaratimet e të pandehurit Raimond Mezi, rezulton se ai nuk ka dijeni për vendimin nr. 100, datë 19/04/1994 ish-KKKP-së Bashkia e Qytetit Vlorë, përmes së cilit është njohur pronësia për 220 ha, që ndodhen në Karaburun. Gjithashtu ky shtetas ka sqaruar se nuk ka paraqitur ndonjë padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, si dhe nuk ka dijeni për



vendimin nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Po ashtu, ky shtetas ka deklaruar se nuk ka aplikuar për regjistrimin e pasurisë pranë ZVRPP Vlorë. Sipas tij, aplikimin mund të këtë bërë avokati i tij, shtetasi Enkes Hysnedhima, pasi ky i fundit duke vepruar në emrin e tij, ka shitur disa prona në Karaburun dhe i ka dhënë shumën prej 4.000.000 lekë me këste, si çmim për shitjen e kësaj prone. Gjithashtu ky shtetas ka deklaruar se në të gjitha kontratat që janë në emër të tij, janë nënshkruar prej tij, por këto kontrata janë firmosur fillimisht në fletë të bardhë bosh dhe se ai nuk ka dijeni në lidhje me përmbajtjen e këtyre kontratave. Ky shtetas ka deklaruar se është paraqitur tre herë pranë zyrës së noteres dhe ka nënshkruar në të tre rastet fletë të bardha bosh. Pranë zyrës së noteres ai është dërguar nga i pandehuri Enkes Hysendhima, i cili e ka telefonuar në të tre rastet që të paraqitej pranë noteres për të nënshkruar. Rezulton se veprimet juridike të kryera nga i pandehuri Raimond Mëzi, janë kryer pranë zyrës së noteres Belona Seraj. Këto deklarime i pandehuri Raimond Mëzi i ka përsëritur edhe gjatë pyetjes së tij në seancat gjyqësore me objekt vleftësimin e ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit në ngarkim të tij.

Nga hetimi provohet se pasuria e regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 421, datë 12/10/2012, me përshkrimin "Një sipërfaqe kullotë prej 220 ha, në vendin Karaburun sipas kufinjëve", në emër të shtetasit Raimond Mezi, është regjistruar mbi bazën e dokumenteve të falsifikuara, si dhe është tjetërsuar tek persona të tretë. Konkretisht rezulton e provuar se pasuria e mësipërme është tjetërsuar duke pasqyruar veprimet përkatëse në regjistrat hipotekorë pranë ZVRPP Vlorë, si më poshtë:

- Në regjistrin hipotekor me nr. 350, datë 02/10/2014 është pasqyruar kërkesa e ndarjes së pasurisë së paraqitur nga shtetasi Raimond Mezi. Konkretisht në këtë numër hipotekor është pasqyruar fakti se në emër të shtetasit Raimond Mezi, figuron e regjistruar pasuria "Një sipërfaqe kullote S=90 ha, në Karaburun të Vlorës". Rezulton se kjo pasuri e ka origjinën nga pasuria prej 220 ha, të regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 421, datë 12/10/2012.
- Në regjistrin hipotekor me nr. 351, datë 02/10/2014 është pasqyruar kërkesa e ndarjes së pasurisë së paraqitur nga shtetasi Raimond Mezi. Konkretisht në këtë numër hipotekor është pasqyruar fakti se në emër të shtetasit Raimond Mezi, figuron e regjistruar pasuria "Një sipërfaqe kullote S=130 ha, në Karaburun të Vlorës" Rezulton se kjo pasuri e ka origjinën nga pasuria prej 220 ha, të regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 421, datë 12/10/2012.
- Në regjistrin hipotekor nr. 362, datë 13/10/2014 është regjistruar kontrata e shitjes nr. 878 rep dhe nr. 502/1 kol, datë 10/10/2014. Përmes kësaj kontrate, shtetasi Raimond Mezi ka shitur sipërfaqen prej 90 ha, subjekteve tregtare "House of Arts" sh.p.k dhe "Digitalnet orks" sh.p.k. Për realizimin e këtij veprimi është lidhur kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. 878 rep dhe nr. 502/1 kol, datë 10/10/2014. Kjo kontratë është lidhur ndërmjet shtetasit Raimond Mezi në cilësinë e palës shitëse dhe subjekteve "House of Arts" sh.p.k dhe "Digitalnet[orks]" sh.p.k. Rezulton se në kryerjen e këtij veprimi juridik, shtetasi Raimond Mezi është përfaqësuar nga shtetasi Enkes Hysendhima.
- Në regjistrin hipotekor nr. 609, datë 15/12/2014 është regjistruar kontrata e shkëmbimit nr. 1081 rep dhe nr. 613/1 kol, datë 04/12/2014. Përmes kësaj kontrate,

shtetasi Raimond Mezi, në cilësinë e pronarit të pasurisë prej 130 ha, ka shkëmbyer këtë pronë me pronën prej 199.500 metër katrorë në pronësi të shtetasit Artur Shehu. Në kryerjen e këtij veprimi juridik rezulton se shtetasi Artur Shehu është përfaqësuar nga shtetasi Pullumb Petritaj.

- Në regjistrin hipotekor me nr. 256, datë 23/03/2015 është pasqyruar kërkesa e ndarjes së pasurisë. Konkretisht në këtë numër hipotekor është pasqyruar fakti se në emër të shtetasit Artur Shehu, figuron e regjistruar pasuria “Një sipërfaqe kullote prej 50.000 metër katrorë, në Karaburun të Vlorës”. Rezulton se kjo pasuri e ka origjinën nga pasuria prej 130 ha, të regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 609, datë 15/12/2014.
- Në regjistrin hipotekor me nr. 257, datë 23/03/2015 është pasqyruar kërkesa e ndarjes së pasurisë. Konkretisht në këtë numër hipotekor është pasqyruar fakti se në emër të shtetasit Artur Shehu, figuron e regjistruar pasuria “Një sipërfaqe kullote prej 125 ha, në Karaburun të Vlorës”. Rezulton se kjo pasuri e ka origjinën nga pasuria prej 130 ha, të regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 609, datë 15/12/2014.
- Në regjistrin hipotekor me nr. 260 të vitit 2015 është regjistruar kontrata e shitjes nr. 405 rep dhe nr. 275/1 kol, datë 25/03/2015. Kjo kontratë është lidhur ndërmjet shtetasit Artur Shehu përfaqësuar nga shtetasi Pullumb Petritaj në cilësinë e palës shitëse dhe shtetasit Arian Laci në cilësinë e palës blerëse. Përmes kësaj kontrate, shtetasi Artur Shehu, ka shitur sipërfaqen e pronës prej 50.000 metër katrorë, pasuri e cila ka qenë regjistruar në regjistrin hipotekor nr.256 datë 23/03/2015.
- Në regjistrin hipotekor me nr. 497, datë 01/10/2015 është pasqyruar kërkesa e ndarjes së pasurisë. Konkretisht në këtë numër hipotekor është pasqyruar fakti se në emër të shtetasit Artur Shehu, figuron e regjistruar pasuria “Një sipërfaqe kullote prej 10 ha, në Karaburun të Vlorës”. Rezulton se kjo pasuri e ka origjinën nga pasuria prej 125 ha, të regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 257, datë 23/03/2015.
- Në regjistrin hipotekor me nr. 498, datë 01/10/2015 është pasqyruar kërkesa e ndarjes së pasurisë. Konkretisht në këtë numër hipotekor është pasqyruar fakti se në emër të shtetasit Artur Shehu figuron e regjistruar pasuria “Një sipërfaqe kullote prej 10 ha, në Karaburun të Vlorës”. Rezulton se kjo pasuri e ka origjinën nga pasuria prej 125 ha, të regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 257, datë 23/03/2015.
- Në regjistrin hipotekor me nr. 7, datë 14/01/2016 është pasqyruar regjistrimi i një sipërfaqe prone prej 10 Ha, regjistruar në emër të shtetasit Thodhori Gjikhuri. Kjo pasuri e ka origjinën nga sipërfaqja e pronës prej 10 ha, regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 497 datë 01/10/2015. Ky veprim është kryer përmes kontratës së shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. 33 rep dhe nr. 32/1 kol, datë 08/01/2016. Kjo kontratë është lidhur ndërmjet shtetasit Artur Shehu përfaqësuar nga shtetasi Pullumb Petritaj në cilësinë e palës shitëse dhe shtetasit Thodhori Gjikhuri në cilësinë e palës blerëse. Përmes kësaj kontrate shtetasi Artur Shehu ka shitur sipërfaqen e pronës prej 10 ha, regjistruar në numrin hipotekor 497 datë 01/10/2015, si dhe pasurinë me sipërfaqe 10 ha, regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 498, datë 01/10/2015.

Gjatë hetimit është administruar prokura e përgjithshme nr. 759 rep dhe nr. 442 kol, datë 11/08/2014. Përmes kësaj prokure, shtetasi Raimond Mëzi ka emëruar si përfaqësues të tij shtetasin Enkes Hysendhima. Gjithashtu është administruar kontrata e shitjes së pasurisë nr. 878 rep dhe nr. 502 kol, datë 10/10/2014. Kjo kontratë është lidhur ndërmjet shtetasit Raimond Mëzi, i përfaqësuar nga shtetasi Enkes Hysendhima në cilësinë e palës shitëse dhe subjekteve “Digitalnet[orks]” sh.p.k dhe “House of Arts” sh.p.k, në cilësinë e palës blerëse. Objekti i kësaj kontrate është shitja e pasurisë me sipërfaqe 90 ha, që ndodhet në Karaburun, kundrejt çmimit prej 180.000 Euro. Bashkëlidhur kësaj kontrate ndodhet prokura e përgjithshme nr. 937 rep dhe nr. 337 kol, datë 30/07/2014, përmes së cilës shtetasi Raimond Mëzi ka emëruar si përfaqësues shtetasin Enkes Hysendhima.

Gjatë kontrollit të zyrës së noteres Bleona Seraj, është sekuestruar Prokura e Përgjithshme nr. 661 Rep dhe nr. 357/2 Kol, datë 11/08/2014, sipas së cilës shtetasi Raimond Mëzi ka emëruar përfaqësues ligjor shtetasin Enkes Hysendhima. Gjithashtu gjatë kontrollit të zyrës së noteres Belona Seraj, janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale katër 4 (fletë) të bardha bosh, në fund të të cilave, në cepin e majtë janë shkruar me shkrim dore emrat e shtetasve Arian Troqe dhe Reneta Troqi, si dhe nënshkrimi i këtyre shtetasve. Janë sekuestruar 29 (njëzet e nëntë) fletë të bardha bosh, në të cilat është shënuar emri i shtetasit Pullumb Petritaj, si dhe nënshkrimi i këtij shtetasi. Janë sekuestruar 21 (njëzet e një) fletë të bardha bosh në të cilat është shënuar emri i shtetasit Jazo Troqe, si dhe nënshkrimi i këtij shtetasi. Janë sekuestruar 35 (tridhjetë e pesë) fletë të bardha bosh, në të cilat ka nënshkruar noterja Belona Seraj. Janë sekuestruar 3 (tre) fletë të bardha bosh në të cilat është pasyruar emri i shtetasës Mirka Rondo, bashkë me nënshkrimin e kësaj shtetaseje, si dhe fotokopje e kartës së identitetit të kësaj shtetaseje. Janë sekuestruar 4 (katër) fletë të bardha bosh në fund të të cilave është pasqyruar emri dhe nënshkrimi i shtetasit Mirdit Çupi, si dhe kopje e kartës së identitetit të këtij shtetasi. Janë sekuestruar 3 (tre) fletë të bardha bosh në fund të të cilave është pasqyruar emri dhe nënshkrimi i shtetasit Ahmet Kulluri, si dhe kopje e kartës së identitetit të këtij shtetasi. Janë sekuestruar 15 (pesëmbëdhjetë) fletë të bardha bosh në fund të të cilave është pasqyruar nënshkrimi i noteres Belona Seraj.

Bazuar në të dhënat e mësipërme rezulton se pasuria e regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 421, datë 12/10/2012, me përshkrimin “Një sipërfaqe kullotë prej 220 ha, në vendin Karaburun sipas kufinjëve”, në emër të shtetasit Raimond Mezi, është regjistruar mbi bazën e dokumenteve tërësisht të falsifikuara. Provohet se për regjistrimin e kësaj pasurie nuk ka aplikuar i pandehuri Raimond Mezi. Ndërsa aplikimi i paraqitur nga shtetasi Nesti Bifsha, bën fjalë për një pronë tjetër, por nga ana e të pandehurës Blerina Dhrami (Brahimi) është përdorur kopje e këtij aplikimi për të kryer regjistrimin e pasurisë në emër të pandehurit Raimond Mezi. Duke qenë se në regjistrin hipotekor me nr. 421, datë 12/10/2012 është pasqyruar se është regjistruar prona mbi bazën e kërkesës nr. 274, organi procedues ka këqyruar pranë ZVRPP Vlorë, praktikën që i përket aplikimit me nr. 274. Nga administrimi i praktikave të aplikimit e konkretisht të aplikimit me nr. 274, datë 09/10/2012, rezulton se ky aplikim i përket aplikuesit Netilda Gunbardhi, për një pronë që ndodhet në Himarë. Pra, rezulton se si ky aplikim ashtu edhe aplikimi në emër të shtetasit Nesti Bifsha, i cili është administruar në fotokopje në praktikën e regjistrimit të kësaj pasurie, nuk bëjnë fjalë për pasurinë prej 220 ha, që ndodhet në Karaburun-Vlorë. Rezulton se për aplikimin e regjistrimit të kësaj pasurie nuk është

administruar dokumenti i identifikimit të aplikuesit, apo ndonjë dokument tjetër përmes së cilit të provohet fakti se ndonjë shtetas ka aplikuar në cilësinë e përfaqësuesit të pandehurit Raimond Mezi. Provohet se pas regjistrimit të kësaj pasurie mbi bazën e dokumenteve të falsifikuara, janë kryer veprime juridike duke e tjetërsuar këtë pasuri tek persona të tretë.

Episodi 2: Regjistrimi i pronës me dokumenta të falsifikuara prej 89 Ha, në vendin e quajtur Shen Velash, Vlorë.

Gjatë hetimeve paraprake është provuar se i pandehuri Raimond Mëzi, në bashkëpunim me të pandehurit Enkes Hysendhima, Donika Besimaj dhe Blerina Dhrami (Brahimi), ka përfitur, regjistruar dhe tjetërsuar një sipërfaqe prone prej 89 Ha, në vendin e quajtur Shen Velash, Vlorë, me dokumente tërësisht të falsifikuara.

Dokumentet e falsifikuara mbi bazën e të cilës është përfitur kjo pasuri është e gjithë dosja gjyqësore që i përket vendimit gjyqësor civil nr. 2217, datë 29/12/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Nga hetimi është provuar se kjo dosje gjyqësore dhe aktet e ndodhura në të janë tërësisht të falsifikuara, si dhe janë futur në kundërshtim me ligjin në arkivën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Për të fshehur këtë veprimtari të kundërligjshme, rezulton se të dhënat e pasqyruara në këtë dosje gjyqësore janë pasqyruar edhe në tre regjistra që ndodheshin të administruara në arkivën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Konkretisht janë pasqyruar të dhënat e kësaj dosje në Regjistrin Civil Themeltar, në Numratorin Civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në Indeksën e Vendimeve Civile të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, regjistra që ndodheshin të arkivuara në mjedise të ndryshme të arkivës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Gjithashtu provohet se edhe dosja fizike që i përket vendimit gjyqësor civil nr. 2217, datë 29/12/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është sistemuar dhe arkivuar në vendin përkatës ku ndodheshin dosjet gjyqësore që i përkisnin muajit dhjetor të vitit 2003. Provohet se veprimtaria e mësipërme është kryer nga e pandehura Donika Besimaj, e cila ka pasur në posedim të gjithë regjistrat e mësipërm. Pasi është realizuar veprimtaria e mësipërme e kundërligjshme, e pandehura Donika Besimaj, u ka vënë në dispozicion kopje të njëzuar të vendimit gjyqësor civil nr. 2217, datë 29/12/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, si dhe të akteve të kësaj dosje, të pandehurve Enkes Hysendhima dhe Raimond Mëzi. Këta dy të fundit, në bashkëpunim me të pandehurën Blerina Dhrami (Brahimi), mbi bazën e dokumenteve të falsifikuara të vëna në dispozicion nga e pandehura Donika Besimaj, kanë regjistruar në regjistrat publik pranë ZVRPP Vlorë sipërfaqen e pronës prej 89 Ha, pronë e cila është pasqyruar sikur është kthyer përmes vendimit gjyqësor civil nr. 2217, datë 29/12/2003 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Pas regjistrimit të kësaj sipërfaqe prone, rezulton se të pandehurit Enkes Hysendhima dhe Raimond Mëzi, kanë kryer veprime juridike mbi këtë pasuri, si ndarje dhe tjetërsime, me qëllimin e vetëm fshehjen e origjinës së paligjshme të kësaj pasurie.

Nga hetimi ka rezultuar se, në ZVRPP Vlorë është regjistruar vendimi gjyqësor nr. 2217, datë 29/12/2003 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Përmes këtij vendimi është përshkruar fakti se shtetasi Raimond Mëzi ka paraqitur padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me objekt anulimin e vendimit nr. 100, datë 19/04/1996 të KKK Pronave, në pikën 1 të tij. Po sipas këtij vendimi rezulton se është vendosur pranimi i padisë, duke anuluar në mënyrë

të pjesshme vendimin e KKK Pronave Vlorë nr. 100, datë 19/04/1996 për pikë 1 të tij dhe duke vendosur kthimin në natyrë të sipërfaqes 89 Ha, në Vlorë, në vendin e quajtur Shen Velash me kufij: Veri-Seit Shehu, Jug-Vllazëria Sharraj, Lindje-Vëllazëria Sharraj, Perëndim Deti. Nga këqyrja e këtij vendimi gjyqësor rezulton se është përshkruar fakti sikur është dhënë nga gjyqtari Skerdilajd Konomi.

Nga sekuestrimi i dosjes gjyqësore, që i përket vendimit nr. 2217, datë 29/12/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, rezulton se kjo dosje pasi është falsifikuar është bërë pjesë e arkivit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Rezulton e provuar se edhe dokumentet shkresore të falsifikuara dhe të përdorura për falsifikimin e kësaj dosje gjyqësore janë të njëjtat dokumente të falsifikuara, që janë bërë pjesë e dosjes gjyqësore që i përket vendimit civil nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Ky fakt provohet edhe nga sekuestrimi i numratorit civil të vitit 2003, ku duket qartë se janë shtuar në këtë libër të dhënat e vendimit të mësipërm gjyqësor. Pra, del qartë se është përdorur i njëjti mekanizëm që është përdorur për të falsifikuar dhe pastaj bërë pjesë të arkivit edhe dosjen gjyqësore që i përket vendimit nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, përmes së cilit janë përfituar 220 ha tokë, si dhe nga të njëjtët persona.

Nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se është vendosur një biletë shorti nr.11, e cila është grisur në pjesën që përmban të dhëna për datën e shortit. Duke qenë se kjo dosje është pasqyruar sikur është hedhur në short në vitin 2002, organi procedues ka sekuestruar librin e shortit të vitit 2002. Nga këqyrja e këtij libri rezulton se në të nuk është pasqyruar hedhja e shortit për dosjen gjyqësore të paditësit Raimond Mëzi. Nga kjo e dhënë provohet fakti se e pandehura Donika Besimaj, ka hequr biletën e shortit nga dosje të tjera të administruara në arkivën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, e ka grisuar në pjesën që ishte vendosur data e hedhjes së shortit dhe pastaj e ka vendosur në këtë dosje gjyqësore. Gjithashtu rezulton se në aktet që janë bërë pjesë të dosjes gjyqësore që i përkasin vendimit nr. 2217, datë 29/12/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është pasqyruar fakti sikur shtetasi Raimond Mezi, ka paraqitur padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë me objekt anulimin e vendimit të KKKP. Si prova shkresore rezulton se është paraqitur vendimi nr. 100, datë 19/04/1994 ish-KKKP-së Bashkia e Qytetit Vlorë, i cili është njësuar me origjinalin pranë noterit publik Ylli Mehmeti. Përmes këtij vendimi rezulton se është vendosur: *“1. Të njoh si ish pronarë të kësaj prone z. Jakup Mezi (trashëgimtarët e tij). –Mbi një sipërfaqe toke prej 89 Ha në Vlorë në vendin e quajtur “Shen Velash”, e cila kufizohet: Lindje Vellazëria sharraj, Perëndim Deti, Veri Seit Shehu, Jug Vellazëria Sharra”*. Gjithashtu rezulton se është paraqitur edhe nota e transkriptimit në favor të Jakup Mezi, e cila është pasqyruar në rradorin 248, vol 11, datë 15/10/1942. Kjo notë transkriptimi është paraqitur fotokopje e njësuar me origjinalin pranë noterit publik Ylli Mehmeti. Në këtë notë transkriptimi është pasqyruar fakti se pasuria që shitet është: *“Në Vlorë dhe në vendin “Shen Velash” një kullotë e cila përbëhet prej aproksimativisht 690 (gjashtëqind e nëntëdhjetë) vreten tokë dhe kufizohet përgjithësisht: Lindje Vellazëria Sharra, Perëndim Deti, Veri Seit Shehu dhe Perroji, Jug Vellazëria Sharra”*. Rezulton se si titull pronësie është pasqyruar fakti se ka shërbyer notë transkriptimi e zyrës Ipotekave të Vlorës nr. 10 (dhjetë) 12-Fruer-1941-XIX.

Organi procedues ka administruar pranë ZVRPP Vlorë, notën e transkriptimit që është pasqyruar në rradorin 248, vol 11, datë 15/10/1942. Rezulton se në këtë notë transkriptimi

është pasqyruar shitja e pasurisë nga shtetasi Vangjel Andriko tek shtetasi Jakup Mezi, të pasurisë që ndodhet në Vlorë në vendin "Apleme", një baçe e cila përbëhet prej dyzet (dyzet) rrënjë ullinj dhe aproksimativisht pese a gjashtë vreten tokë dhe kufizohet: përgjithësisht lindje ullinjt e Kishës, perëndim ullinjt e Kishës dhe përroji, veri Ismail Selfo e Vëllazëria, jugë udhë e Velo Agalliu dhe Vëllazëria. Rezulton se si titull pronësie për kryerjen e veprimit të shitjes ka shërbyer nota e transkriptimit nr. 10 datë 12 Friuer 1942, e cila është administruar dhe flet për shitjen e pasurisë nga shtetasi Hazbi Hamit Xhelo në favor të shtetasit Vnagjel Andriko.

Nga të dhënat e mësipërme rezulton e provuar se vendimi nr. 100, datë 19/04/1994 ish-KKKP-së Bashkia e Qytetit Vlorë, i paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, është krejtësisht i ndryshëm me vendimin nr. 100, datë 19/04/1994 ish-KKKP-së Bashkia e Qytetit Vlorë, të administruar pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave Tiranë. Për rrjedhojë vendimi nr. 100, datë 19/04/1994 ish-KKKP-së Bashkia e Qytetit Vlorë, i paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe pranë ZVRPP Vlorë është i falsifikuar. Pra, rezulton se mbi bazën e të dhënave dhe ekstremiteteve të vendimit të administruar pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave Tiranë është krijuar një vendim tjetër me të njëjtat ekstremitete në favor të subjektit Jakup Mezi, por duke falsifikuar të dhënat e pronësisë, e konkretisht duke pasqyruar fakin sikur komisioni ka njohur pronësinë e subjektit Jakup Mezi mbi një sipërfaqe kullote prej 89 Ha, e ndodhur në vendin "Shen Velash" një kullotë e cila përbëhet prej aproksimativisht 690 (gjashtëqind e nëntëdhjetë) vreten tokë dhe kufizohet përgjithësisht: Lindje Vellazeria Sharra, Perëndim Deti, Veri Seit Shehu dhe Perroji, Jug Vellazeria Sharra.

Gjithashtu rezulton se edhe nota e transkriptimit e pasqyruar në rradhorin 248, vol 11, datë 15/10/1942, në favor të shtetasit Jakup Mezi dhe e paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë është një dokument i falsifikuar. Të dhënat e pasqyruara në këtë notë transkriptimi, pasqyrojnë të dhëna të rreme, pasi shtetasi Vangjel Andriko nuk ka pasur në pronësi pasurinë e pasqyruar në këtë notë transkriptimi. Rezulton e provuar se nota e transkriptimit origjinale dhe e administruar pranë ZVRPP Vlorë, flet për shitjen e pasurisë që ndodhet në vendin "Apleme", një baçe e cila përbëhet prej dyzet (dyzet) rrënjë ullinj dhe aproksimativisht pese a gjashtë vreten tokë dhe kufizohet: përgjithësisht lindje ullinjt e Kishës, perëndim ullinjt e Kishës dhe përroji, veri Ismail Selfo e Vëllazëria, jugë udhë e Velo Agalliu dhe Vëllazëria. Pra, duke marrë të dhënat e kësaj note transkriptimi, rezulton se është krijuar një notë e re transkriptimi e falsifikuar, duke përdorur ekstremitetet e notës origjinale të transkriptimit, por duke falsifikuar të dhënat e pronësisë, e konkretisht falsifikimi qëndron në faktin se është pasqyruar sikur përmes kësaj note transkriptimi është shitur pasuria "Në Vlorë dhe në vendin "Shen Velash" një kullotë e cila përbëhet prej aproksimativisht 690 (gjashtëqind e nëntëdhjetë) vreten tokë dhe kufizohet përgjithësisht: Lindje Vellazeria Sharra, Perëndim Deti, Veri Seit Shehu dhe Perroji, Jug Vellazeria Sharra".

Bazuar në aktin e ekspertimit tekniko-grafik nr. 6495, datë 20/06/2017, të kryer edhe në lidhje me aktet dhe dokumentet që ndodhen në dosjen e mësipërme gjyqësore rezulton se:


- Secila prej shenjave të vulave në formën e katër rreshta mbishkrimesh, me tonalitet boje ngjyrë blu, me përmbajtje të njëjtë "Vertetohet Njësia - Me Origjinalin - Noteri - Ylli Mehmeti", të ndodhura në fletët me nr. 2, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11, në dosjen e sipërcituar objekt ekspertimi është e falsifikuar. Falsifikimi konsiston në përfundimin e secilës prej këtyre shenja vulash nëpërmjet vizatimit me mjet shkruar me dorë.



- Secila prej shenjave të vulave rrethore me tonalitet boje ngjyrë blu, me përmbajtje të njëjtë teksti: “Republika e Shqipërisë - Ylli Mehmeti – Noter - Vlorë”, të ndodhura në fletët me nr. 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11, në dosjen e sipërcituar objekt ekspertimi është e falsifikuar. Falsifikimi konsiston në përfitim të secilës prej këtyre shenja vulash, fillimisht në përfitim në formë stampimi të rrethit të jashtëm të secilës prej tyre, e më tej duke vizatuar me mjet shkruar me dorë, rrethin e brendshëm dhe tërësinë e plotësimeve të tjera të përmbajtjes së secilës prej tyre.
- Shenja e vulës në formën e tre rreshta mbishkrimesh, me tonalitet boje ngjyrë blu, me përmbajtje teksti: “Vendimi mori form te - prere pasi nuk u ankimua - Kancelare”, e ndodhur në faqen e dytë të fotokopjes së dokumentit Vendim nr. 330 (2169) Akti, Nr. 2217 Vendimi, datë 29.12.2003, i gjyqtarit Skerdilajd Konomi, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, të kapur me kapëse metalike në kapakun e pasëm të dosjes me nr. Vendimi 2217, datë 29.12.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë objekt ekspertimi është e falsifikuar. Falsifikimi konsiston në përfitim të kësaj shenje vule, nëpërmjet vizatimit me mjet shkruar me dorë.
- Tek dokumentet e listuara në dosjen e sipërcituar objekt ekspertimi ndodhen 13 (trembëdhjetë) nënshkrime (firma) në emër të Gjyqtar Skerdilajd Konomi.
- 13 (trembëdhjetë) nënshkrimet (firmat) në emër të Gjyqtar Skerdilajd Konomi, të ndodhura në dokumentet e listuara në dosjen gjyqësore me nr. Regj. Them 330 (2169), datë regjistrimi 30/11/2002 dhe nr. Vendimi 2217, datë 29/12/2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me paditës Raimond Mezi dhe paditur K.K.K.P Vlorë objekt ekspertimi: - janë nënshkruar (firmosur) nga i njëjti person; - nuk janë nënshkrime (firma) të Gjyqtar Skerdilajd Konomi, krahasuar me modelet respektive të paraqitura.
- 11 (njëmbëdhjetë) nënshkrimet (firmat) në emër të shtetases Natasha Qejvani, të ndodhura në grup dokumentet e listuara në dosjen gjyqësore me nr. Regj. Them 330 (2169), datë regjistrimi 30/11/2002 dhe nr. Vendimi 2217, datë 29/12/2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me paditës Raimond Mezi dhe paditur K.K.K.P Vlorë objekt ekspertimi, nuk janë nënshkrime (firma) të shtetases Natasha Rexhepi (Qejvani) krahasuar me modelet respektive të paraqitura.

Nga akti i mësipërm i ekspertimit dhe bazuar në të dhëna të administruara pranë ZVRPP Vlorë dhe pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave Tiranë, rezulton e provuar se edhe aktet e administruara në dosjen gjyqësore që i përket vendimit gjyqësor civil nr. 2217, datë 29/12/2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, janë tërësisht të falsifikuara.

Nga deklaratimet e të pandehurit Raimond Mëzi, rezulton se ai nuk ka dijeni për vendimin nr. 100, datë 19/04/1994 ish-KKKP-së Bashkia e Qytetit Vlorë, përmes së cilit është njohur pronësia për 89 Ha, që ndodhet në Shen Velash-Vlorë. Gjithashtu ky shtetas ka sqaruar se nuk ka paraqitur ndonjë padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, si dhe nuk ka dijeni për vendimin nr. 2217, datë 29/12/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Po ashtu, ky shtetas ka deklaruar se nuk ka aplikuar për regjistrimin e pasurisë pranë ZVRPP Vlorë. Sipas tij, aplikimin mund të këtë bërë avokati i tij, shtetasi Enkes Hysnedhima, pasi ky i fundit duke vepruar në emrin e tij, ka shitur disa prona në Karaburun dhe i ka dhënë shumën prej 4.000.000 lekë me këste, si çmim për shitjen e kësaj prone. Gjithashtu ky shtetas ka deklaruar se në të



gjitha kontratat që janë në emër të tij, janë nënshkruar prej tij, por këto kontrata janë firmosur fillimisht në fletë të bardhë bosh dhe se ai nuk ka dijeni në lidhje me përmbajtjen e këtyre kontratave. Ky shtetas ka deklaruar se është paraqitur tre herë pranë zyrës së noteres dhe ka nënshkruar në të tre rastet fletë të bardha bosh. Pranë zyrës së noteres ai është dërguar nga i pandehuri Enkes Hysendhima, i cili e ka telefonuar në të tre rastet që të paraqitej pranë noteres për të nënshkruar. Rezulton se veprimet juridike të kryera nga shtetasi Raimond Mëzi, janë kryer pranë zyrës së noteres Belona Seraj. Këto deklarime i pandehuri Raimond Mëzi i ka përsëritur edhe gjatë pyetjes së tij në seancat gjyqësore me objekt vleftësimin e ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit në ngarkim të tij.

Nga hetimi provohet se pasuria e përshkruar në vendimin e mësipërm të falsifikuar është regjistruar pranë ZVRPP Vlorë, nga e pandehura Blerina Dhrami (Brahimi). Provohet se për regjistrimin e kësaj pasurie është përdorur aplikimi i paraqitur nga shtetasi Nesti Bifsha, i cili mban nr. 455, datë 19/11/2012 dhe bën fjalë për një pronë tjetër që ndodhet në Dhërm-Himarë, pra jo për pronën e regjistruar në emër të shtetasit Raimond Mëzi. Nga këto të dhëna rezulton se është përdorur i njëjti aplikim që është përdorur për të regjistruar vendimin e falsifikuar nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Gjithashtu rezulton se për regjistrimin e kësaj pasurie është përdorur kopje e "njësuar" e të gjithë dosjes gjyqësore të falsifikuar që i përket vendimit nr. 2217, datë 29/12/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Kopje e kësaj dosje mban vulën e arkivës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, si dhe nënshkrimin e shtetases Donika Besimaj dhe datën 11/10/2012. Rezulton se vendimi nr. 2217, datë 29/12/2003 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, nuk ka të pasqyruar shënimin se ky vendim ka marrë formë të prerë, si dhe nuk mban vulën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Pra, del qartë se është përdorur i njëjti mekanizëm që është përdorur edhe për regjistrimin e vendimit nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Provohet se të dy këto vendime gjyqësore të falsifikuara janë regjistruar prej të pandehurës Blerina Dhrami (Brahimi), mbi bazën e të njëjtit aplikim që nuk i përket të pandehurit Raimond Mëzi.

Gjatë hetimit është provuar se pas regjistrimit të pasurisë së mësipërme mbi bazën e dokumenteve të falsifikuara, janë kryer veprime tjetërsimi, duke kaluar e gjithë pasuria në emër të personave të tretë. Rezulton e provuar se veprimet për ndarjen e pasurive dhe regjistrimin e kontratave përkatëse janë kryer nga specialisti Agim Shehaj. Rezulton e provuar se pasuria prej 89 Ha është regjistruar në kartela të ndryshme të regjistrimit të pasurive në emër të shtetasit Raimond Mëzi. Pra, rezulton se gjatë regjistrimit të vendimit gjyqësor të falsifikuar nr. 2217, datë 29/12/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, e gjithë pasuria prej 89 Ha, është pasqyruar në disa kartela pasurie, të cilat kanë qenë hapur nga kompania e menaxhimit. Nga këqyrja e kartelave përkatëse të pasurive të paluajtshme në të cilat është pasqyruar regjistrimi i pasurisë në emër të shtetasit Raimond Mëzi, rezulton se një pjesë e pasurisë prej 89 Ha është pasqyruar në kartelat e mëposhtme:

- Në kartelën e pasurisë me numër 41/63, vol. 15, faqe 69, ZK 8604, me sipërfaqe 13593,4 metër katrorë, e llojit pyll. Kjo pasuri ka kaluar në favor të shtetasit Artur Shehu, përmes kontratës së shkëmbimit nr. 1080 rep dhe nr. 612/3 datë 04/12/2014 të lidhur ndërmjet shtetasit Raimond Mëzi dhe shtetasit Artur Shehu, ky i fundit i përfaqësuar nga shtetasi Pullumb Petritaj.

- Në kartelën e pasurisë me numër 47/45/1, vol. 15, faqe 48, ZK 8604, me sipërfaqe 141725 metër katrorë, e llojit pyll, pasuri e cila vijon në volumnin 47, faqe 13 deri 15.
- Në kartelën e pasurisë me numër 41/95, vol. 15, faqe 25, ZK 8604, me sipërfaqe 1314,2 metër katrorë, e llojit pyll. Kjo pasuri ka kaluar në favor të shtetasit Artur Shehu, përmes kontratës së shkëmbimit nr. 1080 rep dhe nr. 612/3 datë 04/12/2014 të lidhur ndërmjet shtetasit Raimond Mëzi dhe shtetasit Artur Shehu, ky i fundit i përfaqësuar nga shtetasi Pullumb Petritaj.
- Në kartelën e pasurisë me numër 41/108/2, vol. 15, faqe 23, ZK 8604, me sipërfaqe 74364,9 metër katrorë, e llojit pyll. Kjo pasuri ka kaluar në favor të shtetasit Artur Shehu, përmes kontratës së shkëmbimit nr. 1080 rep dhe nr. 612/3 datë 04/12/2014 të lidhur ndërmjet shtetasit Raimond Mëzi dhe shtetasit Artur Shehu, ky i fundit i përfaqësuar nga shtetasi Pullumb Petritaj.
- Në kartelën e pasurisë me numër 41/105, vol. 15, faqe 20, ZK 8604, me sipërfaqe 87766,6 metër katrorë, e llojit pyll. Kjo pasuri ka kaluar në favor të shtetasit Artur Shehu, përmes kontratës së shkëmbimit nr. 1080 rep dhe nr. 612/3 datë 04/12/2014 të lidhur ndërmjet shtetasit Raimond Mëzi dhe shtetasit Artur Shehu, ky i fundit i përfaqësuar nga shtetasi Pullumb Petritaj.
- Në kartelën e pasurisë me numër 41/104, vol. 15, faqe 19, ZK 8604, me sipërfaqe 29971,3 metër katrorë, e llojit pyll. Kjo pasuri ka kaluar në favor të shtetasit Artur Shehu, përmes kontratës së shkëmbimit nr. 1080 rep dhe nr. 612/3 datë 04/12/2014 të lidhur ndërmjet shtetasit Raimond Mëzi dhe shtetasit Artur Shehu, ky i fundit i përfaqësuar nga shtetasi Pullumb Petritaj.
- Në kartelën e pasurisë me numër 41/101, vol. 15, faqe 16, ZK 8604, me sipërfaqe 8292 metër katrorë, e llojit pyll. Kjo pasuri ka kaluar në favor të shtetasit Artur Shehu, përmes kontratës së shkëmbimit nr. 1080 rep dhe nr. 612/3 datë 04/12/2014 të lidhur ndërmjet shtetasit Raimond Mëzi dhe shtetasit Artur Shehu, ky i fundit i përfaqësuar nga shtetasi Pullumb Petritaj.
- Në kartelën e pasurisë me numër 47/47, vol. 15, faqe 10, ZK 8604, me sipërfaqe 34225,4 metër katrorë, e llojit pyll. Kjo pasuri ka kaluar në favor të shtetasit Artur Shehu, përmes kontratës së shkëmbimit nr. 1080 rep dhe nr. 612/3 datë 04/12/2014 të lidhur ndërmjet shtetasit Raimond Mëzi dhe shtetasit Artur Shehu, ky i fundit i përfaqësuar nga shtetasi Pullumb Petritaj.
- Në kartelën e pasurisë me numër 47/46, vol. 15, faqe 9, ZK 8604, me sipërfaqe 76662,1 metër katrorë, e llojit pyll. Kjo pasuri ka kaluar në favor të shtetasit Artur Shehu, përmes kontratës së shkëmbimit nr. 1080 rep dhe nr. 612/3 datë 04/12/2014 të lidhur ndërmjet shtetasit Raimond Mëzi dhe shtetasit Artur Shehu, ky i fundit i përfaqësuar nga shtetasi Pullumb Petritaj.
- Në kartelën e pasurisë me numër 41/108/1, vol. 15, faqe 8, ZK 8604, me sipërfaqe 54293,1 metër katrorë, e llojit pyll. Kjo pasuri ka kaluar në favor të shtetasit Artur Shehu, përmes kontratës së shkëmbimit nr. 1080 rep dhe nr. 612/3 datë 04/12/2014 të lidhur ndërmjet shtetasit Raimond Mëzi dhe shtetasit Artur Shehu, ky i fundit i përfaqësuar nga shtetasi Pullumb Petritaj.



- Në kartelën e pasurisë me numër 47/53/3, vol. 31, faqe 107, ZK 8604, me sipërfaqe 54831.8 metër katrorë, e llojit pyll. Kjo pasuri ka kaluar në favor të shtetasit Artur Shehu, përmes kontratës së shkëmbimit nr. 1080 rep dhe nr. 612/3 datë 04/12/2014 të lidhur ndërmjet shtetasit Raimond Mëzi dhe shtetasit Artur Shehu, ky i fundit i përfaqësuar nga shtetasi Pullumb Petritaj.
- Në kartelën e pasurisë me numër 47/45/2, vol. 15, faqe 188, ZK 8604, me sipërfaqe 166188 metër katrorë, e llojit pyll, pasuri e cila vijon në volumnin 47, faqe 12 deri në faqen 14.
- Në kartelën e pasurisë me numër 47/41/1, vol. 31, faqe 231, ZK 8604, me sipërfaqe 120164.3 metër katrorë, e llojit pyll, pasuri e cila është tjetërsuar tek shtetasi Gerian Kuka.
- Në kartelën e pasurisë me numër 47/45/3, vol. 47, faqe 15, ZK 8604, me sipërfaqe 71162.5 metër katrorë, e llojit pyll, pasuri e cila është tjetërsuar tek shtetasi Gerian Kuka dhe Andi Gjikhuri. Ky veprim është kryer mbi bazën e kontratës së shitjes nr. 756 rep dhe nr. 439/3 kol, datë 09/09/2014, sipas së cilës shtetasi Raimond Mëzi, i përfaqësuar nga shtetasi Enkes Hysendhima, u ka shitur sipërfaqen e mësipërme të pronës shtetasve Gerian Kuka dhe Andi Gjikhuri.
- Në kartelën e pasurisë me numër 47/45/4, vol. 47, faqe 13, ZK 8604, me sipërfaqe 70563 metër katrorë, e llojit pyll, pasuri e cila është tjetërsuar tek shtetasi Gerian Kuka. Ky veprim është kryer mbi bazën e kontratës së shitjes nr. 924 rep dhe nr. 520/1 kol, datë 20/10/2014, sipas së cilës shtetasi Raimond Mëzi, i përfaqësuar nga shtetasi Enkes Hysendhima, i ka shitur sipërfaqen e mësipërme të pronës shtetasit Gerian Kuka.
- Në kartelën e pasurisë me numër 47/45/6, vol. 47, faqe 14, ZK 8604, me sipërfaqe 57350.5 metër katrorë, e llojit pyll, pasuri e cila është tjetërsuar tek shtetasi Gerian Kuka. Ky veprim është kryer mbi bazën e kontratës së shitjes nr. 923 rep dhe nr. 519/1 kol, datë 20/10/2014, sipas së cilës shtetasi Raimond Mëzi, i përfaqësuar nga shtetasi Enkes Hysendhima, i ka shitur sipërfaqen e mësipërme të pronës shtetasit Gerian Kuka.
- Në kartelën e pasurisë me numër 47/45/5, vol. 47, faqe 12, ZK 8604, me sipërfaqe 108837 metër katrorë, e llojit pyll, pasuri e cila është tjetërsuar tek shtetasi Gerian Kuka dhe Andi Gjikhuri. Ky veprim është kryer mbi bazën e kontratës së shitjes nr. 757 rep dhe nr. 410/1 kol, datë 09/09/2014, sipas së cilës shtetasi Raimond Mëzi, i përfaqësuar nga shtetasi Enkes Hysendhima, u ka shitur sipërfaqen e mësipërme të pronës shtetasve Gerian Kuka dhe Andi Gjikhuri.

Nga hetimet e kryera rezulton se fillimisht dhe mbi bazën e dokumenteve të falsifikuara është regjistruar në emër të pandehurit Raimond Mëzi pasuria e paluajtshme me sipërfaqe prej 89 Ha. Konkretisht rezulton se kjo pronë është regjistruar mbi bazën e vendimit gjyqësor nr. 2217, datë 29/12/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, vendim i cili rezulton tërësisht i falsifikuar. Nga hetimet e kryera rezulton se e gjithë dosja gjyqësore që i përket vendimit nr. 2217, datë 29/12/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është tërësisht e falsifikuar dhe është futur në arkivën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Gjithashtu rezulton se edhe vendimi nr. 100, datë 19/04/1996 i ish-KKKP-së Bashkia e Qytetit Vlorë, në emër të subjektit

të shpronësuar Jakup Mëzi, si dhe nota e transkriptimit, në favor të shtetasit Jakup Mezi, që janë paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, janë dokumente të falsifikuara. Provohet se pas regjistrimit të pasurisë së mësipërme, janë kryer veprime tjetërsimi dhe shkëmbimi, duke kaluar prona tek të tretët, veprime këto të kryera nga të pandehurit Enkes Hysendhima dhe Raimond Mezi.


Mbi bazën e vendimit të gjykatës, më datën 31/05/2016, është kryer kontrolli i zyrës së avoktit Enkes Hysendhima. Gjatë kontrollit të zyrës janë gjetur dhe sekuestruar dokumente e prova materiale që lidhen me veprën penale. Konkretisht janë sekuestruar disa copa fletësh të grisura, ku nga bashkimi i tyre formohet një çertifikatë për vërtetim pronësie në emër të shtetasës Renata Troqe, një vërtetim nga dokumentet hipotekore në emër të shtetasit Gëzim Bajrami, që mban vulën e noteres Belona Seraj, si dhe një plan rievimi që mban vulën e noteres Belona Seraj. Gjithashtu nga kontrolli i ushtruar në zyrën e avokatit Enkes Hysendhima është sekuestruar kërkesë padia e shtetasve Malo Bodo dhe Isuf Bodo, kundër të paditurve Raimond Mëzi, etj, si dhe të gjitha provat e aktet që i janë bashkëngjitur kësaj padie. Po ashtu, është sekuestruar vendimi gjyqësor nr. 2762, datë 19/12/2005 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, bashkë me aktet përkatëse të dosjes gjyqësore. Ky vendim gjyqësor i përket kërkuesit Isuf Bodo me objekt vërtetimin e faktit juridik të bashkëpronësisë së shtetasve Sadik, Jemin e Shyqyri Bodo, për një sipërfaqe prone prej 315 ha, dhe të një sipërfaqe prone prej 188 ha, që ndodhen në gadishullin e Karaburunit, pra pikërisht për pronën objekt hetimi prej 220 ha. **Nga këto të dhëna provohet bashkëpunimi ndërmjet të pandehurve Raimond Mëzi dhe Enkes Hysendhima.**

Në funksion të hetimit është thirrur dhe pyetur në cilësinë e deklaruësës shtetasja Rezarta Taushani, me detyrë Kancelare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Kjo shtetase ka sqaruar se arkiva e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, administrohet nga arkivistja Donika Besimaj, që nga viti 2008. Në arkivë ndodhen të gjitha dosjet për të cilat ka përfunduar shqyrtimi gjyqësor dhe vendimi ka marrë formë të prerë. Dosjet që futen në arkive regjistrohen në librin e indekseve dhe në librin e arkivës, i cili plotësohet nga kryesekretarja në momentin e dorëzimit të tij, dokumente të cilat administrohen nga arkivistja. Sipas saj, pasi dosjet administrohen në arkive, të gjitha veprimet fizike mbi këto dosje kryhen vetëm nga arkivistja.

Duke marrë në konsideratë sipërfaqen e pronës së përfituar me dokumente të falsifikuara, e cila është një prone prej 220 Ha, që ndodhet në Karaburun-Vlorë dhe një sipërfaqe prone prej 89 Ha, e cila ndodhet në vendin e quajtur "Shen Velash", Zvrenec-Vlorë, të dy këto prona ndodhen në bregdet, si dhe duke marrë parasysh faktin se pjesa më e madhe e kësaj prone është tjetërsuar, del qartë se ndodhemi para pasojës së rëndë në kuptim të nenit 287 të Kodit Penal. Në lidhje me këtë sipërfaqe prone të paluajtshme, me vendimin nr. 257, datë 30/01/2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është caktuar masa e sigurimit sekuestro preventive.

Episodi 3: Regjistrimi i pronës me dokumenta të falsifikuara prej 33 Ha, në vendin e quajtur Palase, Vlorë.

Nga hetimet e kryera rezulton se, i pandehuri Lefter Gjergji në bashkëpunim me të pandehurit Blerina Dhrami dhe Donika Besimaj, ka përfituar nëpërmjet dokumenteve të



falsifikuara një sipërfaqe prone prej 330,000 m² tokë kullotë, pranë bregdetit të Palasës, Himarë, në vendin e quajtur "Adhendra". Më pas, nga viti 2012 e në vijim, pjesën më të madhe të kësaj toke e ka shitur apo dhuruar tek persona të tjerë, me qëllim mbulimin e origjinës së saj të paligjshme. Rezulton e provuar se i pandehuri Lefter Gjergji, me ndihmën e të pandehurës Donika Besimaj, ka arritur që të falsifikojë aktet e dosjes gjyqësore që i përkasin vendimit nr.1568, datë 02.10.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, si dhe ka falsifikuar vendimin nr.1568, datë 02.10.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Provohet se i pandehuri Lefter Gjergji, ka falsifikuar edhe vendimin nr. 168, datë 14.06.2006; nr. 168 prot., datë 19.06. 2006, të Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Qarkut Vlorë. Pas falsifikimit të këtyre dokumenteve, i pandehuri Lefter Gjergji në bashkëpunim me të pandehurën Blerina Dhrami (Brahimi), ka regjistruar pasurinë e mësipërme në regjistrat publik pranë ZVRPP Vlorë, si dhe ka kryer veprime juridike mbi këtë pasuri, me qëllimin e vetëm fshehjen e origjinës së paligjshme të kësaj pasurie.

Nga hetimet paraprake është provuar se, Vendimi nr. 168, datë 14.06.2006; nr. 168 prot., datë 19.06. 2006, i Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Qarkut Vlorë dhe disa nga dokumentet e dosjes së Komisionit të Kthimit të Pronave Vlorë lidhur me këtë vendim, si dhe vendimi gjyqësor i faktit juridik nr.1568, datë 02.10.2003, i Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë dhe dokumente të tjera të kësaj dosje gjyqësore janë të falsifikuar. Me anë të vendimit të falsifikuar të Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Qarkut Vlorë është vendosur: - njohja e së drejtës së pronësisë për subjektin Theotoq Vangjel Gjergji, mbi një sipërfaqe tokë kullotë prej 35 Ha; - si dhe kthimi në natyrë i kësaj sipërfaqe, sipas skicës së planvendosjes bashkëlidhur vendimit.

Falsiteti i vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Vlorë është vertetuar pas ekspertimit të kryer objekteve të ekspertimit lidhur me këtë rast. Bazuar në aktin e ekspertimit tekniko-grafik nr. 3529, datë 21/04/2016 rezulton se në dokumentet: - Vendim nr. 168, datë 14.06.2006, i Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Qarkut Vlorë; - Regjistër i Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Qarkut Vlorë, konkretisht fleta përkatëse ku është evidentuar/regjistruar vendimi nr. 168, datë 14.06.2006; nr. 168 prot., datë 19.06.2006, i Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Qarkut Vlorë; - shkresat nr. 3776/1, datë 18.08.2011 dhe nr. 3776/3, datë 27.09.2011, të Agjencisë së Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Tiranë, drejtuar ZVRPP Vlorë:

- Nënshkrimi në emër të shtetasve Kasem Cenaj, Llambo Dhima, Bledar Dumani, Ervin Demiraj dhe Afroviti Gjipali në Vendimin nr. 168, datë 14.06.2006, të Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Qarkut Vlorë, nuk është nënshkrimi (firmë) i këtyre shtetasve, krahasuar me modelet respektive të nënshkrimeve të tyre në vendimet e Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Qarkut Vlorë (të kësaj periudhe), të përdorura si modele krahasuese;

- Shenja e vulës së njomë rrethore, me përmbajtje teksti: "REPUBLIKA E SHQIPERISE - ZYRA RAJONALE E AKKP - SEKRETARIA - QARKU VLORE", e ndodhur në fundin e faqes së dytë të dokumentit: Vendim nr. 168, datë 14.06.2006, i Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Qarkut Vlorë, objekt ekspertimi, dhe shenjat e vulës së njomë rrethore, me përmbajtje të njëjtë teksti: "REPUBLIKA E SHQIPERISE - ZYRA RAJONALE E AKKP - SEKRETARIA - QARKU VLORE", të ndodhura në disa prej dokumenteve modele

krahasimi, nuk paraqiten të konfiguruar me të njëjtin tonalitet boje dhe nuk janë formuar nga e njëjta klishe vule;

- Nënshkrimi (firma) e ndodhur nën rubrikën "Drejtori i Përgjithshëm - Elvis Çefa" në fund djathtas të dokumenteve "shkresë nr. 3776/1, datë 18.08.2011 dhe shkresë nr. 3776/3, datë 27.09.2011, të Agjencisë së Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Tiranë, drejtuar ZVRPP Vlorë", objekt ekspertimi, paraqiten të konfiguruar (përfutuara) me bojë, nga stampimi i një klisheje me konfiguracionin përkatës, direkt me sipërfaqen e fletës së dokumentit objekt ekspertimi.

Nga dokumentat e administruara prej Agjencisë së Trajtimit të Pronave Tiranë lidhur me këtë pronë, provohet gjithashtu se, sipërfaqja e pronës që është njohur dhe kthyer me vendimin e mësipërm të Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Qarku Vlorë, nuk përputhet me sipërfaqen e pronës të evidentuar/regjistruar si të njohur dhe kompesuar sipas këtij vendimi në librin e vendimeve të Komisionit Vendor të K.K.Pronave Vlorë. Në rreshtin e librit që është regjistruar vendimi nr. 168, datë. 14.06.2006, i Komisionit Vendor të K.K.Pronave, shënohet se shtetasit Theotoq Gjergji i është njohur sipërfaqja e llojit "kullotë" prej 5 ha dhe kompesuar sipërfaqja prej 5 ha, por jo kthyer kjo sipërfaqe dhe aq më pak njohur dhe kthyer sipërfaqja prej 35 ha që rezulton në vendim të Komisionit Vendor të K.K.Pronave Vlorë.

Nga hetimi provohet se libri i mbledhjeve të protokollit të Këshillit të Bashkisë Himarë është sekuestruar më datë 18/09/2015 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, në kuadër të procedimit penal nr. 1946 të vitit 2014. Nga këqyrja e librit të protokollit të mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Himarë, i cili është sekuestruar me procesverbalin e datës 18/09/2015, rezulton se nga Këshilli i Bashkisë Himarë, në mbledhjen e datës 31/01/2003 është marrë në shqyrtim edhe kërkesa e paraqitur nga shtetasi Theotoq Gjergji. Referuar procesverbalit të kësaj mbledhje rezulton se në rubrikën "Aprovim i sip për Kullota" është përshkruar se: "-Theotoq Gjergji 3.2 Ha Palasë, Aprovohet". Nga kjo e dhënë del qartë se shtetasi Theotoq Gjergji është trajtuar vetëm me 3.2 Ha kullote dhe se të gjitha dokumentet e dala nga Bashkia Himarë në të cilat është pasqyruar sipërfaqja prej 35 ha kullotë janë të falsifikuara.

Krahas kësaj, nga dokumentacioni i dosjes së Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Vlorë me vendim nr. 168, datë 14.06.2006, konstatohet se, kërkesa për kthimin dhe kompesimin e pronës është paraqitur pranë këtij Komisioni me datë 15.12.2005, në emër të shtetasit Theotoq Vangjel Gjergji. Bashkë me kërkesën rezulton të jetë dorëzuar në emër të këtij shtetasi çertifikata e lindjes/personale e shtetasit Theotoq Gjergji; - Vendimi nr. 1568, datë 02.10.2003, i Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, shoqëruar me një akt njoftunie zotnimi të datës 30.01.1939, në emër të Gjykatës së Paqit Himarë, si dhe planvendosjen e pronës së pretenduar nga shtetasi Theotoq Gjergji, përgatitur nga topografi Ervin Demiraj, etj. Vendimi gjyqësor, harta e pronës së pretenduar dhe akt njoftunia rezulton të jene shërbyer nga Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë, pasi mbajnë vulën e arkivistet Donika Besimaj, kancelarit Albert Pashaj, pullat e takës dhe vulën e Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë. Provohet se ky vendim gjyqësor është fotokopjuar nga vendimi i ndodhur në dosjen gjyqësore, pasi kanë dalë shenjat e kapsave që është kapur edhe ne dosje, duke i vendosur më pas një vulë "Vendimi mori formë

të prere pasi nuk u ankimua - Kancelare”, çka nuk është e vendosur në vendimin e administruar në dosjen gjyqësore.

Bazuar në aktin e ekspertimit tekniko-grafik nr. 6495, datë 20/06/2017, të kryer edhe në lidhje me kërkesën e paraqitur për kthimin dhe kompesimin e pronës më datë 15.12.2005, në emër të shtetasit Theotoq Vangjel Gjergji, rezulton se:

Nënshkrimi (firma) e ndodhur në të djathtë dorëshkrimit të emër mbiemrit “THEOTAQ GJERGJI” që ndodhet në të djathtë rubrikës “Nënshkrimi i Kërkuesit”, tek dokumenti “KERKESE PER KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONES” Formular TIP 1, Nr. 187 Prot, datë 15/12/2005, në emër të kërkuesit Theotoq Gjergji, drejtuar Komisionit Vendor të K.K.P. Qarku Vlorë objekt ekspertimi, është nënshkrim (firmë) e shtetasit Lefter Gjergji, krahasuar me modelet respektive të paraqitura.

Nga hetimi provohet se në vendimin gjyqësor nr. 1568, datë 02.10.2003, të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, është pasqyruar sikur është vendosur: “Pranimi i kërkesës së kërkuesit Theotoq Gjergji; - Vërtetimi i faktit juridik të pronësisë së shtetasit Theotoq Gjergji mbi një sipërfaqe prej 35 hektarë, ndodhur në vendin e quajtur Dhrale, në fshatin Palase, Bashkia Himare, me këto kufizime: Veriu – Rrugë Fshati, Jugu – Deti Jon, Lindja – Musha, Perëndimi – Përroi; - Rivendosjen në afat të së drejtës së kërkuesit Theotoq Gjergji për t’ju drejtuar Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave ish Pronarëve pranë Prefektit Vlorë”. Nga sekuestrimi i dosjes së vendimit gjyqësor të vërtetimit të faktit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, si dhe pyetja e sekretares gjyqësore të çështjes Aurela Abazaj, rezulton se një pjesë e akteve të këtij fashikulli gjyqësor, përfshirë edhe vendimin gjyqësor janë të falsifikuara. Shtetasja Aurela Abazaj ka mohuar nënshkrimin e saj tek vendimi gjyqësor, ka mohuar dorëshkrimin dhe nënshkrimin e saj tek fleta e fundit e procesverbalit të seancës gjyqësore datë 02.10.2003 që mban numrin e fletës 22 të dosjes, ka mohuar dorëshkimin e numërtimit të fletëve të fashikullit të dosjes nga faqja 11 – 26. Pra, rezulton se janë hequr akte nga dosja gjyqësore dhe janë futur akte të falsifikuara. Gjithashtu, nga këqyrja e fletëve të procesverbalit të seancës gjyqësore datë 02.03.2003, të vetëpranuar si të dorëshkuara nga shtetasja Aurela Abazaj, konstatohet se, objekti i padisë ka qenë “*Vërtetim i faktit juridik të qënies pronar mbi një sipërfaqe kullotë prej 5 ha dhe rivendosjen në afat të së drejtës për të paraqitur dokumentet pranë k.k.k të pronave të ish pronarëve Vlorë*”. Në seancë gjyqësore rezulton te kete marrë pjesë edhe shtetasi Kristofor Rexho, me cilësinë e perfaqësuesit të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Vlorë. I pyetur ky shtetas me cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, ka deklaruar se gjatë gjykimit të zhvilluar është paraqitur në seancë gjyqësore shtetasi Lefter Gjergji. Ky shtetas ka deklaruar në vijim se shtetasi Lefter Gjergji, i ka vënë në dispozicion hartat e sipërfaqes prej 5 Ha, në vendin e quajtur Dhrale, por asnjëhere për sipërfaqen prej 35 Ha. Edhe gjyqi i zhvilluar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë ka qene për vërtetimin e faktit juridik të pronësisë prej 5 Ha dhe jo 35 Ha. Gjithashtu, nga përmbajtja e vendimit gjyqësor, konstatohet se ky vendim është bazuar ndër të tjera në: - Vendimin e pleqësisë së fshatit Palasë; Vendimin nr. 44, datë 26.05.2003 të Këshillit Bashkiak Himarë, etj. Në fashikullin e dosjes gjyqësore bëjnë pjesë edhe këto dokumente: - kerkesa në emër të shtetasit Theotoq Gjergji, drejtuar Kryesisë së Fshatit Palasë; - procesverbali pa datë për shqyrtimin e kërkesës së shtetasit Theotoq Gjergji, nënshkruar nga katër anëtare dhe Kryeplaku i Pleqësisë së Fshatit Palasë; - vërtetim pa datë i kryeplakut të fshatit Palasë ; - vërtetim pa datë i



Komisionit të Verifikimit të Pronësisë pranë Bashkisë Himarë, nënshkruar në emër të tre anëtarëve; - vendimi nr. 44, datë 26.05.2003, i Këshillit të Bashkisë Himarë për njohjen e pronësisë së pyllit kullotë për shtetasin Theotoq Gjergji; - akt njoftunie zotenimi datë 30.01.1939, e Gjykatës së Paqit Himarë (cituat më lart). Këto dokumente vérehet me sy të lirë që kanë ndërhyrje korigjuese me fshirje me korrektor të sipërfaqes së pronës së pretenduar dhe njohur sipas këtyre akteve të Pleqësisë/Këshillit Bashkiak Himarë për shtetasin Theotoq Gjergji. Më tej, nga këqyrja e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Himarë, kryer prej Policisë Gjyqësore, nuk rezulton të jete marrë ndonjë vendim i tillë me numrin dhe datën që përmban ky vendim. Sa i përket akt njoftuni zotenimi datë 30.01.1939, të Gjykatës së Paqit Himarë, rezulton se, nuk përmendet në pjesën arsyetuese të vendimit gjyqësor. Megjithatë, nga përmbajtja e kësaj akt njoftunie zotenimi, del se, në zyrën e Gjyqit të Paqit Himarë, para gjyqtarit Halim Kolonja, asistuar prej kryesekretarit Mihal Rexho dhe në prani të kërkuesit Theotoq Gjergji, është vërtetuar me deshmitarë se shtetasi Theotoq Gjergji (*vetëm shtatë vjeç çuditërisht*) zotëronte një kullotje 35 vreten, me kufizimet përkatës të cituara në vendimin e gjykatës.

Nga hetimi rezulton e provuar se edhe vendimi gjyqësor nr. 1568, datë 02.10.2003, i Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, aktet e administruara në këtë dosje gjyqësore, si dhe procesverbalet e seancave gjyqësore, janë falsifikuar. Bazuar në aktin e ekspertimit tekniko-grafik nr. 6495, datë 20/06/2017, të kryer edhe në lidhje me aktet dhe dokumentet që ndodhen në dosjen e mësipërme gjyqësore rezulton se:

- Tek 5 (pesë) prej dokumenteve, ndodhur të listuara në dosjen gjyqësore të sipërcituar objekt ekspertimi, konstatohen ndërhyrje. Ndërhyrjet evidentohen tek:
- Plotësimet aktuale të shifrave “35”, të ndodhura në rreshtin e dytë të tekstit në pjesën e sipërme dhe përkatësisht në rreshtin e parë dhe kolonën e tretë të plotësimeve tek tabela në mes të dokumentit, si dhe tek plotësimet e fjalës aktuale “TRIDHJETE E PESE”, të ndodhura në rreshtin e dytë të tekstit në pjesën e sipërme të dokumentit të listuar me nr. 5, të emërtuar “KERKESE”, pa datë, drejtuar Kryepleqësisë së fshatit Palasë, në emër të kërkuesit Theotoq Gjergji objekt ekspertimi.
- Plotësimet aktuale të shifrave “35”, si dhe tek plotësimet e fjalës aktuale “TRIDHJETE E PESE”, të ndodhura në rreshtin e dytë të tekstit poshtë rubrikës “VENDOSI” në pjesën e poshtme të dokumentit të listuar me nr. 6, të emërtuar “PROCES VERBAL”, pa datë, mbajtuar nga Kryepleqësia e fshatit Palasë, për njohjen e z. Theotoq Gjergji pronarë të një kullote prej 35 Ha.
- Plotësimet aktuale të shifrave “35”, të ndodhura në rreshtin e tretë të tekstit në pjesën e sipërme dhe përkatësisht në rreshtin e parë dhe kolonën e tretë të plotësimeve tek tabela në mes të dokumentit, si dhe tek plotësimet e fjalës aktuale “TRIDHJETE E PESE”, të ndodhura në rreshtin e tretë të tekstit në pjesën e sipërme të dokumentit të listuar me nr. 7, të emërtuar “VERTETIM”, pa datë, në emër të Kryeplakut të fshatit Palasë, për pasjen në pronësi nga shtetasi Theotoq Gjergji, të një kullote prej 35 Ha, para reformës agrare.
- Plotësimet aktuale të shifrave “35”, si dhe tek plotësimet e fjalës aktuale “TRIDHJETE E PESE”, të ndodhura në rreshtin e fundit të tekstit, tek dokumenti i listuar me nr. 8, i emërtuar “VERTETIM”, pa datë, lëshuar nga komisioni i verifikimit të pronësisë, pranë


- Bashkisë Himarë, për shtetasin Theotoq Gjergji, si pronarë ose trashëgimtar i një kullote prej 35 Ha.
- Plotësimet aktuale të shifrave "35", si dhe tek plotësimet e fjalës aktuale "TRIDHJETE E PESE", të ndodhura në rreshtin e parafundit të tekstit, tek dokumenti i listuar me nr.9, i emërtuar "VENDIM Nr. 44, datë 26/05/2003", datë 26/05/2003, lëshuar nga Këshilli i Komunës, pranë Bashkisë Himarë, për shtetasin Theotoq Gjergji, si pronarë ose trashëgimtarë i një kullote prej 35 Ha, në vendin e quajtur Dhrale.
 - Ndërhyrjet konsistojnë:
 - Për shifrat "35" të sipërcituara, tek secili prej 5 (pesë) dokumenteve të listuara me nr.5, nr.6, nr.7, nr.8 dhe nr.9, në dosjen e sipërcituar objekt ekspertimi, ndërhyrjet konsistojnë në shtesën me mjet shkruar me tonalitet boje ngjyrë të zezë, të shifrave aktuale të para "3", përpara konfiguracionit të shifrave të mëparshme "5" (të cilat paraqiten sikundër rekuizitat dhe plotësimet e tjera të secilit dokument, të riprodhuara me anën e fotokopjimit), duke konfiguruar shifrat aktuale të sipërfaqes së kullotës, në vlerën "35".
 - Për fjalët "TRIDHJETE E PESE" të sipërcituara tek secili prej 5 (pesë) dokumenteve të listuara me nr.5, nr.6, nr.7, nr.8 dhe nr.9, në dosjen e sipërcituar objekt ekspertimi, ndërhyrjet konsistojnë në mbulimin me një shtresë të ngurtë të bardhë (si ajo e korrektorit) të plotësimit të fjalëve të mëparshme (të cilat rezultojnë me përmbajtje "PESE") dhe dorëshkrimin mbi to e në vijim djathtas secilës prej tyre, me mjet shkruar me tonalitet boje ngjyrë të zezë, të fjalëve aktuale "TRIDHJETE E PESE".
 - Dorëshkrimet e fjalëve me përmbajtje aktuale "TRIDHJETE E PESE", të ndodhura tek secili prej 5 (pesë) dokumenteve të listuara me nr.5, nr.6, nr.7, nr.8 dhe nr. 9, në dosjen e sipërcituar objekt ekspertimi, janë shkruar nga i njëjti person.
 - Tek dokumenti Indeksi i volumit të vendimeve civile të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë (që fillon me nr. 1501 vendimi, datë 23/09/2003 dhe përfundon me nr. 1600 vendimi, datë 07/10/2003), objekt ekspertimi, konstatohen ndërhyrje, të cilat konsistojnë në:
 - Hapjen apo ndarjen apo shkëputjen e brinjëve të majta vertikale të dokumenteve, me sipërfaqen e brendshme të bordurës së kapakut të dokumentit (paraprakisht të ngjitura midis tyre), evidentuar si ndërhyrje, në faqen e brendshme të kapakut të pasëm të dokumentit objekt.
 - Ndarjen apo shkëputjen e grup dokumenteve të gjysmës së dytë të dokumenteve të listuara në Indeks të volumit të vendimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë objekt ekspertimi, me nisje nga dokumenti "VENDIM", Nr. 1103 Regj. Themeltar, Nr. 1569 Vendimi, datë 03/10/2003, i Gjyqtare Klodiana Gjyzari, në Gjykatën e Rrethit Vlorë objekt ekspertimi, deri në dokumentin e fundit të listuar në të dhe më tej, ndarjen apo veçimin e secilit prej tyre nga ky grup.
 - Ribashkimin e grup dokumenteve të gjysmës së dytë të dokumenteve të listuara në Indeks të volumit të vendimeve civile të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë objekt ekspertimi, me nisje nga dokumenti "VENDIM" Nr. 1812 Regjistri, Nr. 1568 Vendimi, datë 02/10/2003, i Gjyqtarit Shkelzen Selimi, në Gjykatën e Rrethit Vlorë objekt ekspertimi, deri në dokumentin e fundit të listuar në këtë grup dokumentesh, me grup dokumentet e listuara përpara dokumentit "VENDIM" Nr. 1812 Regjistri, Nr. 1568 Vendimi, datë 02/10/2003 i Gjyqtarit Shkelzen Selimi, në Gjykatën e Rrethit Vlorë objekt ekspertimi.

- Nënshkrimi (firma) në emër të gjyqtarë Shkelzen Selimi, ndodhur tek rubrika “GJYQTAR-Shkelzen SELIMI”, në ekzemplarin e dokumentit të sipërcituar objekt ekspertimi, paraqitur i listuar me nr. “25-26”, në fundin e dosjes gjyqësore Nr. Regj. Them. 1812, datë regjistrimi 10/09/2003 dhe Nr. Vendimi 1568, datë 02/10/2003, të Gjykatës së Rrethit Vlorë, me paditës Theotoq Gjergji dhe të paditur Bashkia Himarë, etj, objekt ekspertimi është i falsifikuar. Falsifikimi konsiston në plotësimin paraprak të elementëve konfigurativ të këtij nënshkrimi (firme) me vija me laps plumbi, e më tej rishkrimin e tyre me mjet shkruar me tonalitet boje ngjyrë blu.
- Nënshkrimi (firma) në emër të Gjyqtar Shkelzen Selimi, ndodhur tek rubrika “GJYQTAR-Shkelzen SELIMI”, në ekzemplarin e dokumentit të sipërcituar objekt ekspertimi, paraqitur i listuar në dokumentin Indeksi i volumit të vendimeve civile të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë (qëfillon me nr. 1501 vendimi, datë 23/09/2003 dhe përfundon me nr. 1600 vendimi, datë 07/10/2003) objekt ekspertimi, nuk është nënshkrim (firmë) i/e Gjyqtar Shkelzen Selimi, krahasuar me modelet e paraqitura në emer të tij.
- Tek dosja gjyqësore me Nr.Regj.Them. 1812, datë regjistrimi 10/09/2003 dhe Nr. Vendimi 1568, datë 02/10/2003 të Gjykatës së Rrethit Vlorë me paditës Theotoq Gjergji dhe të paditur Bashkia Himarë, etj, -Nënshkrimet (firmat) në emër të Gjyqtarë Shkelzen Selimi të ndodhura në këndin e djathtë të poshtëm të faqes së pasme dhe të faqes së pasme të dokumentit të listuar me nr. 23, objekt ekspertimi, si dhe poshtë printimit të rekuizitës “GJYQTARI Shkelzen SELIMI”, në pjesnë e poshtme të dokumentit të listuar me nr. 24, objekt ekspertimi, janë të falsifikuara. Falsifikimi konsiston në plotësimin paraprak të elementëve konfigurativ të secilit prej tyre me vija me laps plumbi, e më tej rishkrimin e tyre me mjet shkruar me tonalitet ngjyrë blu.
- Nënshkrimi (firma) në emër të Gjyqtar Shkelzen Selimi, e ndodhur poshtë dorëshkrimit të rekuizitës “Gjyqtari-Shkelzen Selimi”, në fund djathtas faqes se pasme të dokumentit të listuar me nr. 22, në dosjen e sipërcituar objekt ekspertimi, nuk është nënshkrim (firmë) i/e Gjyqtar Shkelzen Selimi, krahasuar me modelet e paraqitura në emer të tij.
- Dy nënshkrimet (firmat) në emër të shtetases Aurela Abazaj, të ndodhura tek rubrikat “SEKRETARE- Aurela ABAZAJ”, në ekzemplarin e dokumentit “VENDIM”, Nr. 1812 Regjistri, Nr. 1568 Vendimi, datë 02/10/2003, i Gjyqtarit Shkelzen Selimi, në Gjykatën e Rrethit Vlorë objekt ekspertimi, paraqitur i listuar me nr. “25-26” në fundin e dosjes gjyqësore me Nr. Regj. The. 1812, datë regjistrimi 10/09/2003 dhe Nr. Vendimi 1568, datë 02/10/2003, të Gjykatës së Rrethit Vlorë, me paditës Theotoq Gjergji dhe të paditur Bashkia Himarë, etj, objekt ekspertimi, nuk janë nënshkrime (firma) të shtetases Aurela Abazaj, krahasuar me modelet respektive të paraqitura.
- Nënshkrimi (firma) në emër të shtetases Aurela Abazaj, të ndodhur tek rubrika “SEKRETARE - Aurela ABAZAJ”, në dokumentin “VENDIM”, Nr. 1812 Regjistri, Nr. 1568 Vendimi, datë 02/10/2003, i Gjyqtarit Shkelzen Selimi, në Gjykatën e Rrethit Vlorë objekt ekspertimi, paraqitur i listuar në dokumentin Indeksi i volumit të vendimeve civile të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë (që fillon me nr. 1501 vendimi, datë 23/09/2003 dhe përfundon me nr. 1600 vendimi, datë 07/10/2003) objekt ekspertimi, nuk është nënshkrim (firmë) i/e shtetases Aurela Abazaj, krahasuar me modelet respektive te paraqitura.

- Shenja e vulës në formë tre rreshta mbishkrimesh, me tonalitet boje ngjyrë blu dhe me përmbajtje teksti “Vendimi mori forme te prere pasi nuk u ankimua KANCELARE”, e ndodhur në faqen e pasme të fletës së dytë të dokumentit “VENDIM”, Nr. 1812 Regjistri, Nr. 1568 Vendimi, datë 02/10/2003, i Gjyqtarit Shkelzen Selimi, në Gjykatën e Rrethit Vlorë objekt ekspertimi, ndodhur i listuar në dokumentin Indeksi i volumit të vendimeve civile të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë (që filon me nr. 15001 vendimi, datë 23/09/2003 dhe përfundon me nr. 1600 vendimi, datë 07/10/2003), objekt ekspertimi, është i falsifikuar. Falsifikimi konsiston në përfitim të kësaj shenje vule, nëpërmjet vizatimit me mjet shkruar me dorë.
- Dokumenti i paraqitur në dy faqet e shtatë fletëve vijuese, me nisje në fletën e parë të listuar me nr. 16 (me nr. faqesh “1-2”), deri në fletën e listuar me nr. 22 (me nr. faqesh “13-14”), në dosjen e sipërcituar, në vetvete paraqitet si “Proces-Verbal” i seancës gjyqësore të datës 02/10/2003.
- Dorëshkrimet e plotësuar në dy faqet e gjashtë fletëve vijuese të para, me nisje në fletën e parë të listuar me nr. 16 (me nr. faqesh “1-2”), deri në fletën e listuar me nr. 21 (me nr. faqesh “11-12”), të dokumentin “Proces-verbal” i seancës gjyqësore të datës 02/10/2003 dhe dorëshkrimet e plotësuar në dy faqet e fletës së fundit të listuara me nr. 22 (me nr. faqesh “13-14”), të të njëjtit dokument “Proces-verbal” i seancës gjyqësore të datës 02/10/2003, ndodhur në dosjen gjyqësore objekt ekspertimi, nuk janë shkruar me të njëjtin mjet shkruar dhe nuk janë shkruar nga i njëjti person.
- Dorëshkrimet e plotësuar në dy faqet e fletës së fundit të listuara me nr. 22 (me nr. faqesh “13-14”), të dokumentit “Proces-verbal” i seancës gjyqësore të datës 02/10/2003, ndodhur në dosjen objekt ekspertimi, nuk janë shkruar nga shtetasja Aurela Abazaj, krahasuar me modelet e paraqitura.
- Dokumenti i listuar me nr. 17, në dosjen e sipërcituar objekt ekspertimi, në vetvete paraqitet si fleta e dytë e “Proces-verba”-it të seancës gjyqësore të datës 02/10/2003. Rreshti i 10 (dhjetë) i dorëshkrimeve në faqen e parme të fletës së listuar me nr. 17 (me nr. faqesh “3-4”) paraqitet me përmbajtje: “-faqe toke kullote prej 35ha”.
- Shifra e parë “3” tek plotësimi i numrit “35” në fund të plotësimeve të rreshtit të 10 (dhjetë) dhe tërësia e plotësimeve të tjera në të njëjtin rresht (përfshi dhe shkrimin e shifrës “5” të të njëjtit numër “35”), në faqen e parme të fletës së listuar me nr. 17 (me nr. faqesh “3-4”), në dosjen e sipërcituar objekt ekspertimi, nuk janë shkruar me të njëjtin mjet shkruar.
- Shifra e parë aktuale “3”, tek plotësimi i numrit “35”, në fund të plotësimeve të rreshtit të 10 (dhjetë) të sipërcituar, paraqitet në formën e një shifre të shtuar në vendodhjen aktuale, me mjet shkruar tjetër.

Sipas çertifikatës së lindjes datë 06.12.2005, lëshuar nga Bashkia Himarë, shtetasi Theotoq Gjergji është i biri i Vangjel dhe Angjello, lindur me datë 25.07.1932, në Palasë, Himarë. Ky shtetas është i ati i të pandehurit Lefter Gjergji.

Gjithashtu, nga këqyrja e dosjes së Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Vlorë, konstatohet se, pjesë e saj janë edhe këto dokumente: - Paraqitja grafike e pronës së pretenduar nga shtetasi Theotoq Gjergji, me porositës familja Gjergji, përgatitur nga teogjeodet Ervin Demiraj; - kërkesë për konfirmimin e gjendjes së pronës nr. 552 prot. dhe nr. 553 prot. datë 23.01.2006 të Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Vlorë drejtuar ZVRPP



Vlorë dhe Drejtorisë së Shërbimit Pyjor; - dy shkresa të ZVRPP Vlorë me numër protokollit dhe datë të njëjtë nr. 89/1 prot., datë 14.02.2006, por me përmbajtje të ndryshme; - projekt vendimi (i ndërmjetëm) pa datë i KKKP Qarkut Vlorë, sipas të cilit është vendosur të shtyhet afati i shqyrtimit të kërkesës bazuar në vendimin e K.Sh.K.K.P. nr. 27, datë 24.02.2006 deri me datë 15.06.2006 (relator rezulton anëtari i komisionit Ervin Demiraj); - njoftimi datë 21.06.2006, i Kryesisë së Fshatit Gjilekë drejtuar KVKKP Vlorë (nënshkruar nga kryetari Marko Daffla), sipas të cilit, është njoftuar se Përroi Delta Palasë, në juridiksion të Bashkisë Himarë është monument kulture dhe si i tillë nuk duhet të kthehet asnjë pronë brenda territorit të përroit. Bashkëlidhur këtij njoftimi është edhe kopja e VKM-së nr. 676, datë 20.12.2002 "Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shiptare", si dhe fletë lidhja përkatëse, që përcakton monumentet brenda territorit të Prefekturës Vlorë, ku përfshihet si monument i natyrës shqiptare edhe Përroi Delta Palasë.

Nga këqyrja dhe marrja pranë ZVRPP Vlorë e praktikës së shkresës nr. 552 prot., datë 23.01.2006 të Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Vlorë drejtuar ZVRPP Vlorë, me të cilën është përcjellë për konfirmim edhe harta e gjendjes juridike të pronës së pretenduar në emër të subjektit Theotoq Gjergji, rezulton e provuar se nuk bëhet fjalë për njëjtën pronë të evidentuar në paraqitjen grafike e pronës së pretenduar nga shtetasi Theotoq Gjergji, me porositës familja Gjergji, përgatitur nga teogjeodet Ervin Demiraj. Harta e pronës së pretenduar bën fjalë për një sipërfaqe shumë më të vogël prone dhe jo në të njëjtin vendndodhje me pronën që evidentohet në hartën e përgatitur nga shtetasi Ervin Demiraj, çka është konfirmuar edhe nga ky i fundit. Pra edhe në këtë rast konstatohet qartë se janë hequr dokumente nga dosja e komisionit të kthimit të pronave për subjektin Theotoq Gjergji dhe janë futur dokumente të falsifikuara.

Shtetasi Ervin Demiraj ka deklaruar se ka hartuar "Paraqitjen grafike të pronës së pretenduar nga shtetasi Theotoq Gjergji, me porositës familjen "Gjergji", pjesë e dosjes së Komisionit të Kthimit të Pronave Vlorë dhe dosjes gjyqësore të vërtetimit të faktit juridik. Këtë paraqitje grafike, është shprehur ky shtetas e ka bërë me porosi të shtetasit Lefter Gjergji pas vitit 2007 dhe maksimumi deri në vitin 2011. Sipas tij, paraqitja grafike në fjalë për pronën e pretenduar në emër të shtetasit Theotoq Gjergji, nuk mund të ishte pjesë e dosjes gjyqësore dhe dosjes së kthimit dhe kompesimit të pronave të subjektit të shpronësuar Theotoq Gjergji, pasi është hartuar prej tij në një periudhë të mëvonshme sesa periudha e hartimit të këtyre dosjeve dhe dhënies së vendimit nr. 168, datë 14.06.2006, nga Komisioni Vendor i K.K.Pronave Vlorë. Për më tepër, ky shtetas ka sqaruar, se për rastin e pronës së subjektit Theotoq Gjergji në Komisionin e Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Vlorë, ku ka qene edhe ai anëtar në vitin 2006, është paraqitur një vendim gjyqësor i Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë "vërtetim fakti juridik", shoqëruar me hartë, me vulë lidhëse, që bën fjalë për një pronë tjetër me sipërfaqe 5 Ha, në vendin e quajtur Dhralea, Palasë, Himarë dhe jo për pronën me sipërfaqe 35 Ha, në vendin Adhendra, Palasë, Himarë. Madje, sipas tij, në këtë rast Komisioni i Kthimit të Pronave Vlorë ka vendosur për njohje dhe kompesimin e një sipërfaqe 5 Ha për subjektin Theotagi Gjergji dhe jo për njohje dhe kthim të një sipërfaqe prej 35 Ha kullotë, sikurse është përfutuara me dokumente të falsifikuar më pas.


Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Vlorë janë kërkuar prej Arkivit Qendror Shtetëror Tiranë të dhënat e pronësie që disponohen për shtetasin Theotoq Gjergji për



zonën e Palas, Himarë, etj. Bazuar ne shkresën nr. 1008/1 prot., datë 23.03.2016, të Arkivit Qendror të Shtetit rezulton se: - në emër të shtetasit Theotoq Gjergji nuk diponohen të dhëna pronësie; - akt njoftunie zotenimi datë 30.01.1939, e Gjykatës së Paqit Himarë, nuk është gjetur pranë këtij arkivi; - nga kërkimet e bëra nuk janë gjetur dokumente me nënshkrimet e shtetasve Halim Kolonja dhe M.Rexho (përkatësisht gjyqatar i paqit dhe kryesekretar në Gjykatën e Paqit Himarë), në emër të të cilëve është nënshkruar akt njoftunie zotenimi datë 30.01.1939, Gjykatës së Paqit Himarë, e përdorur pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë dhe Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Vlorë në emër të shtetasit Theotoq Gjergji.

Me vendimin gjyqësore nr. 267, datë 04.05.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë "Për lejimin e kontrollit të vendeve", është ushtrur kontroll në banesën e shtetasit Lefter Gjergji, në Himarë. Nga kontrolli i kryer banesës së shtetasit Lefter Gjergji me datë 04.05.2011, është gjetur një dosje me dokumente pronësie të shtetasit Vangjel Kosta Gjergji, trashëgimtarve Nesturi, etj. Ndër të tjera në këto dokumente bën pjesë edhe vendimi nr. 1034, datë 16.05.2007, i Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë; - prokurë nr. 863 rep., nr. 314 kol., datë 06.03.2007 e shtetasit Theotoq Gjergji; - prokurë e posaçme nr. 1064 kol; nr. 532 rep., datë 02.03.3012, lëshuar nga shtetaset Maria Gjergji, Nikoleta Mailqaj dhe Jonida Gjergji për shtetasin Lefter Gjergji; - vendimi nr. 1568, datë 02.10.2003, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; - shkresat nr. 3776/1, datë 18.08.2011 dhe nr. 3776/3, datë 27.09.2011, të Agjencisë së Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Tiranë, drejtuar ZVRPP Vlorë; - vendimi nr. 168, datë 14.06.2006 i Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Vlorë; - vërtetim nga dokumenti hipotekor datë 10.07.2015; kontratë shitje pasurie e paluajtshme nga shtetasi Lefter Gjergji për shtetasin Gazmend Beqiraj kundrejt vlerës 1,250,000 lekë, etj.

Referuar përmbajtjes së dokumenteve të mësipërme, konstatohet se me vendimin gjyqësor nr. 1034, datë 16.05.2007, të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë është çelur dëshmia e trashëgimisë për shtetasin Theotoq Gjergji, i cili ka vdekur me datë 20.03.2007. Kërkues ka qenë shtetasi Lefter Gjergji dhe trashëgimtarë janë njohur shtetasit Maria Gjergji, bashëshortja, si dhe tre fëmijët e tij Lefter Gjergji, Nikoleta Gjergji (Maliqaj) dhe Jonida Gjergji, me nga ¼ pjesë secili. Me prokurën e posaçme nr. 863 rep., nr. 314 kol., datë 06.03.2007, të lëshuar prej shtetasit Theotoq Gjergji para noterit të Dhomës së Noterisë Vlorë Nefail Islamaj, është emëruar përfaqësues ligjor shtetasi Lefter Gjergji, me porosinë dhe të drejtën për ta përfaqësuar pranë Ministrisë së Drejtësisë, Agjencisë së Kthimit dhe Kompesimit të Pronave dhe Zyrës Qendrore të AKKP-së Tiranë dhe Vlorë, me qëllim për të nënshkruar dhe tërhequr në emrin e tij, dokumentet e plota që kanë të bëjnë me pronat e regjistruara në këtë arkivë qysh në vitet e mëparshme në emër të babit dhe familjes së tij dhe më qëllim për të vazhduar procedurat e mëtejshme ligjore të disponimit të pronës, si dhe për të bërë regjistrimin e kësaj perone dhe marrë certifikatën e pronësisë nga ZVRPP Vlorë, etj. .." Pra, në këtë prokurë nuk bëhet fjalë për ndonjë sipërfaqe prej 35 Ha, sikurse ka përfutuar më pas shtetasi Lefter Gjergji me anë të dokumente të falsifikuara. Me prokurën e posaçme nr. 1064 kol dhe nr. 532 rep., datë 02.03.3012, lëshuar nga shtetaset Maria Gjergji, Nikoleta Mailqaj dhe Jonida Gjergji, para noterit Nefail Islamaj, emërohet prej tyre si përfaqësues shtetasi Lefter Gjergji për menaxhimin e pronave të trashëguara nga babai Theotoq Gjergji, me sipërfaqe 35 Ha, përfshirë dorëzimin e dokumentacionit pranë AKKP Vlorë e Tiranë deri në përfundimin e procesit të njohjes dhe



regjistrimit të pasurisë dhe tërheqjen e akteve përfundimtare, përfshirë edhe disponimin lidhur me këtë pronë në emër të tyre, duke nënshkruara aktet përkatëse.

Pavarësisht sa më lart, me anë të këtyre dokumenteve të falsifikuara të futura në dosjen e vertetimit të faktit juridik me vendim gjyqësor nr. 1568, datë 02.10.2003, të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, si dhe dosjen e Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave nr. 115, datë 15.12.2005, në emër të subjektit Theotoq Gjergji, është regjistruar prona me titull pronësi të falsifikuar në ZVRPP Vlorë, në emër të trashëgimtarëve të shtetasit Theotoq Gjergji.

Nga dokumentet e administruara pranë ZVRPP Vlorë, rezulton se, për regjistrimin fillestar të kësaj prone ka aplikuar shtetasi Arben Ruçi dhe personi i "autorizuar" prej tij Faik Aruni, pa asnjë prokurë të administruar në praktikë. Nga këta shtetas është aplikuar dy herë në vitin 2011 pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, tek specialisti Arlind Limaj, për regjistrimin e pasurisë së mësipërme të njohur dhe kthyer mbi bazën e vendimit nr. 168, datë 19.06.2006, të Komisionit Vendor të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Vlorë, shtetasit Theotoq Gjergji. Aplikimet mbajnë numër 830, muaji 08/2011 dhe nr. 839, muaji 07/2011. Më pas, nga ZVRPP Vlorë mbi bazën e kopjes së vendimit nr. 168, datë 19.06.2006, të Komisionit Vendor të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Vlorë, shoqëruar me kopjen e planvendosjes së pronës, të dërguara nga Agjencia e Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Tiranë me shkresat nr. 3776/1 prot., datë 18.08.2011 dhe nr. 3776/3 prot., datë 27.09.2011, është kryer regjistrimi i pasurisë së mësipërme me sipërfaqe 33 (tridhjetetë) Ha, me hipotekë nr. 84, datë 23.03.2012, zona kadastrale 2863, në emër të shtetasit Theotoq Gjergji. Rezulton se regjistrimi i kësaj pasurie është kryer prej shtetasës Blerina Dhrami (Brahimi), e cila nuk ka qenë specialiste që mbulonte zonën e Palasës, por zonën e Ujit të Ftohtë, Vlorë. Nuk ka asnjë akt të shkruar apo ndonjë dokument të mbajtur për evidentimin e dokumenteve të dorëzuara nga specialisti Arlind Limaj tek specialistja Blerina Dhrami (Brahimi). Shtetasi Arlind Limaj nuk ka shpjeguar rrethanat e marrjes dhe përpunimit të kësaj praktike nga specialistja Blerina Dhrami (Brahimi), kurse shtetasi Eduart Dervishaj, i cili ka qenë Regjistruer i Z.V.R.P.P. Vlorë deri në muajin dhjetor 2011, ka shpjeguar se nuk ka urdhëruar dhe as nuk është në dijeni të kalimit dhe përpunimit të kësaj praktike nga shtetasi Arlind Limaj tek shtetasja Blerina Dhrami (Brahimi), pasi kjo nuk lejohej.

Nga hetimet e kryera, rezulton se para aplikimit në ZVRPP Vlorë për regjistrimin fillestar të kësaj pasurie, Agjencia e Trajtimit të Pronave Tiranë, mbi bazën e kërkesës së shtetasit Arben Ruçi, me shkresën nr. 2146, prot. datë 25.07.2011, i ka dërguar këtij të fundit (Arben Ruçi) dokumentacionin e administruar në dosjen nr. 115, datë 15.12.2005, në emër të subjektit Theotoq Gjergji, të përbërë gjithësej nga 18 fletë. Kopja e këtij dokumentacioni, i cili është dorëzuar pranë ZVRPP Vlorë, është i përbërë nga 22 fletë, pra tre fletë me shumë sesa janë dërguar nga Agjencia e Trajtimit të Pronave shtetasit Arben Ruçi. Kjo rezulton nga shkresa dhe dokumentacioni bashkëlidhur saj, që ZVRPP Vlorë i ka dërguar për konfirmim Agjencisë së Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Tiranë me shkresën nr. 4511 prot., datë 29.07.2011. Këto dokumente kanë dalë nga ZVRPP Vlorë me nënshkrimin e specialistit Arlind Limaj.

Pas regjistrimit, pasuria në fjalë është transkriptuar në regjistrin hipotekor me nr. 85, datë 03.04.2012, në emër të shtetasve Maria Gjergji, Lefter Gjergji, Nikoleta Gjergji dhe Jonida Gjergji. Ky transkript është bërë mbi bazën e aplikimit nr. 103, datë 03.04.2012, të

shtetasit Lefter Gjergji, vendimit gjyqësor nr. 1034, dt. 16.05.2007, të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, me të cilin është çelur dëshmia e trashëgimisë së shtetasit Theotoq Gjergji, i cili ka vdekur me datë 20.03.2007, etj. Sipas këtij vendimi gjyqësor, lidhur me shtetasin Theotoq Gjergji, shtetasja Maria Gjergji është bashkëshortja, shtetasi Lefter Gjergji është i biri dhe shtetaset Nikoleta Gjergji (Maliqaj) dhe Jonida Gjergji janë të bijat. Pranimi i aplikimit është bërë nga specialistja Suela Zotaj dhe përpunimi i praktikës nga specialistja jo e kësaj zone Blerina Dhrami (Brahimi), e cila ka bërë edhe shënimet përkatëse në regjistër. Regjistrimi i kësaj pasurie për trashëgimtarët e shtetasit Theotoq Gjergji është bërë pa administruar asnjë akt/vërtetim pronësie që vërteton pronësinë e këtij këtyre shtetasve mbi pasuritë e shtetasit Theotoq Gjergji dhe pa konfirmuar në Gjykatë dëshminë e trashëgimisë. Megjithatë, sipas akteve të kësaj praktike, shtetasi Lefter Gjergji është emëruar përfaqësues i shtetaseve Maria Gjergji, Nikoleta Maliqaj dhe Jonida Gjergji me prokurën e posaçme nr. 1568 rep dhe nr. 292 kol., datë 02.07.2011, lëshuar para noteres Rajmonda Dyrmishi, Dhoma e Noterisë Tiranë. Sipas kësaj prokure ai është autorizuar për t'i përfaqësuar të tre shtetaset në fjalë për veprimet që lidhen me pasurinë e trashëguar nga shtetasi Theotoq Gjergji, me sipërfaqe 35 Ha, në vendin e quajtur Palase, Himare. Nga ana tjetër, shtetasi Lefter Gjergji, me cilësinë e përfaqësuesit, sipas prokurës së posaçme nr. 3333 rep dhe nr. 1805 kol., datë 07.07.2011, lëshuar para noterit Durim Lekdushi, Dhoma e Noterisë Fier, ka emëruar si përfaqësues shtetasin Arben Ruçi, i biri i Dashamir, lindur me 20.02.1973 dhe banues në Fier, të kryej veprime lidhur me këtë pasuri pranë institucioneve shtetërore dhe ZVRPP Vlorë. Nga sekuestrimi i praktikës së prokurës së lëshuar pranë noterit Durim Lekdushi rezulton se është administruar edhe vendimi nr. 1568, datë 02/10/2003 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, përmes së cilit është vërtetuar fakti juridik i pronësisë së pronarit Theotoq Gjergji mbi një sipërfaqe toke kullote prej 5 Ha, ndodhur në vendin Dhrale, në fshatin Palasë, Bashkia Himarë.


Më pas, nga i pandehuri Lefter Gjergji pasuria është ndarë në 5 (pesë) pjesë, me hipotekë nr. 193 -197, datë 11.06.2012, prej të cilave dy pjesë (nr. 193 – 194) me sipërfaqe 7.5 Ha secila, dy pjesë (nr.195 – 196) me sipërfaqe 2.5 Ha secila dhe një pjesë (nr. 197) me sipërfaqe 13 Ha. Në vijim me pasuritë nene 194, 196 dhe 197 janë kryer transaksione të tjera. Këto pasuri janë shitur, ndarë, dhuruar apo inskriptuar disa herë.

Konkretisht, nga të dhëna e regjistrave dhe dokumenteve hipotekore të administruar, rezulton se, pasuria e regjistruar me nene 84, dt. 23.03.2012, zona kadastrale 2863, me sipërfaqe 33 Ha, e përfituar me dokumente të falsifikuar, kanë derivuar (duke u ndarë, shitur, dhuruar, inskriptuar, etj) pasuritë e poshtëshënuara:

1. Pasuria e regjistruar në nenin 85, datë 03.04.2012, me sipërfaqe 33 hektarë, nga e cila kanë rrjedhur:

- i.** Pasuria e regjistruar ne nenin 193, datë 11.06.2012, me sipërfaqe 7.5 hektarë;
- ii.** Pasuria e regjistruar ne nenin 194, datë 11.06.2012, me sipërfaqe 7.5 hektare;
- iii.** Pasuria e regjistruar ne nenin 195, datë 11.06.2012, me sipërfaqe 2.5 hektarë;
- iv.** Pasuria e regjistruar ne nenin 196, datë 11.06.2012, me sipërfaqe 2.5 hektarë;
- v.** Pasuria e regjistruar ne nenin 197, datë 11.06.2012, me sipërfaqe 13 hektare;

1.1. Nga pasuria nene 194 datë 11.06.2012, me sipërfaqe 7.5 ha, ka rrjedhur pasuria e regjistruar ne nenin 350, datë 16.08.2015, me sipërfaqe 7.5 Ha, dhe nga kjo e fundit kanë rrjedhur pasuritë:



- i. Pasuria e regjistruar ne nenin 65, datë 01.03.2013, me sipërfaqe 5,000 m², nga e cila ka rrjedhur pasuria nr. 714, datë 14.08.2013;
 - ii. Pasuria e regjistruar ne nenin 66, datë 01.03.2013, me sipërfaqe 70,000 m², nga e cila kanë rrjedhur pasuritë: nene 292, datë 04.05.2015, me sipërfaqe 65,000 m²; - nene 293, datë 04.05.2015, me sipërfaqe 5,000 m². Nga pasuria e regjistruar në nenin 292, datë 04.05.2015 ka rrjedhur pasuria nr. 20, datë 03.07.2015 (inskript). Nga pasuria nene 293, datë 04.05.2015, ka rrjedhur pasuria nene 399, datë 30.07.2015 dhe nga kjo e fundit pasuria nene 2, datë 10.03.2016 (inskript).
- 1.2. Nga pasuria nene 196 datë 11.06.2012, me sipërfaqe 2.5 ha, ka rrjedhur pasuria e regjistruar ne nenin 349, datë 16.08.2012, me sipërfaqe 2.5 Ha dhe nga kjo e fundit kanë rrjedhur pasuritë:
- i. Pasuria e regjistruar ne nenin 706, datë 02.08.2013, me sipërfaqe 2 hektarë, e cila është transkriptuar në pasurinë nene 14, datë 08.06.2015;
 - ii. Pasuria e regjistruar në nenin 707, datë 02.08.2013, me sipërfaqe 5,000 m², e cila është transkriptuar në pasurinë nene 767, datë 03.09.2013. Kjo pasuri më tej është transkriptuar në pasuritë me nene 1112, datë 17.12.2013, me sipërfaqe 2,500 m², dhe pasurinë nene 1113, datë 17.12.2013, me sipërfaqe 2,500 m². Pasuria nene 1112, datë 17.12.2013 është transkriptuar më tej në pasurinë nene 1115, datë 17.12.2013 dhe kjo e fundit në pasurinë nene 380 datë 18.11.2014.
- 1.3. Nga pasuria nene 197 datë 11.06.2012, me sipërfaqe 13 ha, kanë rrjedhur pasuritë e mëposhtme:
- i. Pasuria e regjistruar ne nenin 40, datë 03.02.2015, me sipërfaqe 5000 m², e cila është transkriptuar në pasurinë nene 72, datë 23.02.2015;
 - ii. Pasuria e regjistruar ne nenin 41, datë 03.02.2015, me sipërfaqe 5000 m², e cila është transkriptuar në pasurinë nene 58, datë 17.02.2015;
 - iii. Pasuria e regjistruar ne nenin 42, datë 03.02.2015, me sipërfaqe 12 hektarë, e cila është transkriptuar në pasurinë nene 320, datë 01.06.2015 me sipërfaqe 15,000 m² dhe pasurinë nene 321 datë 01.06.2015 me sipërfaqe 10.5 Ha, kjo e fundit inskriptuar në pasurinë nene 15, datë 08.06.2015. Pasuria nene 320, datë 01.04.2015 është transkriptuar në pasurinë 347 datë 08.06.2015.

Nga hetimet rezulton se personat që kanë përfituar nga pasuria e të pandehurit Lefter Gjergji janë shtetasit Renald Kobure, Majlinda Petritaj, Marjo Memaj, Ervin Dalipaj, Gazmend Beqiraj, Andi Gjikhuri, Lulëzim Shusha dhe Nikolin Lleshi. Më konkretisht, pasuria e regjistruar në nene 350, datë 16.08.2012, me sipërfaqe 7.5 Ha i është blere shtetasit Lefter Gjergji nga shtetasi Pëllumb Saliq, sipas kontratës së shitblerjes 05.07.2012, kundrejt vlerës 14,790,000 leke, përkatësisht me 197.2 lek/meter katror. Shtetasi Pëllumb Saliq është kunat i shtetasit Faik Haruni, i cili ka bërë aplikimin për regjistrimin fillestar të pasurisë. Pasuria e regjistruar në nene 349, viti 2012, me sipërfaqe 2,5 Ha, i është blere shtetasit Lefter Gjergji nga shtetasi Renald Kobure, me kontratën e shitblerjes datë 05.07.2012, kundrejt vlerës 4,930,000 leke, përkatësisht me 197.2 lek/meter katror. Në vitin 2013 kjo pasuri është ndarë në dy të tilla dhe pasuria e regjistruar në nene 767, datë 03.09.2013, me sipërfaqe 5,000 m², i është shitur shtetases Majlinda Petritaj, kundrejt çmimit 1,635,000 leke. Më pas, nga kjo pasuri është shitur sipërfaqja prej 2,500 m² për shtetasin Marjo Memaj, kundrejt vlerës 500,000 leke. Me po këtë

çmim, me kontratën e shitblerjes datë 12.11.2014, lidhur para noteres Belona Seraj, pasuria është shitur nga shtetasi Marjo Memaj për shtetasin Ervin Dalipaj. Pasuria e regjistruar në nene nr. 58, viti 2015, me sipërfaqe 5,000 m², i është blere shtetasit Lefter Gjergji nga shtetasi Gazmend Beqiraj, me kontratën e shitblerjes datë 12.02.2015, kundrejt shumës 1,250,000 leke. Pasuria e regjistruar në nene 347, datë 08.06.2015, me sipërfaqe 15,000 m², i është blere shtetasit Lefter Gjergji nga shtetasi Andi Gjikhuri, "Alb – Star" sh.p.k, përfaqësuar nga shtetasi Sadik Ismailaj dhe shtetasja Alma Tafani, kundrejt vlerës 4,000,000 lekë. Pasuria e regjistruar në nene 72, viti 2015, me sipërfaqe prej 5000 m², i është dhuruar shtetasit Lulëzim Shusha nga shtetasi Lefter Gjergji. I pyetur shtetasi Lulëzim Shusha ka deklaruar se me shtetasin Lefter Gjergji nuk ka pasur njohje apo ndonjë mardhenie miqësie. Kjo pasuri i është dhuruar prej tij për të shlyer një borxh që i kishte shtetasi Pellumb Petritaj.

Përsa më lart, duke qënë se titulli i pronësisë: "Vendimi nr. 168, datë 14.06.2006, i Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Qarkut Vlorë", vendimi gjyqësor nr. 1568, datë 02.10.2003, i Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, aktet e administruara në këtë dosje gjyqësore si dhe procesverbalet e seancave gjyqësore janë të falsifikuara, për rrjedhim edhe regjistrimi i pasurisë së paluajtshme pranë Z.V.R.P.P. Vlorë për këtë rast është kryer mbi bazën e dokumentave të falsifikuara. Pra, rezulton e provuar se, me anë të përdorimit të dokumentave të falsifikuara është fituar pronësia e pasurisë së paluajtshme me sipërfaqe totale prej 330.000 m², e cila është regjistruar në nenin 84, datë 23.03.2012, zona kadastrale 2863, të regjistrit hipotekor të Z.V.R.P.P Vlorë, në emër të shtetasit Theotoq Gjergji. Më pas, duke përdorur dokumentet hopotekore të pasurive të ndara dhe regjistruara, të cilat gjithashtu janë me përmbajtje të rreme, pasi kanë prejardhje nga dokumente të falsifikuara (Vendimi nr. 168, datë 14.06.2006, i Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Qarkut Vlorë, etj), është tjetërsuar/transferuar tek persona të tjerë një pjesë e kësaj pasurie të paluajtshme, që është produkt i veprës penale "Falsifikimi i dokumentave", të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, me qëllim fshehjen dhe mbulimin e origjinës së paligjshme të saj/pasurisë, duke fshehur e mbuluar natyrën e vërtetë të burimit.

Duke marrë në konsideratë sipërfaqen e pronës së përfitur me dokumente të falsifikuara, e cila është prone me sipërfaqe prej 330.000 m², tokë kullotë, pranë bregdetit të Palasës, Himarë, në vendin e quajtur "Adhendra", si dhe duke marrë parasysh faktin se pjesa më e madhe e kësaj prone është tjetërsuar, del qartë se ndodhemi para pasojës së rëndë në kuptim të nenit 287 të Kodit Penal. Në lidhje me këtë sipërfaqe prone të paluajtshme, me vendimin nr. 257, datë 30/01/2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është caktuar masa e sigurimit sekuestro preventive.

Mbi bazën e të dhënave të mësipërme provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri Raimond Mëzi, në bashkëpunim me të pandehurit Enkes Hysendhima, Donika Besimaj dhe Blerina Dhrami (Brahimi), ka përfitur, regjistruar dhe tjetërsuar një sipërfaqe prone prej 220 Ha, në vendin e quajtur Karaburun, Vlorë, si dhe një sipërfaqe prone prej 89 Ha, në vendin e quajtur "Shen Velash", Vlorë, me dokumente tërësisht të falsifikuara. Provohet se dokumentet e falsifikuara mbi bazën e të cilës është përfitur kjo pasuri është e gjithë dosja gjyqësore që i përket vendimit gjyqësor civil nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, si dhe e gjithë dosja gjyqësore që i përket vendimit gjyqësor civil nr. 2217, datë 29/12/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Rezulton e provuar se këto dy dosje

gjyqësore dhe aktet e ndodhura në to janë tërësisht të falsifikuara, si dhe janë futur në kundërshtim me ligjin në arkivën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Për të fshehur këtë veprimtari të kundërligjshme, rezulton se të dhënat e pasqyruara në këto dosje gjyqësore janë pasqyruar edhe në tre regjistra që ndodheshin të administruara në arkivën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Konkretisht janë pasqyruar të dhënat e këtyre dosjeve gjyqësore në Regjistrin Civil Themeltar, në Numratorin Civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në Indeks in e Vendimeve Civile të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, regjistra që ndodheshin të arkivuara në mjedise të ndryshme të arkivës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Gjithashtu provohet se edhe dosjet fizike që u përkasin vendimeve të mësipërme të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë janë sistemuar dhe arkivuar në vendin përkatës ku ndodheshin dosjet gjyqësore që i përkisnin muajit dhjetor të vitit 2000 dhe muajit dhjetor të vitit 2003. Rezultoni e provuar se pasi janë falsifikuar dosjet e mësipërme gjyqësore dhe janë bërë pjesë të arkivit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i pandehuri Raimond Mëzi në bashkëpunim me të pandehurit Enkes Hysendhima, Donika Besimaj dhe Blerina Dhrami (Brahimi), ka arritur të regjistrojë pronën e përfituar mbi bazën e dokumenteve të falsifikuara, si dhe ka kryer veprime juridike me qëllim fshejen e origjinës së paligjshme të kësaj prone të paluajtshme. Për rrjedhojë provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri Raimond Mëzi ka konsumuar elementët e veprave penale "Falsifikimi i dokumenteve", të kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", që ka sjellë pasoja të rënda dhe të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 186/2 dhe 287/3 dhe 25 të Kodit Penal.

Bazuar në të dhënat e mësipërme provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri Lefter Gjergji në bashkëpunim me të pandehurat Blerina Dhrami (Brahimi) dhe Donika Besimaj, ka përfituar nëpërmjet dokumenteve të falsifikuara një sipërfaqe prone prej 330,000 m², tokë kullotë, pranë bregdetit të Palasës, Himarë, në vendin e quajtur "Adhendra". Më pas, nga viti 2012 e në vijim, pjesën më të madhe të kësaj toke e ka shitur apo dhuruar tek persona të tjerë, me qëllim mbulimin e origjinës së saj të paligjshme. Rezultoni e provuar se i pandehuri Lefter Gjergji, me ndihmën e të pandehurës Donika Besimaj, ka arritur që të falsifikojë aktet e dosjes gjyqësore që i përkasin vendimit nr.1568, datë 02.10.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, si dhe ka falsifikuar vendimin nr.1568, datë 02.10.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Provohet se i pandehuri Lefter Gjergji ka falsifikuar edhe vendimin nr. 168, datë 14.06.2006; nr. 168 prot., datë 19.06. 2006, të Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Qarkut Vlorë. Pas falsifikimit të këtyre dokumenteve, i pandehuri Lefter Gjergji në bashkëpunim me të pandehurën Blerina Dhrami (Brahimi), ka regjistruar pasurinë e mësipërme në regjistrat publik pranë ZVRPP Vlorë, si dhe ka kryer veprime juridike mbi këtë pasuri, me qëllimin e vetëm fshehjen e origjinës së paligjshme të kësaj pasurie. Për rrjedhojë provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri Lefter Gjergji ka konsumuar elementët e veprave penale "Falsifikimi i dokumenteve", të kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", që ka sjellë pasoja të rënda, parashikuar nga nenet 186/2 dhe 287/3 të Kodit Penal.

Nga të dhënat e mësipërme, rezultoni e provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri Enkes Hysendhima, në bashkëpunim me të pandehurit Raimond Mëzi, Donika Besimaj dhe Blerina Dhrami (Brahimi), ka regjistruar dy pronat e mësipërme pranë ZVRPP Vlorë, si dhe ka kryer veprime juridike mbi këto pasuri, me qëllim fshehjen e origjinës së

paligjshme të tyre. Rezulton e provuar se i pandehuri Enkes Hysendhima, fillimisht ka falsifikuar aktet dhe vendimet e dy dosjeve gjyqësore të mësipërme, të cilat në bashkëpunim me të pandehurit Raimond Mëzi dhe Donika Besimaj, i kanë bërë pjesë të arkivës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Pasi këto dosje dhe vendime gjyqësore tërësisht të falsifikuara, janë pasqyruar sikur ndodheshin në arkivën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, rezulton se e pandehura Donika Besimaj, u ka vënë në dispozicion kopje të këtyre dy dosjeve gjyqësore dhe vendimeve gjyqësore të pandehurve Enkes Hysendhima dhe Raimond Mëzi. Mbi bazën e këtyre dokumenteve tërësisht të falsifikuara, të pandehurit Enkes Hysendhima dhe Raimond Mëzi, në bashkëpunim me të pandehurën Blerina Dhrami (Brahimi), kanë arritur që të regjistrojnë këto dy vendime gjyqësore ne regjistrat publik pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë. Provohet se pasi të pandehurit Enkes Hysendhima dhe Raimond Mëzi, janë pajisur nga e pandehura Blerina Dhrami (Brahimi) me dokumentet vertetim nga dokumentet hipotekor për pasuritë e regjistruara mbi bazën e dy vendimeve gjyqësore tërësisht të falsifikuara, këta të fundit në bashkëpunim me njëri tjetrin kanë tjetërsuar pasurinë e përfituar mbi bazën e dokumenteve të falsifikuara, duke konsumuar veprën penale të parashikuar nga neni 287/3 e 25 të Kodit Penal. Për rrjedhojë provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri Enkes Hysendhima ka konsumuar elementët e veprave penale "Falsifikimi i dokumenteve", të kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", që ka sjellë pasoja të rënda dhe të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 186/2 dhe 287/3 dhe 25 të Kodit Penal.

Bazuar në të dhënat e mësipërme rezulton e provuar se e pandehura Blerina Dhrami (Brahimi), ka regjistruar të tre pasuritë e mësipërme në regjistrat publik pranë ZVRPP Vlorë. Regjistrimi i këtyre pasurive është kryer në kundërshtim me ligjin nr. 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", si dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij. Provohet, se i pandehuri Raimond Mëzi, nuk ka aplikuar ndonjëherë për regjistrimin e dy vendimeve gjyqësore, por për regjistrimin e këtyre vendimeve gjyqësore është përdorur aplikimi i paraqitur më parë nga shtetasi Nesti Bifsha, aplikim i cili nuk ka lidhje me pronën e regjistruar në favor të pandehurit Raimond Mëzi. Gjithashtu, rezulton se e pandehura Blerina Dhrami (Brahimi), ka regjistruar pronën në favor të pandehurit Lefter Gjergji, duke mos qenë specialiste e kësaj zone, si dhe nuk ekziston asnjë akt i shkruar apo ndonjë dokument i mbajtur për evidentimin e dokumenteve të dorëzuara nga specialisti Arlind Limaj tek e pandehura Blerina Dhrami (Brahimi). Nga të gjitha këto të dhëna, del qartë se e pandehura Blerina Dhrami (Brahimi), kishte dijeni se dokumentet e paraqitura si titull pronësie për regjistrimin e pronës, ishin të falsifikuara, por në kundërshtim me ligjin ka regjistruar tre sipërfaqet e pronës objekt hetimi, duke konsumuar elementët e veprës penale "Shpërdorimi i detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Gjithashtu rezulton e provuar se e pandehura Blerina Dhrami (Brahimi), pasi ka regjistruar pasuritë e mësipërme në kundërshtim me ligjin dhe përmes përdorimit të dokumenteve të falsifikuara, ka pajisur të pandehurit Lefter Gjergji, Raimond Mëzi dhe Enkes Hysendhima, me dokumentet vertetim nga dokumentet hipotekorë, në të cilat është pasqyruar pronësia në emër të këtyre shtetasve. Mbi bazën e këtyre dokumenteve të lëshuara nga e pandehura Blerina Dhrami (Brahimi), dokumente në të cilat janë pasqyruar të dhënat e dokumenteve të falsifikuara, të pandehurit Lefter Gjergji, Raimond Mëzi dhe Enkes Hysendhima kanë arritur ta ndajnë dhe më pas ta tjetërsojnë tek personat e tretë, pasurinë e

përfituar me dokumente të falsifikuara. Për rrjedhojë provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se e pandehura Blerina Dhrami (Brahimi) ka konsumuar elementët e veprave penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të kryer në bashkëpunim dhe nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin dhe “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga nenet 186/3 e 25 dhe 248 të Kodit Penal.

Bazuar në të dhënat e mësipërme rezultojnë e provuar se e pandehura Donika Besimaj, në bashkëpunim me të pandehurit Lefter Gjergji, Raimond Mëzi dhe Enkes Hysendhima, kanë falsifikuar aktet e tre dosjeve të mësipërme gjyqësore, duke i bërë pjesë të arkivës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Rezultojnë e provuar se dy dosjet gjyqësore me palë paditëse Raimond Mëzi, janë tërësisht të falsifikuara, dosje të cilat janë falsifikuar nga e pandehura Donika Besimaj në bashkëpunim me të pandehurit Raimond Mëzi dhe Enkes Hysendhima. Provohet se e pandehura Donika Besimaj, ka marrë fletëthirrje nga dosje të tjera të arshivuara në arkivën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të cilat i ka përdoruar për falsifikimin e këtyre dy dosjeve gjyqësore. Ndërsa në lidhje me dosjen gjyqësore me kërkues Theotoq Gjergji, provohet se janë falsifikuar provat dhe aktet e kësaj dosje, si dhe vendimi gjyqësor, dosje e cila ka qenë e administruar në arkivën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Gjithashtu rezultojnë se të tre vendimet gjyqësore të falsifikuara janë administruar prej të pandehurës Donika Besimaj në librin e numratorit të vendimeve, si dhe janë pasqyruar të dhënat e këtyre vendimeve në të gjitha regjistrat përkatës, të cilët ndodheshin të administruara në arkivën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Konkretisht janë pasqyruar të dhënat e këtyre dosjeve në Regjistrin Civil Themeltar, në Numratorin Civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në Indeks të Vendimeve Civile të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, regjistra që ndodheshin të arkivuara në mjedise të ndryshme të arkivës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Gjithashtu provohet se dosjet gjyqësore të falsifikuara janë sistemuar dhe arkivuar në vendin përkatës ku ndodheshin dosjet gjyqësore që i përkisnin muajit dhjetor të vitit 2000 dhe muajit dhjetor të vitit 2003. Me këtë veprim, e pandehura Donika Besimaj ka konsumuar elementët e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Konkretisht këto veprime janë kryer në kundërshtim me ligjin nr. 8436, datë 28/12/1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 7381, datë 08/05/1990 “Për krijimin e Ministrisë së Drejtësisë”, si dhe neni 23 të Urdhërit nr. 1830, datë 03/04/2001 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e rregullore për organizimin dhe funksionimin e administratës gjyqësore”, rregullore e cila ka dalë në zbatim të dy ligjeve të mësipërme. Gjithashtu rezultojnë e provuar se pas falsifikimit të tre dosjeve të mësipërme gjyqësore, e pandehura Donika Besimaj, ka pajisur me kopje të njësuar të akteve të këtyre dosjeve dhe vendimeve gjyqësore përkatëse të pandehurit Lefter Gjergji, Raimond Mëzi dhe Enkes Hysendhima, duke i paraqitur këto dokumente sikur kanë dalë nga Arkiva e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Për rrjedhojë e pandehura Donika Besimaj, ka konsumuar edhe elementët e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve” të kryer më shumë se një herë dhe në bashkëpunim, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal. Sa mësipër provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se e pandehura Donika Besimaj ka konsumuar elementët e veprave penale “Falsifikimi i dokumenteve” të kryer më shumë se një herë dhe në bashkëpunim dhe “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga nenet 186/2 dhe 248 të Kodit Penal.



Nga ana e organit të akuzes pasi janë kryer veprimet hetimore shtetasit Raimond Mëzi, Lefter Gjergji, Enkes Hysendhima, janë akuzuar dhe marrë të pamndehur se kanë kryer veprat penale "Fallsifikimi i dokumentave" kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" që ka sjellë pasoja të rënda dhe në bashkëpunim parashikuar nga nenet 186/2 dhe 287/3 e 25 të Kodit Penal, Blerina Dhrami (Brahimi) e akuzuar se veprat penale "Fallsifikimi i dokumentave" kryer në bashkëpunim dhe nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin dhe "Shpërdorimi i detyrës" parashikuar nga nenet 186/3 dhe 248 të Kodit Penal dhe Donika Besimaj e akuzuar se veprat penale "Fallsifikimi i dokumentave" kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë dhe "Shpërdorimi i detyrës" parashikuar nga nenet 186/2 dhe 248 të Kodit Penal dhe është paraqitur kërkesa për gjykimin e çështjes para gjykatës.

Në përfundim të gjykimit nga ana e akuzës duke vlerësuar të provuara ato janë kërkuar dhe masat përkatëse të dënimit.

Mbrojtja e të pandehurit **Raimond Mëzi** ka kërkuar:

1-Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit për veprat penale për të cilat akuzohet në bazë të nenit 388 pika b e K.Pr.Penale.

2-Nese gjykata e deklaron fajtor dënimin në minimumin që parashikon neni 186/2 i Kodit Penal dhe neni 287/1 i Kodit Penal dhe pezullimin e ekzekutimit të dënimit.

Nga ana e mbrojtjes janë analizuar provat e akuzës në lidhje me fajësinë e të pandehurit.

Nga akt ekspertimet përkatëse rezulton se vendimet gjyqësore Nr.1360 datë 29.12.2000 dhe 2217 datë 29.12.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë janë të fallsifikuar, por nuk provohet fakti se janë fallsifikuar nga shtetasi Raimond Mëzi. Vetëm përfundimi se "nuk përjashtohet që kërkesë padia të jetë nënshkruar nga shtetasi Raimond Mëzi" nuk provon se është nënshkruar prej tij.

Sipas akuzës provohet autorësia e të pandehurit dhe për fallsifikimin e vendimit Nr 100 datë 19.04.1996 të KKK pronave ku është krijuar një vendim tjetër komisioni me të njëjta ekstremite ku është njohur sipërfaqja në favor të Jakup Mëzi në 220 ha kullotë në Karaburun dhe 89 ha kullotë në Shën Vlash.

I pandehuri ka theksuar se ai nuk ka pasur kurrë dijeni për këtë vendim pasi babai i tij kishte autorizura shtetasin Bexhet Mehmeti që të merrej me pronat.

Ai është vënë në dijeni të faktit se pronat e tij mund të kenë origjinë të paligjshme kur me postë ju njoftua padia e Isuf Bodos dhe kontaktoi me avokatin që ta përfaqësonte në gjykim.

Prokuroria e akuzon të pandehurin dhe në lidhje me rregjistrimet e vendimeve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe në ZRPP Vlorë.

Ai nuk ka aplikuar kurrë për rregjistrimin e pronës në ZRPP dhe as ka dijeni si mund të jetë rregjistruar ajo. Aplikimi është bërë në emër të Nesti Bifsha.

Sipas prokurorisë i pandehuri ka tërhequr dokumentat e pronësisë nga ZRPP dhe ka kryer transaksionet përkatëse duke bërë fillimisht pjestimin e pasurisë në 90 ha dhe 130 ha nga të cilat 130 ha i ka shkëmbyer me Artur Shehu dhe 90 ha ja ka shitur subjekteve "House of Arts" dhe "Dixhital netëorks".

Këto veprime janë kryer nga i pandehuri ose përfaqësuesi i tij Av. E Hysendhima, por nuk provon se dhe rregjistrimi është bërë prej tij.



Pasi ai u vu në dijeni të dokumentave nga djali i Bexhetit ka kryer këto veprime para noterit që janë veprime ligjore.

Nga ana e mbrojtjes është cituar vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë Nr 4 datë 15.04.2011 si dhe janë analizuar parashikimet e nenit 186 të Kodit Penal dhe 287 të Kodit Penal.

Në rrethanat kur nuk provohet kryerja e veprës penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal i pandehuri nuk mund të akuzohet për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal

Pasoja e rëndë parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal nuk rezulton e provuar pasi nëse do të konsiderohet se janë dëmtuar personat të cilve ju është shitur prona nga ana e tyre nuk është paraqitur ndonjë kallzim.

Veprimet e kryera nga i pandehuri janë të ligjshme dhe janë regjistruar dhe nuk mund të konsiderohen se janë bërë me qëllim fshehjen e origjinës së pronës me qëllim pastrimi të produkteve të veprës penale.

Nga ana e mbrojtjes në kërkimet përfundimtare është cituar dhe një deklaratë noteriale e të pandehurit ku sipas tij në deklaratimet para opgj ka disa të dhëna që ai nuk i ka thënë.

Deklarata noteriale nuk është administruar nga gjykata,por duke qenë se diskutimi përfundimtar është nënshkruar dhe nga i pandehuri sipas deklarimeve të tij rezulton se:

1.Jakup Mëzi nuk është babai i tij biologjik,por e ka birësuar në moshën 1 vjeç dhe Jakup Mëzi dhe Zubë Mëzi(nëna) kanë vdekur në vitet 1973 dhe 1983).

Jakupi ka pasur prona dhe ai ka përfituar ullahte në vendin e quajtur "Anë e madhe" dhe "Apleme".Ka dhe prona të tjera por nuk i ka gëzuar asnjëherë se janë zaptuar nga persona të tjerë.

Ai ka autorizuar një të njohurin e tij Bexhet Mehmeti të merrej me pronat dhe dokumentat i kishte Bexheti i cili ka vdekur para dy-tre vjetësh dhe ja la te birit Klint Mehmeti. Ja kërkoi disë here dokumenta Klinit dhe fillimisht ai nuk ja dha por më vonë ja dha.

Kishte dëgjuar se babai kishte shumë prona dhe në Karaburun dhe me dokumentat që kishte nga mesi i vitit 2014 ka kontaktuar me av. Enkes Hysendhima.Shkoi aplikoi në ZRPP dhe mori dokumenta origjinale dhe ja dha avokatit vërtetimin e pronësisë për 90 ha me qëllim që ti shiste se kishte borxhe.Avokati e ka njoftuar për veprimet që kryheshin dhe lekët kanë kaluar në llogarinë e tij bankare.Avokati i ka dhënë fillimisht para se të shiteshin pronat rreth 40 milion lekë që të lante borxhet dhe një kredi bankare.

Shumat e lekëve i ka tërhequr pak nga pak dhe ishin rreth 25 milion lekë të reja.


Deklarimet në procesverbalin e datës 20.09.2016 kanë thënie të pavërteta pasi ai ka kërkuar të ishte avokati dhe ai nuk i ka lexuar deklaratimet.

Ai nuk ka aplikuar kurrë pranë ZRPP për regjistrimin e ndonjë vendimi gjykate dhe me pronat është marrë Bexheti.Ai ka aplikuar në vitin 2014.Nuk ka falsifikuar asnjëherë në jetën e tij,por është marrë me punë të ndershme dhe është i pafajshëm.

Mbrojtja e të pandehurit **Lefter Gjergji** ka kërkuar:

1-Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit për veprat penale për të cilat akuzohet në bazë të nenit 388 pika b e K.Pr.Penale.

2-Nese gjykata e deklaron fajtor dënimin në minimumin që parashikon neni 186/2 i Kodit Penal ,gjashtë muaj burgim dhe neni 287/1 i Kodit Penal pesë vjet burgim dhe pezullimin e ekzekutimit të dënimit.



Nga ana e mbrojtjes janë analizuar provat e akuzës në lidhje me fajësinë e të pandehurit.

Nga akt ekspertimet përkatëse rezulton se vendimi gjyqësor Nr.1568 datë 02.10.2003 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe vendimi Nr168 datë 14.06.2006 janë të fallsifikuar, por nuk provohet fakti se janë fallsifikuar nga shtetasi Lefter Gjergji.

Këto akte janë në emër të babait të tij, Theotaq Gjergji

I vetmi aktyt që e lidh të pandehurin me akuzën është deklarimi i shtetasit Ervin Demiraj i cili ka dhënë dy deklarime kontradiktore një herë ka thënë se nuk e mban mend se kush e ka porositur për planvendosjen, kurse pas 15 ditësh ka deklaruar se mban mend që Lefter Gjergji e ka porositur për të kryer planimetritë për këto pasuri.

Vetëm mbi bazën e kësaj prove ai nuk mund të deklarohet fajtor pasi çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit dhe me një provë të vetme praktika gjyqësore ka mbajtur një qëndrim të konsoliduar se nuk mund të deklarohet fajtor.

Nga ana e mbrojtjes janë cituar pjesë nga disa vendime të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë Nr 4 datë 15.04.2011 si dhe janë analizuar parashikimet e nenit 186 të Kodit Penal dhe 287 të Kodit Penal.

Në rrethanat kur nuk provohet kryerja e veprës penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal i pandehuri nuk mund të akuzohet për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal

Pasoja e rëndë parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal nuk rezulton e provuar pasi nëse do të konsiderohet se janë dëmtuar personat të cilve ju është shitur prona nga ana e tyre nuk është paraqitur ndonjë kallzim apo padi civile

Veprimet e kryera nga i pandehuri janë të ligjshme dhe janë regjistruar dhe nuk mund të konsiderohen se janë bërë me qëllim fshehjen e origjinës së pronës me qëllim pastrimi të produkteve të veprës penale.

Mbrojtja e të pandehurit Enkes Hysendhima ka kërkuar:


1-Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit për veprat penale për të cilat akuzohet në bazë të nenit 388/1 pika "b" e K.Pr.Penale pasi fakti nuk përbën veprë penale.

Sipas pretendimeve të organit të akuzës, gjatë hetimeve paraprake është provuar se i pandehuri Enkes Hysendhima në bashkëpunim me të pandehurit Raimond Mezi, Donika Besimaj dhe Blerina Dhrami kanë falsifikuar dhe regjistruar me dokumente të falsifikuara, pronën prej 220 ha, në vendin e quajtur Karaburun, Vlorë si dhe të pronës prej 89 ha në vendin e quajtur Shën Vlash, Vlorë.

Dokumentet e falsifikuara mbi bazën e të cilave janë përfituar këto pasuri janë :

- Vendimi gjyqësor civil Nr. 1360, datë 29/12/2000 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë;
- Vendimi gjyqësor civil Nr. 2217, datë 29/12/2003 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë;
- Dosjet gjyqësore përkatëse të këtyre vendimeve;

Pasi rezulton e provuar se këto dy dosje gjyqësore dhe aktet e ndodhura në to janë tërësisht të falsifikuara, si dhe janë futur në kundërshtim me ligjin në arkivën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.



Për të fshehur këtë veprimtari të kundërligjshme, organi i akuzës ka pretenduar se të dhënat e pasqyruara në këto dosje gjyqësore, janë pasqyruar edhe në tre regjistra që ndodheshin të administruara në arkivën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Konkretisht janë pasqyruar të dhënat e këtyre dosjeve gjyqësore në :

- Regjistrin Civil Themeltar;
- Numërorin Civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë;
- Indeksit e Vendimeve Civile të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë;

Sipas këtij organi, rezulton e provuar se i pandehuri Enkes Hysendhima, fillimisht ka falsifikuar aktet dhe vendimet e dy dosjeve gjyqësore të mësipërme, të cilat në bashkëpunim me të pandehurit Raimond Mëzi dhe Donika Besimaj, i kanë bërë pjesë të arkivës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë

Pasi këto dosje dhe vendime gjyqësore tërësisht të falsifikuara, janë pasqyruar sikur ndodheshin në arkivën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, rezulton se e pandehura Donika Besimaj, u ka vënë në dispozicion kopje të këtyre dy dosjeve gjyqësore dhe vendimeve gjyqësore të pandehurve Enkes Hysendhima dhe Raimond Mëzi.

Mbi bazën e këtyre dokumenteve tërësisht të falsifikuara, të pandehurit Enkes Hysendhima dhe Raimond Mëzi, në bashkëpunim me të pandehurën Blerina Dhrami (Brahimi), kanë arritur që të regjistrojnë këto dy vendime gjyqësore në regjistrat publik të pasurive të paluajtshme pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë.

Pasi të pandehurit Enkes Hysendhima dhe Raimond Mëzi, janë pajisur nga e pandehura Blerina Dhrami (Brahimi) me vërtetim nga dokumentet hipotekor për pasuritë e regjistruara mbi bazën e dy vendimeve gjyqësore tërësisht të falsifikuara, këta të fundit në bashkëpunim me njëri tjetrin kanë tjetërsuar pasurinë e përfituar mbi bazën e dokumenteve të falsifikuara, duke konsumuar veprën penale të parashikuar nga neni 287/3 e 25 të Kodit Penal.

I. Sipas organit të akuzës veprimet kriminale të të pandehurit Enkes Hysendhima konsistojnë në :

1. Falsifikimin e dokumenteve të dy dosjeve Gjyqësore
2. Futjen dhe tërheqjen e këtyre dosjeve në mënyrë të kundërligjshme në arkivën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
3. Depozitimin pranë ZVRPP Vlorë me qëllim regjistrimin e tyre.
4. Tërheqjen e dokumenteve të pronësisë dhe kryerjen e transaksioneve të ndryshme me qëllim fshehjen e origjinës së pronës.

II. Sipas organit të akuzës autorësia e këtyre veprimeve vërtetohet me :

1. Provat e gjetura si rezultat i kontrollit të zyrës së av. Enkes Hysendhima;
2. Provat e gjetura si rezultat i kontrollit të zyrës së noteres Belona Seraj;
3. Deklarimet e bashkë të pandehurit Raimond Mëzi;

(Janë pasqyruar konkluzionet e akt ekspertimeve përkatëse).

Nga rezultati i akteve të ekspertimit rezulton i provuar vetëm fakti që këto dy vendime gjyqësore janë të falsifikuara, por nuk vërtetohet kurrësi fakti që të jenë falsifikuar nga ana e të pandehurit Enkes Hysendhima. Ekspertet nuk kanë qenë në gjendje të përcaktojnë se cili ka

qenë "i njejt person" që ka falsifikuar firmat e gjyqtar Thoma Nika, "i njejt person" që ka falsifikuar firmat e gjyqtarit Skerdilajd Konomi dhe i "njejt person" që ka falsifikuar firmat e shtetas Natasha Qejvani. Gjithashtu, nuk është përcaktuar nëse ka qenë i njëjt person që ka falsifikuar firmat e të tre këtyre shtetasve apo kanë qenë tre persona të ndryshëm.

Me gjithë rezultatet e mësipërme të akteve ëkspertimit, çuditerisht organi i akuzes pretendon se rezulton e provuar se falsifikimi i dosjeve gjyqësore që i përket vendimit gjyqësor civil Nr. 1360, datë 29/12/2000 dhe Nr. 2217, datë 29/12/2003 ë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është realizuar nga i pandehuri Enkes Hysendhima në bashkëpunim me të pandehurin Raimond Mëzi.

Akuzat e prokurorisë mbi autorësinë e shtetasit Enkes Hysendhima në falsifikimin e dokumentave të mësipërm, si në fillim të hetimeve paraprake ashtu edhe në këtë fazë të gjykimit, kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të bazuara vetëm në hamendesime.

-Sipas Prokurorisë, autorësia e te pandehurit Enkes Hysendhima në falsifikimin e dosjeve Gjyqësore të vendimeve Nr.1360, datë 29/12/2000 dhe Nr. 2217 datë 29/12/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, provohet edhe nga krahasimi i të dhënave te administruara pranë ZVRPP Vlorë dhe Agjencisë së Trajtimit të Pronave Tiranë.

-Prokuroria jo vetëm që nuk përcakton mënyrën se si i pandehuri Enkes Hysendhima ka mundur t'i realizojë këto veprime të kundërligjshme, por nuk përcakton minimalisht as kohën kur pretendon që ky i pandehur, ti këtë realizuar keto veprime. Organi i akuzës nuk ofron një version, se si ka mundur ky shtetas t'i fuste ne arkivën e Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Vlorë këto akte, t'i bënte pjesë të kësaj arkive duke i pë këto akte, dhe me vonë t'i depozitonte ato në ZVRPP Vlorë, por limitohet vetëm duke pretenduar se gjate hetimeve rezultoi e provuar se autori i falsifikimit është shtetasi Enkes Hysendhima ne bashkëpunim me te pandehurit e tjere. Këto vendime Gjyqësore civile i përkasin viteve 2000 dhe 2003, kohe ne te cilen, shtetasi Enkes Hysendhima ka qene vetëm 19 dhe 22 vjeç dhe ne atë periudhe ndodhej jashtë shtetit me studime.

Këtë fakt e kemi permendur edhe gjatë hetimeve paraprake si dhe perpara Gjykates ne momentin e caktimit te mases se sigurise, por nuk është marre kurre ne konsiderate, si nga prokuroria, ashtu edhe nga Gjykata.

I pandehuri Enkes Hysendhima ka kryer studimet universitare në fakultetin e juridikut ne universitetin "La Sapienza" te Romes ne periudhen 1999-2009. Me pas ne janar te vitit 2010 është kthyer ne Shqiperi. Ne periudhën maj 2010 korrik 2011 ka punuar prane Bashkise Orikum si jurist. Nga data 09 shtator i vitit 2012 deri ne 23 dhjetor te vitit 2013 ka qene i punësuar prane Aluizni-t Vlora II.

Nga sa me sipër duam te theksojme dhe te veme ne vëmendje te Gjykatës se i pandehuri Enkes Hysendhima nuk ka pasur asnjë lloj funksioni dhe asnjë lloj aksesu në arkivën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë si në momentin që datojnë vendimet e falsifikuara, si në momentin qe ka filluar punë e pandehura Donika Besimaj , ashtu edhe gjatë kohës kur ka pretenduar organi i akuzës se janë kryer të gjitha këto veprime në kundërshtim me ligjin.

Në dosje nuk ndodhet ndonjë provë shkresore, shkencore apo me deshmitarë, apo qoftë edhe në formen e një indicieje, që të provojë faktin se shtetasi Enkes Hysendhima ka pasur akses sado minimal në arkivën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke bërë të mundur

futjen në këtë arkivë të fashikujve gjyqësore të falsifikuar dhe manipulimin e regjistrave të mbajtur nga Sekretaria dhe Arkiva e kësaj Gjykate.

Gjithashtu, i pandehuri Enkes Hysendhima nuk ka pasur njohje me të pandehurën Donika Besimaj dhe as me ndonjë person tjetër, që të ketë kryer detyrën e arkivistes, me herët në arkivën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Ky shtetas profesionin e avokatit ka filluar ta ushtroj rreth muajve Qershor-Korrik i vitit 2014, pasi deri në Dhjetor të vitit 2013 ishte i punësuar pranë Aluizni Vlorë. Në dosje nuk ndodhet asnjë dokument që të vërtetojë faktin që i pandehuri Enkes Hysendhima të ketë tërhequr dorazi vendimet e gjykatës. Po ashtu në dosje nuk ndodhet asnjë dokument që të provojë faktin që ti këtë depozituar dorazi në ZVRPP Vlorë.

Me provat e administruara nga vetë organi i akuzës gjatë hetimeve paraprake, të cilat janë pjesë e fashikullit gjyqësor, u vërtetua qartësisht se nuk ka qenë i pandehuri Enkes Hysendhima personi që ka depozituar këtë dokument në ZVRPP Vlorë pasi rezultoi se kjo gjë është realizuar nëpërmjet bashkëpunimit midis këtyre dy institucioneve.

Nga vetë hetimet e prokurorisë është vërtetuar fakti se për regjistrimin e vendimeve gjyqësore në ZVRPP Vlorë, është përdorur aplikimi i shtetasit Nesti Bifsha i datës 19/11/2012 i cili i përket një prone tjetër ndodhur në fshatin Dhermi. Në këto kushte, mbas një hetimi me shume se një vjeçar, pra nuk rezultoi te jetë falsifikuar ndonjë akt nga i pandehuri.

Në lidhje me transaksionet e kryera (janë cituar ato ku pjesëmarrës ka qenë shtetasi Enkes Hysendhima si përfaqësues i Jakup Mëzi).

Nuk rezultoi e pasqyruar në akte se mbi ç'bazë organi i akuzës ka arritur në përfundimin se shtetasi Enkes Hysendhima, është përgjegjës për regjistrimin në mënyrë të paligjshme të këtyre vendimeve në regjistrat e pasurive të palajtmshme të ZVRPP Vlorë.

Sipas prokurorisë, gjatë hetimeve paraprake ka rezultuar e provuar se pas regjistrimit të pasurive të mësipërme mbi bazën e dokumenteve të falsifikuara, janë kryer veprime tjetërsimi, duke kaluar e gjithë pasuria në emër të personave të tretë. Nga aktet bashkelidhur fashikullit hetimor, të shndërruar në fashikull gjyqësor si rrjedhojë e aplikimit të gjykimit të shkurtuar, ka rezultuar se veprimet për ndarjen e pasurive dhe regjistrimin e kontratave përkatëse janë kryer nga specialisti Agim Shehaj (pra vete prokuroria e pranon se veprimet mbi pasuritë janë kryer nga një specialist tjetër i ZVRPP dhe jo nga Blerina Dhrami, person me të cilin dyshohet se ka bashkëpunuar shtetasi Enkes Hysendhima).

Pretendimi i ngritur nga përfaqësuesi i organit të akuzës se shtetasi Enkes Hysendhima, ka kryer veprime juridike mbi pasuritë e shtetasit Raimond Mezi pasi është pajisur nga e pandehura Blerina Dhrami (Brahimi) me dokumentet e pronësisë nuk rezultoi të jete i provuar dhe ngelet në kuadrin e hamendësimeve.

Nuk rezultoi nga asnjë provë që shtetasi Enkes Hysendhima, me cilesinë e përfaqësuesit ligjor të të pandehurit Raimond Mezi, të jetë pajisur prej shtetasës Blerina Dhrami, me dokumentin e pronësisë përkatëse. Vërtetimi i pronësisë i datës 02.10.2014 që i përket pasurisë prej 90 ha të ndodhur në Karaburun, nuk është firmosur nga juristja Blerina Dhrami, por nga juristi Agim Shehaj.

Sipas organit të akuzës autorësia e të pandehurit Enkes Hysendhima, në kryerjen e veprave penale për të cilat është hetuar dhe dërguar për gjykim, rezulton e provuar edhe nga provat e mëposhtme:

1. Nga procesverbali i kontrollit të zyrës së avokatisë së av. Enkes Hysendhima

Mbi bazën e vendimit të gjykatës, më datën 30/05/2016, është kryer kontrolli i zyrës së avokatit Enkes Hysendhima. Sipas prokurorisë, gjatë kontrollit janë gjetur dhe sekuestruar dokumente e prova materiale që lidhen me veprën penale.

Konkretisht janë sekuestruar disa copa fletësh të grisura, ku nga bashkimi i tyre formohet një certifikatë për vërtetim pronësie në emër të shtetasës Renata Troqe, një vërtetim nga dokumentet hipotekore bashkëlidhur tij një plan rievimi në emër të shtetasit Gëzim Bajrami, që mban vulën e noteres Belona Seraj.

Është sekuestruar kërkesë padia e shtetasve Malo Bodo dhe Isuf Bodo, kundër të paditurve Raimond Mëzi etj, si dhe të gjitha provat e aktet që i janë bashkëngjitur kësaj padie.

Është sekuestruar vendimi gjyqësor Nr.2762, datë 19/12/2005 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, bashkë me aktet përkatëse të dosjes gjyqësore. Ky vendim gjyqësor i përket kërkesit Isuf Bodo me objekt vërtetimin e faktit juridik të bashkëpronësisë së shtetasve Sadik, Jemin e Shyqyri Bodo, për një sipërfaqe prone prej 315 ha, dhe të një sipërfaqe prone prej 188 ha, që ndodhen në gadishullin e Karaburunit, pra pikërisht për pronën objekt hetimi prej 220 ha. Nga këto të dhëna provohet bashkëpunimi ndërmjet të pandehurve Raimond Mëzi dhe Enkes Hysendhima.

I pandehuri Enkes Hysendhima ka spjeguar gjatë hetimeve paraprake se, dokumentat e mësipërme që janë gjetur në zyrën e avokatit nuk kanë absolutisht asnjë lidhje me veprën penale për të cilën i pandehuri akuzohet.

Fakti që këto dokumenta nuk kanë asnjë lidhje me veprën penale për të cilën akuzohet i pandehuri, rezulton e provuar nga vetë organi akuzës, i cili gjatë hetimeve paraprake, në kuadër të këtij procedimi penal ka verifikuar duke administruar pranë ZVRPP Vlorë dosjet përkatëse të këtyre dokumentave dhe ka konfirmuar origjinën e ligjshme të këtyre dokumentave të gjendura të grisura në koshin e zyrës së avokatit. Në të njëjtën kohë është konfirmuar fakti se këto dokumenta janë leshuar nga ZVRPP Vlorë dhe nuk ka rezultuar asnjë shkelje ligjore si në lidhje me veprën penale për të cilën ishte ushtruar kontrolli atë ditë në zyrë, ashtu edhe me çdo lloj veprë penale tjetër.

Sipas organit të akuzës autorësia e kryerjes së veprave penale nga ana e shtetasit Enkes Hysendhima në veprimet e mësipërme, rezulton e provuar edhe nga kontrolli i zyrës së noteres Bleona Seraj.

Sipas prokurorisë, fakti që në zyrën e noteres u gjeten letra të bardha bosh të firmosura nga motra e të pandehurit Enkes Hysendhima, (Reneta Troqe) dhe kunati i tij (Arjan Troqe) dhe vjehri i motrës (Jazo Troqe), vërteton faktin e bashkëpunimit midis noteres dhe avokatit, në lidhje me falsifikimin e pronave në Kraburun në emër të Raimond Mëzi.

Kjo akuzë rezulton të jetë e paprovuar dhe nuk gjen mbështetje në asnjë nga provat e mbledhura gjatë hetimeve paraprake nga vetë organi i akuzës. Nga dokumentat e sekuestruara në zyrën e noteres nuk rezulton asnjë dokument i firmosur në fletë të bardhë nga shtetasi Enkes Hysendhima apo nga shtetasi Raimond Mëzi. Ekzistenca e bashkëpunimit midis avokat Enkes

Hysendhima dhe noteres nuk është mohuar ndonjëherë nga palët në këtë procedim, por elementet e këtij bashkëpunimi nuk kanë në thelb përmbushje të realizimit të veprimtarisë kriminale të dyshuar nga prokuroria por bashkëpunimin profesional midis një avokati dhe një noteri.

Fakti që në zyrën noteriale u gjenden flete të bardha bosh të firmosura nga të afërmit e avokatit ndërkohe që njëkohësisht në zyrën e avokatit u gjet i grisur fotokopja e një dokumenti pronësie të motrës së tij, nuk përben absolutisht element të ndonjë veprë penale. Këto element fillimisht, në fazat e para të hetimeve paraprake mund të hidhnin dyshime për bashkëpunim midis këtyre shtetasve, por në konkluzion të hetimeve kur faktet u sqaruan dhe u vërtetuan.

Sipas organit të akuzës autorësia e kryerjes së veprave penale për të cilat akuzohet shtetasi Enkes Hysendhima, rezulton e provuar edhe nga deklaratimet e bashkëpandehurit Raimond Mëzi

Sipas prokurorisë, nga deklaratimet e të pandehurit Raimond Mëzi, rezulton se ai nuk ka dijeni për vendimin Nr. 100, datë 19/04/1996 të ish-KKKP-së Bashkia e Qytetit Vlorë, përmes së cilit është njohur pronësia për 220 ha, që ndodhen në Karaburun. Gjithashtu ky shtetas ka sqaruar se nuk ka paraqitur ndonjë padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, si dhe nuk ka dijeni për vendimin Nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. (nga akti i ekspertimit rezulton se "nuk përjashtohet që kerkese padia të jetë firmosur nga shtetasi Raimond Mëzi).

Po ashtu, ky shtetas ka deklaruar se nuk ka aplikuar për regjistrimin e pasurisë pranë ZVRPP Vlorë. Sipas tij, aplikimin mund të këtë bërë avokati i tij, shtetasi Enkes Hysendhima, pasi ky i fundit duke vepruar në emrin e tij, ka shitur disa prona në Karaburun dhe i ka dhënë shumën prej 4.000.000 lekë me këste, si çmim për shitjen e kësaj prone.

Duke iu referuar akteve shkresore të administruara gjatë hetimeve paraprake, edhe ky deklarim rezulton të jetë i pavërtetë, pasi nga aktet e ndodhura në dosje rezultoi që për regjistrimin e pronës të ishte përdorur aplikimi i shtetasit Nesti Bifsha. Nga ana e prokurorisë u konkludua se për regjistrimin e pronës nuk është administruar dokumenti i identitetit të ndonjë personi. Të gjitha shumat e kontratës së shitjes kanë kaluar në Nr. e llogarisë së shitesit Raimond Mëzi direkt nga noteria. Në dosje nuk ekziston e depozituar ndonjë provë që të vërtetojë faktin që vlerat monetare objekt i kontratës së shitjes të jenë derdhur në llogarinë bankare të ndryshme nga ajo e shtetasit Raimond Mëzi.

Gjithashtu ky shtetas ka deklaruar se në të gjitha kontratat që janë në emër të tij, janë nënshkruar prej tij, por këto kontrata janë firmosur fillimisht në fletë të bardhë bosh dhe se ai nuk ka dijeni në lidhje me përmbajtjen e këtyre kontratave.

Edhe kjo pjesë e deklaratimit të të pandehurit Raimond Mezi, rezulton të jetë e pavërtetë pasi sipas aktit të ekspertimit nuk është provuar një pretendim i tillë, fakt i konfirmuar edhe në vendimin e pushimit të datës 14.07.2017.

Ky shtetas ka deklaruar se është paraqitur tre herë pranë zyrës së noteres dhe ka nënshkruar në të tre rastet fletë të bardha bosh. Pranë zyrës së noteres ai është dërguar nga i pandehuri Enkes Hysendhima, i cili e ka telefonuar në të tre rastet që të paraqitej pranë noteres për të nënshkruar.



Në asnjë procesverbal pyetjesh nuk gjendet një deklaram i tillë nga ana e shtetasit Raimond Mëzi. Madje as në seancat e zhvilluara për masën e sigurimit. Prokuroria e kishte pretenduar këtë fakt dhe e kishte paraqitur si të deklaruar nga shtetasi Raimond Mëzi që në rastin e kërkesës se paraqitur ne gjykatë me objekt kontrollin e zyrës së av. Enkes Hysendhima. Ky vendim me Nr. 321 është marre në daten 30.05.2016 nga gjykatsia e hetimeve paraprake ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Nga kjo rrjedh që kërkesa e prokurorië është paraqitur minimumi një ditë përpara, pra në daten 29.05.2016. Deri ne këtë moment shtetasi Raimond Mëzi ishte pyetur dy here nga prokuroria, ne daten 04.04.2016 dhe ne daten 26.05.2016. Në asnjërin prej procesverbaleve te mësipërm nuk rezulton shtetasi Raimond Mëzi të ketë deklaruar “të jete telefonuar nga shtetasi Enkë tre herë.

Janë cituar pjesë nga deklaramet e shtetasit Raimond Mëzi datë 04.04.2016,26.05.2016 dhe 20.09.2016

Nga hetimet e organit të akuzës dhe provat e ndodhura në dosjen Gjyqësore, rezultoi e provuar se akuzat kundër të pandehurit Enkes Hysendhima, se në bashkëpunim me të pandehurit Raimond Mëzi, Donika Besimaj dhe Blerina Dhrami (Brahimi), kanë arritur që të regjistrojnë këto dy vendime gjyqësore ne regjistrat publik pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, janë krejtësisht te pabazuara dhe rezultojnë te bazohen ne hamendesime dhe deduksione hipotetike. ëpenale të falsifikimit të dokumentave si në formen e falsifikimit direkt ashtu dhe në atë të përdorimit.

Me provat e ndodhura në dosje nuk rezultoi absolutisht e provuar që Enkes Hysendhima të ketë kryer ndonjë veprim juridik që vjen në kundërshtim me ligjin civil apo penal në fuqi në Republikën e Shqipërise. Ai nuk ka bashkëpunuar kurrë me asnjë nga të pandehurit e tjerë dhe në dosje nuk rezulton e depozituar ndonjë provë apo fakt që të vërtetojë të kundertën.

I vetmi bashkëpunim i tij ka qenë ai me të pandehurin Raimond Mëzi nga i cili ka qenë i autorizuar me tagra të specifikuara qartësisht në prokuren e përfaqesimit dhe veprimet e tij nuk bien ndesh me asnjë nga këto tagra. Prokurat e përfaqësimit në emrin e tij kanë rezultuar të rregullta dhe si gjatë hetimeve paraprake ashtu edhe gjatë gjykimit nuk është shfaqur asnjë pretendim mbi vërtetesinë e tyre si nga organi i akuzës ashtu edhe nga personi i cili i ka lëshuar, i pandehuri Raimond Mëzi. Vetë i pandehuri Raimond Mëzi në deklaramet e tij ka deklaruar që ka kërkuar asistencën e avokatit dhe për këtë i ka lëshuar prokurë për shitjen e pronave të trashëguara nga babai i tij Jakup Mëzi.

Në lidhje me konsumimin e elementeve te veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale parashikuar nga neni 287/3 i Kodit Penal.

Nga dokumentet e administruara gjatë hetimeve paraprake të cilat tashmë ndodhen në fashikullin e gjykimit, vërtetohet fakti se i pandehuri Enkes Hysendhima ka përfaqësuar shtetasin Raimond Mëzi në shitjen e pronës se tij. Këto veprime nuk bien ndesh me asnjë dispozite ligjore si civile ashtu edhe penale. Një nga tagrat e prokures ishte edhe ajo e perfaqesimit te shtetasit Raimond Mëzi në kryerjen e transaksioneve te pronave të tij. Siç u vërtetua me sipër prokura është e rregullt dhe nënshkruar përpara noterit dhe askush nuk ka ngritur pretendime mbi rregullsine e saj.



Procedimi penal i ndërmarrë fillimisht edhe në ngarkim të noterit që kishte hartuar prokurën e përfaqesimit dhe kontratat përkatëse të shitjes u pushua për shkak se nuk provohet se në veprimet e noterit evidentohen elementë të ndonjë vepre penale.

Kontrata e shitjes së pronës prej 90 ha të ndodhur në Karaburun, ka qenë një veprim i ligjshëm, i kryer përpara noterit publik, përkundrejt vlerës monetare përkatëse, e cila ka kaluar nga llogaria bankare e blerësit, tek llogaria bankare personale e shitësit Raimond Mëzi, nepërmjet llogarise se noterit publik. Për pasojë pretendimet e të pandehurit Rajmond Mezi, se nga ky transaksion, ka përfituar vetëm shumën 40.000.000 milion lekë të vjetra është i pabazuar, pasi nga aket shkresore të admistruara në fashikullin gjyqësor, ekstrakti i llogarisë bankare të të pandehurit dhe i asaj të noterit, ku pasqyrohet fakti se e gjithë shuma e paguar nga blerësit, është lëvruar në llogarinë personale të të pandehurit Rajmond Mëzi.

Ne këto kushte rezulton së tij në shitjen e pronës dhe se vlera monetare e pasurisë së paluajtshme të shitur, ka kaluar në llogarinë bankare të shitesit dhe jo të përfaqesuesit. Shitesi me vonë ka disponuar këto vlera sipas nevojës dhe dëshirave të tij.

Enkes Hysendhima ka qenë përfaqësues i palës shitëse dhe nga transaksionet e pronave nuk ka përfituar asnjë shumë monetare. Po ashtu rezulton se shtetasi Enkes Hysendhima nuk ka përfituar asnjë pronë apo pasuri që të kenë prejardhje nga këto dy vendime, as për vete as për ndonjë nga të afërmit e tij.

Fakti që i pandehuri Enkes Hysendhima, ka përfaqësuar në shitjen e pronës të pandehurit Raimond Mëzi, nuk provon aspak *ndonjë kontribut apo bashkëpunim* në falsifikimin e dokumenteve si në formën e falsifikimit direkt ashtu edhe në atë të përdorimit. Vërtetimi i pronesisë (*objekt i kontrates së shitblerjes*) ka dalë nga një organ shtetëror siç është ZVRPP Vlorë firmosur dhe vulosur nga drejtuesi i institucionit mbas korrespondencës të këtij institucioni me gjykatën e rrethit Gjyqësor Vlorë në lidhje me konfirmimin e vendimit Gjyqësor.

Nisur nga ky fakt, përderisa nuk provohet se i pandehuri të ketë kryer veprën penale të "Falsifikimit të dokumenteve", për pasojë nuk provohet as dijenia e këtij shtetasi lidhur me qenien të falsifikuar të dokumentacionit të pronesisë objekt transaksioni. Kësisoj dhe në këtë linjë arsyetimi, nuk mund t'i atribuohet të pandehurit Enkes Hysendhima, edhe kryerja e veprës penale të "Pastrimit të produkteve të veprës penale", pasi ajo është e lidhur drejtpërdrejtë me veprën penale të "Falsifikimit të dokumenteve²".

Teoria e së drejtës penale ka pranuar se për të pasur ekzistencën e elementeve të veprës penale të "Pastrimit të produkteve të veprës penale", duhet medoemos që pasuria e krijuar apo vlera monetare që ka shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, të jetë rrjedhojë e përfitimeve të ardhura nga aktiviteti kriminal i kryer.

Edhe në këtë drejtim, nuk rezulton të jetë hetuar dhe arritur të provohet nga organi i akuzës, nëse ndonjë vlerë monetare e përdorur nga i pandehuri Enkes Hysendhima gjatë aktivitetit të tij si përfaqësues i të pandehurit Raimond Mëzi, të jetë rrjedhojë e përfitimeve të ardhur nga ndonjë aktivitet kriminal që ai të ketë kryer.

Nuk u vërtetua gjithashtu nga prokuroria se vlerat monetare që kanë shërbyer për blerjen e këtyre pronave nga ana e personave të trete, të kenë ardhur nga ushtrimi i ndonjë aktiviteti kriminal.

Në kushtet kur :

- I pandehuri Enkes Hysendhima, për të mundësuar kompletimin e transaksionit të pronave të shtetasit Rajmond Mëzi, veprimet i ka kryer në kuadër të veprimeve të lejuara dhe të kërkuara nga i përfaqesuari prej tij, nëpërmjet prokurës së posaçme;
- Nuk provohet dijenia e të pandehurit Enkes Hysendhima në lidhje me përmbajtjen e eventualisht të falsifikuar të dokumentave të pronesisë të kontestuar;
- Nga akti i ekspertimit grafik të shkrimit dhe nënshkrimit, nga ana e ekspertit nuk u arrit të konkludohej me një përfundim objektiv dhe kategorik lidhur me autoresinë e të pandehurit Enkes Hysendhima, për kryerjen e veprës penale të "Falsifikimit të dokumentave", në asnjërin nga format e parashikuara në ligj;
- Nga aktet bashkelidhur kërkesës për gjykim dhe të administruar në fashikullin gjyqësor, nuk rezultoi në menyrë katërciperisht të provuar fakti se dokumentacioni i kontestuar është depozituar prej të pandehurit, pasi aktet shkresore të administruara gjatë hetimeve paraprake, provojnë tërësisht të kundërtën;
- Gjatë hetimeve paraprake të kryera në funksion të këtij procedimi penal, nuk rezultoi që i pandehuri Enkes Hysendhima, të ketë patur për vete apo për të tretë perfitime materiale si rrjedhojë e transaksionit të kryer për llogari të të përfaqesuarit prej tij.

Akuza në ngarkim të tij, rezultoi të jetë e pambeshtetur në prova, të cilat duhet të jenë në unitet, në harmoni dhe të mbështesin e konfirmojnë njëra-tjetren apo faktet e pretenduara nga organi i akuzës në gjykim.

Bazuar në nenin 388/1 germa "b" të K.Pr.Penale, kërkojnë prej Gjykatës që të deklarojë të pafajshëm të pandehurin Enkes Hysendhima, për kryerjen e veprave penale të "Falsifikimi i dokumentave", dhe "Pastrim i produkteve të veprës penale", e kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 186/2 dhe 287/2 i K.Penal, pasi fakti i kontestuar këtij shtetasi nuk përben vepër penale.

Mbrojtja e të pandehurës **Blerina Dhrami(Brahimi)** ka kërkuar:

1-Deklarimin e pafajshëm të të pandehurës për veprat penale për të cilat akuzohet në bazë të nenit 388/1 pika "b" e K.Pr.Penale pasi fakti nuk përben vepër penale.

Nga ana e mbrojtjes janë pasqyruar pjesë nga kërkimet e akuzës në lidhje me fajësinë e kësaj të pandehurë dhe nga analiza e tyre nga mbrojtja është pretenduar se:

1-Nga akuza nuk është treguar se çfarë veprimesh ka kryer e pandehura fallsifikim apo përdorim të dokumentave të fallsifikuar dhe me kë i ka kryer këtë veprim.Ligji parasjhton se punonjst e ZRPP mbajnë përgjegjësi vetëm për dokumenta që prodhojnë brenda zyrave dhe nuk mbajnë përgjegjësi për dokumenta e sjella nga të tretët.

E pandehura ka krye veprimet për regjistrimin e pronës prej 220 ha mbi bazën e vendimit gjyqësor dhe hartës shoqëruese.Organi i akuzës duhet të provonte se ajo ka pasur dijeni që vendimi gjyqësor ishte i falsifikuar.I pandehuri Raimond Mëzi sipas deklarimeve të tij nuk ka shkuar në ZRPP për regjistrimin e pronës atëhere si kjo e pandehur e ka kryer veprën penale në bashkëpunim?

Prokuroria e ka mbështetur akuzën mbi deduksione dhe ata nuk kanë prova për të paraqitur.

E pandehura nuk njihej me të pandehurit e tjerë dhe akuza duhet të vërtetohet të kundërtën.

Fakti që nuk është aplikimi i të pandehurit, por i një personi tjetër është një shkelje e rregullores së brendshme dhe akuza nuk ka paraqitur asnjë provë se ky aplikim është futur në dosje nga e pandehura. Teorikisht këtë veprim mund ta ketë kryer çdo punonjës tjetër që ka akses në arkivë.

Të njëjtat pretendime janë dhe me regjistrimin e pronës prej 89 ha në vendin e quajtur "Adhendra".

Që në fillim e pandehura nuk e ka pranuar akuzën. Në pozicionin e juristes së ZRPP ajo kishte për detyrë që nga ana vizuale çdo dokument të ishte në formën e kërkuar nga ligji. Dokumentat e paraqitura ishin vendime gjyqësore ku dhe ekspertët e fushës arritën në përfundimin se janë të falsifikuar pas një kohe të caktuar.

Gjithashtu nuk provohet dhe kryerja e veprës penale "Shpërdorimi i detyrës" pasi veprimet janë ekryer sipas parashikimeve të ligjit 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme".

Mbrojtja e të pandehurës **Donika Besimaj** ka kërkuar:

1-Deklarimin e pafajshëm të të pandehurës për veprat penale për të cilat akuzohet në bazë të nenit 388/1 pika "b" e K.Pr.Penale pasi fakti nuk përbën vepër penale.

E pandehura Donika Besimaj as ka përfituruar, as ka regjistruar, dhe as ka tjetërsuar as një metër katror tokë, as vetëm dhe as në bashkëpunim me persona të tjerë.

Nga ana e mbrojtjes janë pasqyruar pjesë nga kërkimet e akuzës në lidhje me fajësinë e kësaj të pandehure dhe nga analiza e tyre nga mbrojtja është pretenduar se:

Provohet se dosja fizike që i përket vendimit gjyqësor civil nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është sistemuar dhe arkivuar në vendin përkatës ku ndodheshin dosjet gjyqësore që i përkisnin muajit dhjetor të vitit 2000.

Prokuroria shprehet se :provohet se veprimtaria e mësipërme është kryer nga e pandehura Donika Besimaj, e cila ka pasur në posedim të gjithë regjistrat e mësipërm.

(Nuk është treguar asnjë provë që të tregojë se si e ka vërtetuar këtë fakt prokuroria për ta mbështetur këtë përfundim)

Sipas akuzës del qartë se e pandehura Donika Besimaj, e cila ka pasur në administrim të gjithë arkivën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka hequr fletëhirrjet nga dosja gjyqësore që i përket vendimit 1502, datë 23/09/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke i administruar në dosjen krejtësisht të falsifikuar, që i përket vendimit nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Po sipas Prokurorisë, gjatë hetimeve paraprake është provuar se i pandehuri Raimond Mëzi, në bashkëpunim me të pandehurit Enkes Hysendhima, Donika Besimaj dhe Blerina Dhrami (Brahimi), ka përfituruar, regjistruar dhe tjetërsuar një sipërfaqe prone prej 89 Ha, në vendin e quajtur Shen Velash, Vlorë, me dokumente tërësisht të falsifikuara. Provohet se dokumentet e falsifikuara mbi bazën e të cilës është përfituruar kjo pasuri është e gjithë dosja gjyqësore që i përket vendimit gjyqësor civil nr. 2217, datë 29/12/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Nga hetimi është provuar se kjo dosje gjyqësore dhe aktet e ndodhura në të janë tërësisht të falsifikuara, si dhe janë futur në kundërshtim me ligjin në arkivën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë

Gjithashtu provohet se edhe dosja fizike që i përket vendimit gjyqësor civil nr. 2217, datë 29/12/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është sistemuar dhe arkivuar në vendin përkatës ku ndodheshin dosjet gjyqësore që i përkisnin muajit dhjetor të vitit 2003. Provohet se veprimtaria e mësipërme është kryer nga e pandehura Donika Besimaj, e cila ka pasur në posedim të gjithë regjistrat e mësipërm.

Rezulton e provuar se i pandehuri Lefter Gjergji, me ndihmën e të pandehurës Donika Besimaj, ka arritur që të falsifikojë aktet e dosjes gjyqësore që i përkasin vendimit nr.1568, datë 02.10.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, si dhe ka falsifikuar vendimin nr.1568, datë 02.10.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Gjithashtu provohet se edhe dosja fizike që i përket vendimit gjyqësor civil nr. 2217, datë 29/12/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është sistemuar dhe arkivuar në vendin përkatës ku ndodheshin dosjet gjyqësore që i përkisnin muajit dhjetor të vitit 2003. Provohet se veprimtaria e mësipërme është kryer nga e pandehura Donika Besimaj, e cila ka pasur në posedim të gjithë regjistrat e mësipërm.

(Janë cituar aktet që rezulton e provuar se janë të falsifikuara)

-Nga të dhënat e nxjerra ,është pretenduar nga prokuroria ,pa asnjë bazë se:

1.Këto dosje janë hartuar nga bashkëpunimi midis të pandehurve Donika Besimaj,Raimond Mëzi dhe Enkes Hysendhima.

2.Këto dosje janë futur në arshivë prej të pandehurës Donika Besimaj.

3.Po prej kësaj të pandehure janë hedhur të dhënat e përmbajtjes se tyre të falsifikuar nepër rregjistra.

4.Po prej të pandehurës Donika Besimaj i janë dhënë kopje të njehsuara të vendimeve të tyre të pandehurve të tjere në vitin 2012 për ti përdorur për rregjistrimin e tyre në ZVRPP Vlorë.

Nga provat rezulton se:

1.E pandehura Donika Besimaj nuk ka asnjë njohje të mëparshme apo të mëvonshme me të pandehurin Rajmond Mëzi.

2.I pandehuri Rajmond Mëzi nuk ka qenë kurrë personalisht në Gjykatën e Vlorës, aq me pak në arshivën e saj, apo në sportel,për të dorezuar apo tërhequr akte.

3.Shkrimi i përdorur për të plotësuar dosjet e falsifikuara dhe shkrimi i përdorur për të plotësuar të dhenat në rregjistrat e arshivës nuk është i të pandehurës Donika Besimaj apo i familjareve të saj.

4.E pandehura Donika Besimaj ka filluar punë në arshivën e gjykatës pas vitit 2008.

5.E pandehura Donika Besimaj i dorezonte çelesat e kësaj arshive pa inventar në kohën e Lejes se zakonshme(që është një periudhe një muaj për çdo vit),si dhe kur ka qenë me raporte të zgjatura shëndetësore,ku zevendesohet në këtë detyrë, pa kryer më parë inventar.

-Nga të dhenat e mesiperme ekziston mundësia :

1.Që dosjet mund të futeshin në arshivë edhe nga ndonjë person tjetër i gjykatës,ose nga një person që ka patur akses në çelesat e arshivës,në prani ose në mungesë të të pandehurës Donika Besimaj, gjatë kohës që ajo ka kryer detyrën e punonjeses së arshivës,të jenë sistemuar prej një personi tjetër,dhe po prej tij ,të jenë plotësuar edhe rregjistrat.

2.Që dosjet të jenë përgatitur dhe të jenë rregjistruar në ata rregjistra përpara se e pandehura Donika Besimaj të merrte atë detyrë,pra përpara vitit 2008,dhe pasi janë lenë aty të harrohen,janë venë në levizje pas vitit 2012 për tu përdorur.

Sa me sipër mendojnë që mund të ketë ndodhur pikërisht në këtë mënyrë,futja e këtyre dosjeve në arshivë dhe plotesimi me të dhënat e tyre edhe i rregjistrave përpara se e pandehura Donika Besimaj të ketë filluar punën në arshivën e Gjykatës.

Këtë alternativë e ka berë me të besueshme vete organi i hetimit pasi:

Së pari,Nga ekspertimet grafike teknik shkrimi ëe shkrimit të të pandehurës apo i familjareve të saj.(Qëllimi i prokurorisë në kryerjen e këtij ekspertimi ka qenë pikërisht provimi ose jo i këtij fakti,dhe duke qenë se ekspertimi doli me rezultat negativ ,vetë prokuroria duhej të tërhiqej nga akuzat për te pandehurën))

Së dyti,Nga ekspertimet e kryera nuk u morën mostra shkrimi për krahasim të të gjithë punonjesve të gjykatës ,sidomos të atyre që kanë punuar atje që nga viti 2003 periudhë që përkon me kohën kur fillon mundësia e kryerjes se veprimeve të kundërligjshme.

Së treti,një pjesë e shënimeve në rregjistra,deklaruar nga kancelarja, nuk kryhen prej arkivistes dhe si i tillë nuk është kërkuar as përgjegjesi i plotësimit te tyre,
(*me se shumti me mostrat e krahasimit të të pakten gjithë kryesekretareve që kanë punuar atje ato vite.*)

Nga dëshmia e kancelares së gjykatës provohet se arkivistja(detyrë që ka pasur e pandehura) administron, por shënimet në regjistër në momentin e dorëzimit të dosjeve kryhen nga kryesekretarja.

Në këtë procedim si prova kanë shërbyer kryesisht dokumentet,aktet e ekspertimit, deklaramet e personave që tregojnë rrethana të hetimit,deklaramet e personave nën hetim dhe deklaramet e të pandehurve.

Që të provohet një akuzë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm me se paku provat duhet të jenë në unitet dhe harmoni me njëra tjetrën .

a. Provat shkencore siç është ekspertimi,mohojnë kryerjen e veprës prej saj, pasi shkrimet në dosje dhe rregjistra nuk janë të sajat dhe as të ndonjë personi të saj të afërm .

b. Deklarimet e personave qe tregojnë rrethana të hetimit ,deklarimet e kancelares së gjykates se as plotësimi i rregjistrave nuk është detyrë e saj(të pandehurës) por e kryesekretares.

c. Deklarimet e të pandehurit dhe personit ndaj të cileve është zhvilluar hetimi,siç është rasti i Rajmond Mëzit dhe Lefter Gjergjit kanë treguar se ata vetë nuk janë paraqitur kurrë personalisht në sportelet e gjykatës dhe se ata nuk e kanë njohur fare të pandehurën Donika Besimaj.

d.Deklarimi i të pandehurit Enkes Hysendhima nuk ka në asnjë rresht të tij tregime rreth veprimeve te përbashketa mes tij dhe të pandehurës.

e.Vetë deklarimet e të pandehurës tregojnë padijeninë e saj të plotë rreth fakteve të zbuluara.

Nga shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështje mbi bazën e kërkesave të nenit 380 të K.Pr.Penale i cili parashikon: **“Për të marrë vendimin gjykata nuk mund të përdorë prova të tjera veç atyre që janë marrë ose janë verifikuar në shqyrtimin gjyqësor”** gjykata pasi ka pranuar dhe shqyrtuar gjatë gjykimit provat shkresore të paraqitura nga palët që janë pjesë e fashikullit të prokurorit në këtë gjykim rezultoi e provuar se:

Gjatë gjykimit janë marra dhe administruar të gjitha aktet e marra gjatë hetimit të çështjes të cilat në baze të nenit 371 të K.Pr.Penale për shkak se u procedua me gjykim te shkurtuar janë pjesë e fashikullit të gjykimit dhe janë pranuar në këtë gjykim me cilesinë e provave dhe konkretisht:

1. Kallëzimi penal i paraqitur nga shtetasit Isuf Bodo dhe Malo Bodo, më datë 11/02/2016;
2. Procesverbali për sekuestrimin e dokumentave, datë 09/03/2016 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, bashkë me dokumentat e sekuestruara e konkretisht të gjitha akate te dosjes gjyqësore që i përkasin vendimit civil nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me paditës shtetasin Raimond Mezi.
3. Procesverbali për sekuestrimin e dokumentave, datë 06/06/2016 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, bashkë me dokumentat e sekuestruara e konkretisht të gjitha akate te dosjes gjyqësore që i përkasin vendimit civil nr. 2217, datë 29/12/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me paditës shtetasin Raimond Mezi.
4. Vendimi nr. 2217, datë 29/12/2003 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me shënimin “Vendimi mori forme te prere”;
5. Regjistër Themeltar Civil i vitit 2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë;
6. Regjistër Themeltar Civil i vitit 2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë;
7. Libri i numratorit civil të vitit 2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë;
8. Libër volum i vendimeve civile të vitit 2003, numër vendimi 1500, datë 23/09/2003 deri në vendimin nr. 1600, datë 07/10/2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë;
9. Procesverbal për sekuestrimin e dokumenteve datë 06/06/2016 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, bashkë me dokumentet e sekuestruara, e konkretisht Regjistër Civil Themeltar të vitit 2000, në të cilin janë pasqyruar të dhënat e vendimit gjyqësor nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë;
10. Procesverbal për sekuestrimin e dokumenteve datë 01/06/2016 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, bashkë me dokumentet e sekuestruara, e konkretisht Numratori

- i Vendimeve Civile të vitit 1999-2000, në të cilin janë pasqyruar të dhënat e vendimit gjyqësor nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë;
11. Procesverbal për sekuestrimin e dokumenteve datë 25/04/2016 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, bashkë me dokumentet e sekuestruara, e konkretisht Librin e Indeksit të vendimeve civile të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në të cilin janë pasqyruar të dhënat e vendimit gjyqësor nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë;
 12. Procesverbal për sekuestrimin e dokumentave, datë 15/03/2016 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, bashkë me dokumentat e sekuestruara e konkretisht të gjitha akate te dosjes gjyqësore që i përkasin vendimit civil nr. 1568, datë 02/10/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me kërkues shtetasin Theotoq Gjergji.
 13. Procesverbal për sekuestrimin e dokumenteve datë 10/03/2016, pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave, bashkë me dokumentet e sekuestruara e konkretisht e gjithë praktika që i përket vendimit nr. 115, datë 15/12/2005 të Komisionit te Kompensimit të Pronave Qarku Vlorë, ne emër të shtetasit Theotoq Gjergji;
 14. Procesverbal për sekuestrimin e dokumenteve datë 27/05/2016, pranë noterit Durim Lekdushi, bashkë me dokumentet e sekuestruara;
 15. Procesverbal për sekuestrimin e dokumenteve datë 23/05/2016, pranë noterit Ermal Islamaj, bashkë me dokumentet e sekuestruara;
 16. Procesverbal për sekuestrimin e dokumenteve datë 23/05/2016, pranë noterit Belona Seraj, bashkë me dokumentet e sekuestruara;
 17. Procesverbal për sekuestrimin e dokumenteve datë 26/04/2016, pranë ZVRPP Vlorë, bashkë me dokumentet e sekuestruara, e konkretisht praktika e regjistrimit të vendimit nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë;
 18. Procesverbal për sekuestrimin e dokumenteve datë 03/06/2016, pranë ZVRPP Vlorë, bashkë me dokumentet e sekuestruara, e konkretisht praktika e regjistrimit të vendimit nr. 2217, datë 29/12/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë;
 19. Procesverbal për sekuestrimin e dokumenteve datë 09/06/2016, pranë ZVRPP Vlorë, bashkë me dokumentet e sekuestruara, e konkretisht praktika e regjistrimit të pasurive në emër të shtetasve Agim Kërçuku dhe Robert Bano;
 20. Procesverbal për sekuestrimin e dokumenteve datë 09/06/2016, pranë ZVRPP Vlorë, bashkë me dokumentet e sekuestruara, e konkretisht praktika e regjistrimit të pasurive në emër të shtetasve Enkes Hysendhima, Ina Petritaj dhe Renata Troqe;
 21. Procesverbal për sekuestrimin e dokumenteve datë 04/05/2016, pranë ZVRPP Vlorë, bashkë me dokumentet e sekuestruara, e konkretisht praktika e regjistrimit të pasurive në emër të shtetasve Lulzim Shusha, shoqëria Enginnering Global, Andi Gjikhuri, Petro Beja, Gazmend Beqiraj, Arben Ruci, Renald Kobure, Pëllumb Saliaj, Lefter Gjergji, Majlinda Petritaj, Marjo Memaj dhe Ervina Dalipaj;
 22. Procesverbal për sekuestrimin e dokumenteve datë 09/05/2016, pranë ZVRPP Vlorë, bashkë me dokumentet e sekuestruara, e konkretisht praktika e regjistrimit të pasurive në emër të shtetasve Pëllumb Saliaj, Dhimitraq Mustaka, Zhaklin Deliu dhe Andi Gjikhuri;

23. Procesverbali për sekuestrimin e dokumenteve datë 30/05/2016, pranë noterit Belona Seraj, bashkë me dokumentet e sekuestruara;
24. Procesverbali për sekuestrimin e dokumenteve datë 31/05/2016, gjatë kontrollit të zyrës noteriale të noterës Belona Seraj, bashkë me dokumentet e sekuestruara;
25. Procesverbali për sekuestrimin e dokumenteve datë 31/05/2016, gjatë kontrollit të zyrës së avokatit Enkes Hysendhima, bashkë me dokumentet e sekuestruara;
26. Procesverbali për sekuestrimin e dokumenteve datë 31/05/2016, gjatë kontrollit të banesës së shtetasit Enkes Hysendhima, bashkë me dokumentet e sekuestruara;
27. Procesverbali për sekuestrimin e dokumenteve datë 04/05/2016, gjatë kontrollit të banesës së shtetasit Lefter Gjergji, bashkë me dokumentet e sekuestruara;
28. Procesverbali për sekuestrimin e dokumenteve datë 04/05/2016, pranë ZVRPP Vlorë, bashkë me dokumentet e sekuestruara;
29. Procesverbali për kontrollin e zyrës së noterës Belona Seraj, datë 31/05/2016;
30. Procesverbali për kontrollin e zyrës së avokatit Enkes Hysendhima, datë 31/05/2016;
31. Procesverbali për kontrollin e banesës së shtetasit Enkes Hysendhima, datë 31/05/2016;
32. Procesverbali për kontrollin e banesës së shtetasit Pullumb`Petritaj, datë 31/05/2016;
33. Procesverbali për kontrollin e banesës së shtetasit Renald Kobure, datë 04/05/2016;
34. Procesverbali për kontrollin e zyrës së shtetasit Renald Kobure, datë 04/05/2016;
35. Procesverbali për kontrollin e banesës së shtetasit Lefter Gjergji, datë 04/05/2016;
36. Procesverbali për marrjen e mostrave të vulës datë 01/02/2017, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë;
37. Akti i ekspertimit tekniko-grafik nr. 6495, datë 20/06/2017, bashkë me tabelën fotografike;
38. Akti i ekspertimit grafik nr. 7891, datë 12/08/2016, bashkë me tabelën fotografike;
39. Akti i ekspertimit tekniko-grafik nr. 2294, datë 10/03/2017, bashkë me tabelën fotografike;
40. Akti i ekspertimit tekniko-grafik nr. 3685, datë 13/04/2017, bashkë me tabelën fotografike;
41. Akti i ekspertimit tekniko-grafik nr. 3529, datë 21/04/2016, bashkë me tabelën fotografike;
42. Procesverbali për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve datë 06/07/2017 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, e konkretisht aktet e dosjes gjyqësore që i përkasin vendimit nr. 1502, datë 23/09/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë;
43. Procesverbali për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve datë 26/04/2016, pranë ZVRPP Vlorë, bashkë me dokumentet e administruara;
44. Procesverbali për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve datë 03/07/2017, bashkë me dokumentet e administruara;
45. Procesverbali për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve datë 07/06/2016, pranë ZVRPP Vlorë, bashkë me dokumentet e administruara;
46. Procesverbali për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve datë 29/05/2016, pranë ZVRPP Vlorë, bashkë me dokumentet e administruara;
47. Procesverbalet për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve datë 01/06/2016, pranë ZVRPP Vlorë, bashkë me dokumentet e administruara;

48. Procesverbali për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve datë 13/06/2016, bashkë me dokumentet e administruara;
49. Procesverbalet për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve datë 09/06/2016, pranë ZVRPP Vlorë, bashkë me dokumentet e administruara;
50. Procesverbali për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve datë 03/06/2016, pranë ZVRPP Vlorë, bashkë me dokumentet e administruara;
51. Procesverbali për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve datë 03/06/2016, pranë ZVRPP Vlorë, bashkë me dokumentet e administruara;
52. Procesverbali për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve datë 27/05/2016, pranë noterit Durim Lekdushi, bashkë me dokumentet e administruara;
53. Procesverbali për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve datë 23/05/2016, pranë noterit Ermal Islamaj, bashkë me dokumentet e administruara;
54. Procesverbali për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve datë 09/05/2016, pranë noterit Alida Memetaj, bashkë me dokumentet e administruara;
55. Procesverbali për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve datë 10/05/2016, pranë noterit Alketa Dëshalla, bashkë me dokumentet e administruara;
56. Procesverbali për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve datë 04/05/2016, pranë noterit ZVRPP Vlorë, bashkë me dokumentet e administruara;
57. Procesverbali për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve datë 19/12/2016, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, bashkë me dokumentet e administruara;
58. Regjistrimet dhe procesverbalet e transkriptit bashkë me 6 (gjashtë) CD, të përgjuara mbi bazën e vendimit nr. 70, datë 24/05/2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë;
59. Regjistrimet dhe procesverbalet e transkriptit bashkë me 3 (tre) CD, të përgjuara mbi bazën e vendimeve nr. 74, datë 29/04/2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. 56, datë 05/05/2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. 59, datë 11/05/2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. 61, datë 12/05/2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe nr. 66, datë 19/05/2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë;
60. Regjistrimet dhe procesverbalet e transkriptit bashkë me 1 (një) CD, të përgjuara mbi bazën e vendimit nr. 58, datë 11/05/2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë;
61. Regjistrimet dhe procesverbalet e transkriptit bashkë me 1 (një) CD, të përgjuara mbi bazën e vendimit nr. 67, datë 19/05/2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë;
62. Vendim për autorizimin e kryerjes së përgjimeve të fshehta në vende publike, datë 29/04/2016, dhe datë 19/05/2016, bashkë me raport shërbimi, datë 26/05/2016; raport shërbimi 27/05/2016; datë 28/05/2016; datë 29/05/2016 dhe datë 30/05/2016;
63. Note transkriptimi neni 10, volumni 11, viti 1941 dhe neni 248, volumni 11, viti 1942, administruar pranë ZVRPP Vlorë përmes shkresës nr. 82/1 prot, datë 02/03/2017;
64. Kopje të procesverbalit të seancës gjyqësore të zhvilluar më datë 03/06/2016 dhe kopje të procesverbalit të seancës gjyqësore të zhvilluar më datë 29/01/2017, bashkë me një CD, të administruar përmes shkresës nr. 635, datë 22/05/2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë;
65. Dokumentet e administruara pranë ZVRPP Vlorë përmes shkresës nr. 16322/1 prot, datë 30/06/2016;

66. Dokumentet e administruara pranë Raiffeisen Bank Dega Vlorë, përmes shkresës nr. 4277 prot, datë 03/06/2016;
67. Dokumentet e administruara pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave Tiranë, përmes shkresës nr. 2061/1 prot, datë 14/07/2016;
68. Dokumentet e administruara pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave Tiranë, përmes shkresës nr. 2033/1 prot, datë 21/07/2016;
69. Dokumentet e administruara pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, përmes shkresës nr. 773 prot, datë 15/06/2016;
70. Dokumentet e administruara pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, përmes shkresës nr. 1008/1 prot, datë 23/03/2016;
71. Dokumentet e administruara pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave Tiranë, përmes shkresës nr. 1601/1 prot, datë 24/05/2016;
72. Dokumentet e administruara pranë Bashkisë Himarë, përmes shkresës nr. 1437/1 prot, datë 11/05/2016;
73. Dokumentet e administruara pranë ZVRPP Vlorë, përmes shkresës nr. 1822/1 prot, datë 26/02/2016;
74. Dokumentet e administruara pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave Tiranë, përmes shkresës nr. 500/1 prot, datë 19/02/2016;
75. Dokumentet e administruara pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave Tiranë, përmes shkresës nr. 735/1 prot, datë 24/02/2016;
76. Procesverbalet për marrjen e të dhënave nga personat që ka dijeni për vepren penale, e konkretisht nga shtetasit shtetasja Arben Ruçi; Alma Dautaj; Gerian Kuka; Albana Balla; Thoma Nika; Antigona Mecaj; Andi Mone; Manol Mertiri; Kasem Cenaj; Ervin Demiraj; Afroviti Gjipali; Llambro Dhima; Diana Hysi; Bledar Dumani; Manuela Kamberi; Leonora Bezhani; Faik Haruni; Arlind Limaj; Kristofor Rexho; Eduart Dervishi; Aurela Abazaj; Kujtim Sulçe dhe Rezarta Taushani;
77. Procesverbali për marrjen e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet, nga shtetasi Enkes Hysendhima, datë 01/06/2016 dhe datë 20/09/2016;
78. Procesverbali për marrjen e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet, nga shtetasi Raimond Mëzi, datë 26/05/2016 dhe datë 20/09/2016;
79. Procesverbali për marrjen e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet, nga shtetasi Lifter Gjergji, datë 09/05/2016, datë 25/05/2016 dhe datë 20/09/2016;
80. Procesverbali për marrjen e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet, nga shtetasja Belona Seraj, datë 31/05/2016 dhe datë 04/11/2016;
81. Aktet ne lidhje me mast e sigurimit dhe aktet të tjera të këtij fashikulli të procedimit penal.

I.Në lidhje me faktin penal për falsifikimin e dokumantave gjykata vlerëson se gjatë gjykimit rezultoi e provuar se:

-Vendimi Nr.100 datë 19.04.1996 ish-KKKP-së Bashkia e Qytetit Vlorë, i cili është njësuar me origjinalin pranë noterit publik Ylli Mehmeti, i paraqitur në dosjen me nr 1360 vendimi datë 29.12.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe pranë ZVRPP Vlorë është i falsifikuar.

Rezultoni se mbi bazën e të dhënave dhe ekstremiteteve të vendimit të administruar pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave Tiranë është krijuar një vendim tjetër me të njëjtat ekstremitete në favor të subjektit Jakup Mezi, por duke falsifikuar të dhënat e pronësisë, e konkretisht duke pasqyruar fakin sikur komisioni ka vendosur *“1. Të njoh si ish pronarë të kësaj prone z. Jakup Mezi (trashëgimtarët e tij). Mbi një sipërfaqe kullote prej 220 ha e ndodhur në vendin “Karaburun”, kufizuar në: Lindje Përroi i uji i njelm, Jug Qafa e gjashtës, Veri Deti, Perëndim Përroi i Dhime Kushtes”*.

-Vendimi Nr.100 datë 19.04.1996 ish-KKKP-së Bashkia e Qytetit Vlorë, i cili është njësuar me origjinalin pranë noterit publik Ylli Mehmeti, i paraqitur në dosjen me nr.2217 vendimi datë 29.12.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe pranë ZVRPP Vlorë është **i falsifikuar**.

Rezultoni se mbi bazën e të dhënave dhe ekstremiteteve të vendimit të administruar pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave Tiranë është krijuar një vendim tjetër me të njëjtat ekstremitete në favor të subjektit Jakup Mezi, por duke falsifikuar të dhënat e pronësisë, e konkretisht duke pasqyruar fakin sikur komisioni ka vendosur ka njohur pronësinë e subjektit Jakup Mezi mbi një sipërfaqe kullote prej 89 Ha, e ndodhur në vendin “Shen Velash” një kullotë e cila përbëhet prej aproksimativisht 690 (gjashtëqind e nëntëdhjetë) vreten tokë dhe kufizohet përgjithësisht: Lindje Vellazeria Sharra, Perëndim Deti, Veri Seit Shehu dhe Perroji, Jug Vellazeria Sharra.

Falsifikimi i tij është kryer duke përdoruar të dhënat nga dosja nr. 905 e vitit 1994, që përmban vendimin nr. 100, datë 19/04/1996 të ish-KKKP-së Bashkia e Qytetit Vlorë, në emër të subjektit të shpronësuar Jakup Mëzi, vendim në të cilin është vendosur:

“1. Të njohë si ish-pronarë të kësaj prone z. Jakup Mëzi (trashëgimtarët e tij). –Mbi një sipërfaqe trualli e ndodhur në vendin “Sadra” lagjia “Isa Boletini”, prej 4800 metër katrorë truall. –Mbi një sipërfaqe toke të tjetërsuar në truall prej 6600 metër katrorë e ndodhur në vendin “Aplemë”, lagjia e Re. 1b. Të kompensojë sipërfaqen e truallit prej 5000 metër katrorë sipas disponibilitetit që do të ketë komisioni. 1c. Sipërfaqja e tokës së tjetërsuar në truall prej 6400 metër karorë do të trajtohet me ligjin për tokën bujqësore”.

-E gjithë praktika e dosjes gjyqësore që i përket vendimit gjyqësor civil nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është **e falsifikuar duke krijuar një dosje tërësisht të falsifikuar**.

Të dhënat e pasqyruara në Regjistrin themeltar civil të vitit 2000, në numratorin e vendimeve civile të viteve 1999-2000 dhe në Indeks të vendimeve gjyqësore civile të viteve 1999-2000-2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në lidhje me vendimin nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë janë të falsifikuara.

- E gjithë praktika e dosjes gjyqësore që i përket vendimit gjyqësor civil nr. 2217, datë 29/12/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është **e falsifikuar duke krijuar një dosje tërësisht të falsifikuar**.



Të dhënat e pasqyruara në Regjistrin themeltar civil të vitit 2002,2003, në numratorin e vendimeve civile të viteve 2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në lidhje me vendimin nr. 2217, datë 29/12/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë janë të falsifikuara.

- Praktika e dosjes gjyqësore që i përket vendimit gjyqësor civil nr. 1568, datë 02/10//2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është e falsifikuar duke krijuar në dosje akte të falsifikuara përfshirë dhe vendimin gjyqësor.Me vendimin origjinal Nr.1568, datë 02/10//2003 i është njohur subjektit Theotaq Gjergji sip prej 5 ha.

Të dhënat e pasqyruara në Volumin e vendimeve të vitit 2003 që fillon nga vendimi nr. 1500, datë 23/09/2003 deri në vendimin nr. 1600, datë 07/10/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në lidhje me vendimin nr. 1568, datë 02/10//2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në lidhje me vendimin nr.1568 datë 02.10.2003të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë janë të falsifikuara.

-Të gjitha aktet dhe praktika në lidhje (me pronësinë dhe vendimi gjyqësor nr.1568 datë 02.10.2003 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë)që i përkasin dosjes me Nr vendimi 168, datë 14/06/2006 të KVKKPronave Qarku Vlorë në emër të subjektit Theotaq Gjergji, të cilat ndodhen pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave Tiranë dhe janë përdoruar në ZRPP Vlorë për reregjistrimin e pronës janë të falsifikuara

Falsifikimi në këtë dosje është bërë duke zëvendësuar aktet e pronësisë dhe vendimin Nr.1568, datë 02/10//2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ku i është njohur subjektit Theotaq Gjergji sip prej 5 ha si dhe duke futur në dosje vendimin nr. 168, datë 14/06/2006 të KVKKPronave Qarku Vlorë tërësisht të falsifikuar në lidhje me pronën e kthyer subjektit.


Në lidhje me këto prona pas rregjistrimit të tyre janë kryer transaksionet e cituar nga akuza më lart.

Gjatë hetimit dhe gjykimit nuk është bërë e mundur të saktësohet periudha e saktë se kur janë kryer falsifikimet përkatëse.

Nisur nga data që mbajnë Vendimi Nr.100 datë 19.04.1996 ish-KKKP-së Bashkia e Qytetit Vlorë në emer të Jakup Mëzi për sip 220 ha kjo periudhe fillon nga kjo datë deri në datën 17.04.2012 ,datë në të cilën për vendimin Nr.1360 datë 29.12.2000 është nënshkruar si vendim i nxjerrë naga arkiva për herë të parë nga e pandehura Donika Besimaj.

Vendimi Nr 1360 datë 29.12.2000 është falsifikuar pas datës 23.09.2003.Rezulton se në dosjen e mësipërme gjyqësore është administruar edhe një fletë-thirje, e cila mban nr. 673 Akti. Organi procedues ka sekuestruar në cilësinë e provës dosjen gjyqësore që i përket numrit 673 Akti. Rezulton se kjo dosje gjyqësore i përket vendimit nr. 1502, datë 23/09/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me gjyqtarë Lek Mehilli dhe me palë paditëse Ariste Kuqi dhe palë e paditur K.K.K Pronave të rrethit Vlorë.

Nisur nga data që mbajnë Vendimi Nr.100 datë 19.04.1996 ish-KKKP-së Bashkia e Qytetit Vlorë në emer të Jakup Mëzi për sip 89 ha kjo perudhe fillon nga kjo datë deri në datën 11.10.2012 ,datë kur është bërë fotokopja e dosjes për vendimin Nr.2217 datë



29.12.2003 e nënshkruar si vendim i nxjerrë nga arkiva për herë të parë nga e pandehura Donika Besimaj.

Për vendimet përkatëse gjyqësore periudha e falsifikimit të tyre është e mundshme të jetë kryer nga data që mbajnë vendimet përkatëse, përkatësisht 29.12.2000 (vendimi Nr 1360) dhe 29.12.2003 (vendimi Nr. 2217).

Duke analizuar aktet, vendimin për vertetimin e faktit juridik Nr 1568 datë 02.10.2003 (datë në të cilën rezultoi se është lëshuar dhe vendimi origjinal) dhe datën se kur është nënshkruar si vendim i nxjerrë nga arkiva për herë të parë nga e pandehura Donika Besimaj rezultoi se kjo datë është 08.05.2009. Kjo kopje vendimi është depozituar në dosjen me Nr 168 vendimi datë 14.07.2006 të KVKK Pronave Qarku Vlorë në emër të subjektit Theotoq Gjergji, dosje e cila është dërguar e konfirmuar nga AKKP Tiranë në datë 03.08.2011 ZVRPP Vlorë.

Vendimi Nr 168 vendimi datë 14.07.2006 të KVKK Pronave Qarku Vlorë në emër të subjektit Theotoq Gjergji është falsifikuar nga kjo datë deri në datë 03.08.2011 kur rezultoi se ka qenë i administruar në dosjen përkatëse pranë AKKP Tiranë.

Mbi bazën e këtyre fakteve të pandehurit janë akuzuar për veprat penale përkatëse "Falsifikimi i dokumentave" parashikuar nga nenet 186/2/3 të Kodit Penal, "Shpërdorimi i detyrës" parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" parashikuar nga neni 287/3 i Kodit Penal.

(i). Në lidhje me natyrën juridike të veprave penale, të parashikuara respektivisht nga nenet 186/2 e 25, 186/3 e 25, 248, 287/3 të Kodit Penal.

Paraprakisht, gjykata vlerëson se, për të pasur një figurë konkrete të veprës penale është e domosdoshme ekzistenca e të gjithë elementëve përbërës të saj të marra së bashku, të cilët janë: (i). Objekti i veprës penale; (ii). Ana objektive; (iii). Subjekti dhe (iv). Ana subjektive. Provueshmëria e elementëve objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale, shërben si element themelor për të vënë një person përpara përgjegjësisë penale.

Gjithashtu, vepra penale paraqet në vetvete një unitet të të gjithë elementëve të figurës së saj dhe ajo konsiderohet e kryer apo e konsumuar, kur ekzistojnë të katër elementët figurës së saj dhe në eventualitetin e mungesës së njërit prej këtyre elementëve, do të arrihet në përfundimin se, figura konkrete e veprës penale nuk është konsumuar, për pasojë autori apo subjekti aktiv i saj, nuk mund të mbajë përgjegjësi penale.


Neni 186 i Kodit Penal, parashikon se:

"1. Falsifikimi ose përdorimi i dokumentave të falsifikuara dënohet me burgim deri në tre vjet.

2. Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet.

3. Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin, dënohet me burgim nga një vit deri në shtatë vjet burgim".

Objekti juridik i veprës penale të "Falsifikimit të dokumentave" janë marrëdhëniet juridike të vendosura nga ligjvënësi, me qëllim sigurimin dhe mbrojtjen e veprimtarisë së ligjshme të organeve të administratës publike apo personave juridikë privatë në lidhje me hartimin, administrimin dhe lëshimin e dokumentave, nga veprimet e kundraligjshme,



shoqërisht të rrezikshme, të kryera me faj dhe të dënueshme penalisht, që synojnë të prekin, çënojnë apo trondisin ligjshmërinë e funksionimit të këtyre organeve.

Objekti material, përfaqëson vetë dokumentat e falsifikuara, të cilat mund të jenë të ndryshme, me përjashtim të atyre dokumentave (p.sh. dokumentat shkollore apo shëndetësore) të cilat, ligjvënësi për shkak të rëndësisë që paraqesin, falsifikimin apo përdorimin e tyre e ka ngritur në nivelin e veprës penale, për pasojë nëse do të gjendeshim përpara një rasti të tillë, cilësimi juridik i faktit penal do të bëhej konform dispozitës penale konkrete (p.sh. neni 187 apo 188 të Kodit Penal).

Nga ana objektive, vepra penale e “Falsifikimit të dokumentave”, do të quhet e konsumuar, nëse realizohet përmes njërës apo dy formave të mëposhtme:

(i).Falsifikimit të dokumentave.

(ii).Përdorimit të tyre.

Në lidhje me veprën penale “bijë”, atë të “Falsifikimit të dokumentave” nga personi që e ka për detyrë, parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal, ligjvënësi ka parashikuar si element të anës objektive, vetëm kryerjen e saj përmes veprimit të falsifikimit (*pasqyrim të të dhënave të rreme apo fshehjes së tyre*), duke lënë jashtë elementin e përdorimit të dokumentit të falsifikuar, pikërisht nisur nga cilësitë e posaçme të subjektit aktiv të veprës penale, i cili përfaqëson një person zyrtar, i cili për shkak të ligjit apo aktit nënligjor, është i detyruar të lëshojë dokumentin.

Në vendimin Nr.113, datë 27.03.2013, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ndër të tjera arsyeton se: “Format e kryerjes se veprës penale të falsifikimit të dokumenteve janë i) hartimi ose ndërhyrja në dokument dhe ii) përdorimi. Në formën e parë të kryerjes është e domosdoshme zbulimi i autorësisë së falsifikimit.”

Gjykata çmon se, vepra penale e falsifikimit të dokumentave, futet në kategorinë e veprave penale formale, që do të thotë se ajo do të quhet e konsumuar dhe për pasojë autori i saj do të përgjigjet penalisht, atëherë kur realizohet në njërën nga format e përmendura më sipër, pa patur nevojë për ardhjen apo mundësinë e ardhjes së ndonjë pasoje.

Midis veprimeve të autorit të veprës penale dhe falsifikimit të dokumentave apo përdorimit të tyre, duhet të ekzistojë lidhja shkakësore në kuptimin që, dokumenti i falsifikuar apo përdorimi i tij vjen ekskluzivisht dhe vetëm si rezultat i veprimeve të autorit (*nullum crimen, nulla poena sine causa*).

Subjekti, i cili përfaqëson autorin e veprës penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, (në rastet e paragrafit të parë dhe të dytë është subjekt i përgjithshëm, ndërsa në paragrafin e tretë është gjithmonë subjekt i posaçëm, në kuptimin që, përfaqëson një person zyrtar, i cili është i detyruar për shkak të ligjit apo aktit nënligjor që të lëshojë dokumentin dhe që të mbajnë përgjegjësi penale dhe të jetë subjekt i procedimit dhe gjykimit penal), duhet të plotësojë dy kriteret ekskluzive ligjore:

(i).Kriterin e moshës, pra të ketë mbushur moshën 14 vjeç(ndodhemi përpara një krimi).

(ii).Kriterin e përgjegjshmërisë, pra të jetë i aftë të kontrollojë veprimet e tij si dhe të kuptojë rëndësinë e kryerjes së tyre.

Mungesa qoftë e njërit prej këtyre dy kritereve, përbën shkak procedural që ndaj subjektit (*autorit të veprës penale*) të mos fillojë procedimi penal dhe nëse ka filluar ai duhet pushuar, duke proceduar me caktimin e masave mjekësore (*në rastin e papërgjegjshmërisë*) dhe me caktimin e masave edukuese (*në rastin e moshës*).

Nga ana subjektive, vepra penale e “Falsifikimit të dokumentave”, në të gjitha format e saj, kryhet vetëm me dashje direkte, në kuptimin që, autori i veprës penale e parashikon dhe e dëshiron falsifikimin apo përdorimin e dokumentit të falsifikuar, pra ka dijeni rreth falsitetit të dokumentit që vë në përdorim.³

Qëllimi nuk është element cilësues i dispozitës penale konkrete (neni 186), por nisur nga fakti se, nëse ekzistenca apo mungesa e qëllimit ndikon në vetë ekzistencën e figures së veprës penale, e për pasojë edhe në përgjegjësinë penale të autorit të saj, gjykata e çmon me rëndësi t’i referohet jurisprudencës së Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Me Vendimin Nr. 14, datë 04.02.2009, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë shprehet se: *“Vepra penale e falsifikimit të dokumentave, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, kryhet gjithmonë me dashje direkte të autorit, por krahas kësaj është e domosdoshme që të provohet se falsifikimi është bërë me qëllim fitimi ose çdo interesi tjetër personal,”*

Në kuadrin e interpretimit historik, gjykata i referohet me analogji edhe Udhëzimit Nr. 18, datë 07.07.1960 të Pleniumit të Gjykatës së Lartë (*i cili bën fjalë për veprën penale të falsifikimit të monedhave*), sipas së cilit, qëllimi i përfitimit apo çdo lloj interesi tjetër personal, në veprën penale të falsifikimit të monedhave, duhet të ekzistojë gjithmonë, në të kundërt nuk do kemi këtë figurë krim.

Ligjvënësi, në kuadër të ashpërsimit të politikës penale ndaj figurës së veprës penale të parashikuar në nenin 186 të Kodit Penal, ka parashikuar në të njëjtën dispozitë penale, si rrethanë cilësuese (*që do të thotë se kjo figurë vepre penale, e kryer në njërin nga rrethanat cilësuese, mund të qëndronte eventualisht e parashikuar në një dispozitë të veçantë penale*) rastin kur, vepra penale “mëmë”, ajo e “Falsifikimit”, kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një here, ose kur ka sjellë pasoja të rënda.

Në lidhje me rrethanën cilësuese të “përsëritjes”, pra të kryerjes së veprës penale më shumë se një herë, gjykata vlerëson se, për t’u ndodhur përpara kësaj situatë është e nevojshme që, veprimet kriminale të autorit të veprës penale të jenë të tilla që, nga ana objektive, secili veprim kriminal në drejtim të falsifikimit apo përdorimit të dokumentit të falsifikuar, duhet të qëndrojë i mëvetësishëm apo autonom nga tjetri dhe në distanca kohore të tilla, nga i cili nxirret përfundimi se, autori i veprës penale ka cënuar dy raporte juridike të mbrojtura nga ligji, përmes dy apo më shumë veprimeve të kundraligjshme dhe të kryera me faj prej tij.

Neni 248 i Kodit Penal, parashikon se:

³ Vendimi Nr.113, datë 27.03.2013 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Vendimi Nr.186, datë 05.06.2013 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

“Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet.”

Objekti grupor dhe individual i veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”⁴ janë marrëdhëniet juridike të vendosura nga ligjvënësi, me qëllim garantimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë së organeve të administratës shtetërore (*publike*), dhe për të mbrojtur të drejtat e interesat pasurore e jopasurore të shtetit dhe individëve⁵, nga veprimet apo mosveprimet e kundraligjshme, shoqërisht të rrezikshme, të kryera me faj dhe të dënueshme penalisht, të kryera nga personi që ushtron funksione publike. Në çështjen penale objekt gjykimi, objekti apo raportet juridike të vendosura nga ligjvënësi, janë ato marrëdhënie juridike, të cilat lidhen me ligjshmërinë e realizimit të procesit të njoftimit dhe referimit të veprave penale në organin e akuzës nga ana e shërbimeve të policisë gjyqësore, me qëllim ushtrimin e ndjekjes penale dhe vënies përpara përgjegjësisë penale të personave dhe autorëve përgjegjës, të mbrojtura nga veprimet apo mosveprimet e kundraligjshme, të dënueshme penalisht dhe të kryera me faj nga ana e punonjësve të policisë gjyqësore, të cilët ushtrojnë kompetenca në fushën e zbulimit, marrjes dijeni dhe hetimit të veprave penale, të identifikuar si të tilla nga ligji dhe aktet nënligjore në fuqi.

Nga ana objektive, kjo vepër penale, do të quhet e realizuar, vetëm nëse vërtetohet, në mënyrë alternative apo kumulative, fakti se personi publik:

(i).Kryen/ose nuk kryen veprime/apo mosveprime, të cilat konsistojnë në kryerjen e veprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbëjnë mospërbushje të rregullt të detyrës publike, të cilat i kanë sjellë atij përfitime materiale të padrejta, nëse këto veprime/mosveprime nuk përbëjnë vepër tjetër penale.

(ii).Kryen/ose nuk kryen veprime/apo mosveprime, të cilat konsistojnë në kryerjen e veprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbëjnë mospërbushje të rregullt të detyrës publike, të cilat i kanë sjellë personave të tjerë përfitime materiale të padrejta, nëse këto veprime/mosveprime nuk përbëjnë vepër tjetër penale.

(iii).Kryen/ose nuk kryen veprime/apo mosveprime, të cilat konsistojnë në kryerjen e veprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbëjnë mospërbushje të rregullt të detyrës publike, të cilat i kanë sjellë atij përfitime jomateriale të padrejta, nëse këto veprime/mosveprime nuk përbëjnë vepër tjetër penale.

(iv).Kryen/ose nuk kryen veprime/apo mosveprime, të cilat konsistojnë në kryerjen e veprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbëjnë mospërbushje të rregullt të detyrës publike, të cilat i kanë sjellë personave të tjerë përfitime jomateriale të padrejta, nëse këto veprime/mosveprime nuk përbëjnë vepër tjetër penale.

⁴ Seksioni II i Kodit Penal “Veprat penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik”.

⁵ Vendimi Nr.210, datë 03.07.2013, si dhe vendimi Nr.138, datë 14.05.2014 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

(v).Kryen/ose nuk kryen veprime/apo mosveprime, të cilat konsistojnë në kryerjen e veprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbëjnë mospërbushje të rregullt të detyrës publike, të cilat kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, nëse këto veprime/mosveprime nuk përbëjnë vepër tjetër penale.

(vii).Kryen/ose nuk kryen veprime/apo mosveprime, të cilat konsistojnë në kryerjen e veprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbëjnë mospërbushje të rregullt të detyrës publike, të cilat kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetasve, nëse këto veprime/mosveprime nuk përbëjnë vepër tjetër penale.

(viii).Kryen/ose nuk kryen veprime/apo mosveprime, të cilat konsistojnë në kryerjen e veprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbëjnë mospërbushje të rregullt të detyrës publike, të cilat kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të personave juridikë, nëse këto veprime/mosveprime nuk përbëjnë vepër tjetër penale.

Në lidhje me kundraligjshmërinë e veprimit apo të mosveprimit të kryer nga personi publik, si komponent i anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, në vendimin Nr.138, datë 14.05.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, është arritur në përfundimin se: *“Nga pikëpamja objektive kjo vepër penale konsumohet në dy forma kriminale me veprime ose mosveprime të kundërligjshme, të cilat në thelb përbëjnë mospërbushje të rregullt të detyrës nga personi që ushtron funksione publike, veprime këto të kryera në kundërshtim me kuadrin ligjor e nënligjor që sanksionon detyrat e të pandehurit në ushtrim të funksionit publik, ndërsa në rastin e mosveprimit kriminal, subjekti i kësaj vepre nuk ndërmerr veprimet të cilat duhet të kryheshin prej tij në ushtrim të rregullt të detyrës. Është e rëndësishme të provohet se veprimet apo mosveprimet e të pandehurës janë ndërmarrë ose nuk janë kryer gjatë kohës që ka qenë në ushtrim të funksionit, pra të vërtetohet lidhja e tyre me detyrën publike. Nga veprimet ose mosveprimet e subjektit të posaçëm/funksionarit publik duhet të vijë pasoja e parashikuar nga ligji konkretisht sigurimi i përfitimeve materiale ose jomateriale për vete apo persona të tjerë ose dëmtimi i interesave të ligjshme të shtetit apo shtetasve, pra të vërtetohet pasoja kriminale, si element i domosdoshëm i anës objektive të veprës penale.”*

Midis veprimeve apo mosveprimeve të subjektit aktiv të kësaj vepre penale dhe pasojave apo mundësisë së ardhjes së pasojave, duhet të ekzistojë lidhja shkakësore, në kuptimin që, pasojat e ardhura apo mundësia e ardhjes së tyre, vijnë ekskluzivisht dhe vetëm si rezultat i veprimeve apo mosveprimeve të kundraligjshme, të cilat nga ana e tyre përbëjnë mospërbushje të rregullt të detyrës nga ana e personit publik (*funksionarit publik apo personi që kryen një detyrë shtetërore*).

Kjo vepër penale, nga pikëpamja e pasojave që ajo sjell, kategorizohet në veprat penale materiale, të cilat do të quhen të konsumuara vetëm nëse vërtetohet ardhja e pasojës konkrete (*dëmi konkret apo e mundësisë së ardhjes së saj (neni 13 i Kodit Penal)*).

Ky qëndrim është mbajtur edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili në vendimin Nr.5, datë 15.01.2014, ndër të tjera shprehet se: *“Si në pretendimet e prokurorit dhe në arsyetimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, megjithëse pretendohet për ardhje të dëmit, nuk janë evidentuar pasojat efektive të ardhura nga kjo veprimtari, e kryer në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës dhe rrezikshmëria shoqërore e atyre veprimeve. Prandaj, me të drejtë gjykata ka konkluduar se nuk mund të këtë përgjegjësi penale*



në mungesë të pasojave konkrete të ardhura realisht nga veprimet apo mosveprimet e kryera nga të gjykuarit gjatë ushtrimit të detyrës.”⁶

Subjekti, i cili përfaqëson autorin e veprës penale, në rastin e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, ka cilësi të posaçme, sepse në çdo rast, përfaqëson një person publik, i cili ushtron veprimtari publike në emër dhe për llogari të shtetit, dhe që është i ngarkuar nga ligji për kryerjen apo moskryerjen e veprimeve apo mosveprimeve, me qëllim përmbushjen e rregullt të detyrës dhe që të mbajë përgjegjësi penale dhe të jetë subjekt i procedimit dhe gjykimit penal, duhet të ketë mbushur moshën 14 vjeç (*pasi ndodhemi përpara një krimi*), si dhe të jetë i aftë të kontrollojë veprimet e tij si dhe të kuptojë rëndësinë e kryerjes së tyre.

Nga ana subjektive, kjo vepër penale, kryhet vetëm me dashje (direkte apo indirekte)⁷, në kuptimin që, autori i veprës penale është në dijeni të faktit se, veprimet apo mosveprimet e tij, vijnë në kundërshtim me ligjin dhe përfaqësojnë mospërmbushje të rregullt të detyrës së tij dhe pavarësisht këtij fakti, ai i realizon ato, duke sjellë si pasojë dëmtimin e interesave të ligjshëm të shtetit, personave fizikë apo juridikë.

Qëllimi është element cilësues i kësaj vepre penale, sepse lidhet pikërisht me pikësynimin kriminal që autori i veprës penale synon të arrijë, e konkretisht përfitimin material ose jomaterial, për veten apo persona të tjerë, dhe duke shkatuar si pasojë dëmtimin e interesave të ligjshëm të shtetit, personave fizikë apo juridikë.

Motivi nuk është element cilësues i kësaj vepre penale, por eventualisht mund të ndikojë në individualizimin e llojit dhe vëprës penale.

Neni 287,i Kodit Penal ⁸, parashikon se:

Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, nëpërmjet:

a) këmbimit ose transferimit të pasurisë, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, duke ditur se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;

b) fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pasurinë, duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;

c) fitimit të pronësisë, posedimit ose përdorimit të pasurisë, duke e ditur në çastin e marrjes në dorëzim të saj, që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale; ç) kryerjes së veprimeve financiare ose transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi, sipas legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave;

d) investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave a sendeve, duke ditur se janë produkte të veprës penale ose veprimtarisë kriminale;

dh) këshillimit, ndihmës, nxitjes ose thirrjes publike për kryerjen e secilës prej veprave të përcaktuara më sipër; - dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.

⁶ Shih përsëri vendimi Nr.138, datë 14.05.2014 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

⁷ Vendimi Nr.5, datë 15.01.2014, vendimi Nr.138, datë 14.05.2014, vendimi Nr.210, datë 03.07.2014 dhe vendimi Nr.193, datë 05.06.2013 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

⁸ Nga një interpretim literal dhe logjik të dispozitës, arrihet në përfundimin se, produktet të cilat synohen të pastrohen mund të vijnë si rezultat i kryerjes së një krimi apo edhe të një kundravajtje penale. Kjo sipas nenit 1 të Kodit Penal, ku parashikohet se: “Veprat penale ndahen në krime dhe në kundravajtje penale.”

Kur kjo veprë kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale, në bashkë E njëjta veprë, kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet me burgim .

Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe kur:

a) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person që nuk mund të merret si i pandehur ose që nuk mund të dënohet;

b) ndjekja penale për veprën, produktet e së cilës pastrohen, është parashkruar ose amnistuar;

c) personi që kryen pastrimin e produkteve është i njëjtë me personin që ka kryer veprën, nga e cila kanë rrjedhur produktet;

ç) për veprën penale, nga e cila kanë ardhur produktet, nuk është filluar asnjëherë çështja penale apo nuk është dhënë një dënim me vendim penal të formës së prerë;

d) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person, pavarësisht shtetësisë së tij, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe është njëkohësisht e dënueshme, si në shtetin e huaj, ashtu edhe në Republikën e Shqipërisë. Dijenja dhe qëllimi, sipas paragrafit të parë të këtij neni, nxirren nga rrethana fakti objective”

Gjykata vlerëson se, parashikimi i nenit 287, pika 1, shkronja “b” e Kodit Penal, është e njëjtë me parashikimin e nenit 9, pika 1, shkronja “b” të Konventës së Këshillit të Europës “Për Pastrimin, Kërkimin, Kapjen dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit dhe Për Financimin e Terrorizmit”⁹.

Gjykata vlerëson se, ekzistenca e kësaj figure krimi, është shprehje e politikës penale të ligjvënësit, i cili nisur nga kushtet aktuale social ekonomike, formave të ndryshme të shfaqjes së kriminalitetit dhe ratifikimit të instrumentave ndërkombëtare si konventa e lartpërmendur, synon parandalimin dhe goditjen e fenomenit të pastrimit të produkteve të veprës penale.

Neni 1 i Konventës së Këshillit të Europës “Për Pastrimin, Kërkimin, Kapjen dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit dhe Për Financimin e Terrorizmit” jep këtë përkufizim: “Për qëllime të kësaj Konvente:

a) “produkt” nënkupton çdo avantazh ekonomik të nxjerrë nga veprat penale. Ky avantazh mund të konsistojë në çdo pasuri, siç përcaktohet në nënparagrafin b të këtij neni;

b) “pasuri” nënkupton pasuri të çdo natyre, fizike ose jofizike, e huajtshme ose e paluajtshme, si dhe aktet juridike ose dokumentet që vërtetojnë një titull ose interes mbi këtë pasuri;”

Nocionin e “produktit të veprës penale” e konstatojmë edhe në nenin 36 të Kodit Penal, i cili parashikon se: “1.Konfiskimi jepet detyrimisht nga gjykata dhe ka të bëjë me marrjen dhe kalimin në favor të shtetit:

a) të sendeve që kanë shërbyer ose janë caktuar si mjete për kryerjen e veprës penale;

b) të produkteve të veprës penale, ku përfshihet çdo lloj pasurie, si dhe dokumentet ose instrumentet ligjore që vërtetojnë tituj ose interesa të tjerë në pasurinë që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale;”.

Gjykata vlerëson se, parashikimi i nenit 36 të Kodit Penal në lidhje me nocionin e “produktit të veprës penale” është i ngjashëm me atë të nenit 1 të Konventës së Këshillit të

⁹ Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin Nr.9646, datë 27.11.2006 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për Pastrimin, Kërkimin, Kapjen, dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit dhe Për Financimin e Terrorizmit.”

Europës “Për Pastrimin, Kërkimin, Kapjen dhe Konfiskimin e Produkteteve të Krimit dhe Për Financimin e Terrorizmit”, që do të thotë se, produkt të veprës penale, do të kuptojmë çdo avantazh ekonomik i nxjerrë nga një vepër penale, i cili mund të konsistojë në pasuri të çdo natyre si dhe në dokumenta apo akte juridike që vërtetojnë një titull apo një interes mbi këtë pasuri.

Objekti juridik i kësaj vepre penale përfaqëson tërësinë e marrëdhënieve juridike të vendosura nga ligjvënësi me qëllim garantimin e funksionimit të rregullt dhe normal të organeve të administratës publike dhe mbrojtja e interesit të shtetit dhe shtetasve nga pastrimi i produkteve të veprës penale.

Objekti material përfaqëson vetë produktin e veprës penale që pastrohet.

Nga ana objektive, kjo vepër penale kryhet përmes veprimeve aktive të autorit të veprës, të cilat bien brenda parashikimeve të njëres nga format e parashikuara në nenin 287 të Kodit Penal.

Midis veprimeve të autorit të veprës penale (që synojnë pastrimin e produktit të veprës penale) dhe pasojës apo mundësisë së ardhjes së pasojës (pastrimi i produktit të veprës penale), duhet të ekzistojë lidhje shkakësore, në kuptimin që realizimi i pastrimit të produktit të veprës penale (pasoja) të vijë ekskluzivisht dhe drejtpërdrejtë nga veprimet e autorit të veprës penale (shkaku).

Gjykata e çmon me rëndësi në këtë pikë, të evidentojë faktin se midis produktit të veprës penale (vepra penale mëmë) nga njëra anë dhe veprës penale të pastrimit të këtij produkti (vepra penale bijë), duhet të ekzistojë gjithmonë lidhje shkakësore ekskluzive dhe e domosdoshme (*condicio sine qua non*).

Nga ana subjektive vepra penale e pastrimit të produkteve të veprës penale, kryhet vetëm me dashje direkte¹⁰, në kuptimin që, autori i veprës penale e parashikon dhe e dëshiron ardhjen e pasojës (pastrimin e produktit të veprës penale), pra ai ka dijeni se pasuria apo avantazhi ekonomik (shih më sipër përkufizimin) i ardhur nga vepra penale mëmë, përbën produkt të veprës penale dhe dëshiron që këtë produkt ta pastrojë përmes veprimeve aktive të realizuara në njërin nga format e parashikuara në nenin 287 të Kodit Penal. Qëllimi është element cilësues i dispozitës konkrete dhe ai konsiston në: (i).Fshehjen, mbulimin e origjinës së pasurisë ose dhënien e ndihmës, për të shmangur pasojat juridike, që lidhen me kryerjen e veprës penale. (ii).Shmangien nga raportimi sipas ligjit për pastrimin e parave.

Pra, autori i veprës penale, veprimtarinë e tij kriminale e kryen duke e ditur që avantazhet apo pasuria që ai disponon janë produkt i veprës penale dhe synon t’i pastrojë ato, duke i dhënë trajtën e një pasurie apo avantazhi ekonomik të ligjshëm.

Gjykata çmon se, pastrimi i produkteve të veprës penale nuk përfaqëson një akt të vetëm, por përfshin një proces, i cili synon jo vetëm fshehjen e origjinës së vetë produktit, por edhe mbajtjen nën kontroll të tij dhe ky proces, zakonisht kalon nëpër tre faza, të cilat janë:

(i).Vendosja e produktit të veprës penale;

¹⁰ Neni 15 i Kodit Penal.

(ii).Shtresëzimi, i cili përfaqëson përpjekjen e autorit të veprës penale për të realizuar ndarjen e produktit nga burimi kriminal, duke krijuar rrjete komplekse transaksionesh financiare;

(iii).Integrimi, i cili përfaqëson epilogun e procesit të pastrimit të produkteve të veprës penale, në të cilin ky produkt (zakonisht para) integrohet në ekonominë e ligjshme dhe bashkohet me asetet e tjera të ligjshme, duke e bërë mjaft të vështirë ndarjen midis pasurisë së ligjshme dhe asaj të paligjshme.

(ii).Në lidhje me natyrën juridike të institutit të bashkëpunimit.

Neni 25 i Kodit Penal parashikon se: “Bashkëpunim quhet kryerja e veprës penale nga dy ose më shumë persona me marrëveshje ndërmjet tyre.”.

Në lidhje me rrethanën rënduese të “bashkëpunimit”, ligjvënësi ka sanksionuar në nenin 25 të Kodit Penal, kuptimin e institutit të bashkëpunimit, sipas së cilit, kërkohet bashkekzistenca e dy elementeve të rëndësishëm:

- (i).Së pari, vepra të jetë kryer nga dy ose më shumë persona.
- (ii).Së dyti, kjo vepër të jetë kryer në marrëveshje ndërmjet tyre.

Ligjvënësi, duke përdorur si kritere juridike natyrën juridike të bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale, shtrirjen kohore të tij, qëndrueshmërinë dhe rrezikshmërinë shoqërore të tij, në nenet 25 dhe 28¹¹ të Kodit Penal, ka sanksionuar dy forma kryesore të bashkëpunimit:

-Së pari, bashkëpunimin e thjeshtë në kryerjen e veprës penale, i cili i referohet rastit kalsik të kryerjes së veprës penale nga dy apo më shumë persona, në marrëveshje midis tyre, marrëveshje e cila mund të jetë bërë në çfarëdo forme, përpara apo gjatë kryerjes së veprës penale dhe e cila nga ana e saj, me interpretim përjashtues nuk futet në ato forma të bashkëpunimit, të cilat karakterizohen nga shtrirja më e gjatë kohore, si dhe nga qëndrueshmëria më e lartë e tyre.

-Së dyti, format e posaçme të bashkëpunimit, të cilat ligjvënësi i ka parashikuar në mënyrë shteruese:

- i.Organizatrat kriminale.
- ii.Organizatrat terroriste.
- iii.Bandat e armatosura.
- iv.Grupi i strukturuar kriminal.

Gjykata vlerëson se, në kuadrin historik, format e posaçme të bashkëpunimit, janë transpozuar në Kodin Penal shqiptar, me miratimin nga ana e ligjvënësit të Ligjit Nr.9275, datë 16.09.2004 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin penal të Republikës së Shqipërisë”¹², si rezultat i ratifikimit të “Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar” (*Konventa e Palermos*).¹³, e cila pas botimit në fletoren zyrtare bëhet pjesë e

¹¹ Neni 28 i Kodit Penal me titull “Format e veçanta të bashkëpunimit”.

¹² Botuar në Fletoren Zyrtare Nr.69, datë 07.10.2004.

¹³ Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr.8920, datë 11.07.2002, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.41, Korrik 2002.



sistemit të brëndshëm normativ, duke prevaluar në rang hierarkik edhe mbi ligjet e vendit, të cilat vijnë në kundërshtim me të.¹⁴

Këto forma të posaçme të bashkëpunimit, krahas elementëve të përgjithshëm që u përmenden tek bashkëpunimi i thjeshtë, kërkojnë prezencën e disa elementëve karakteristikë, vërtetimi i së cilëve sjell si pasojë kualifikimin juridik të veprës penale sipas dispozitave të pjesës së posaçme të këtij Kodi (*nenet 333, 333/a, 334 dhe 334/1 të Kodit Penal*) dhe këto elementë janë:

i. Numri i bashkëpunëtorëve, i cili pavarësisht se, në kuptim të nenit 28 të Kodit Penal, duhet të jetë jo më i vogël se 2(dy)¹⁵ apo 3(tre)¹⁶, zakonisht është shumë herë më i madh.

ii. Ekzistenca e një qëllimi kriminal të përbashkët, i cili synohet të arrihet nga të gjithë pjesëtarët e secilës formë të posaçme të bashkëpunimit.

iii. Kohëzgjatja dhe shtrirja kohore relativisht e gjatë e aktivitetit kriminal, në funksion të arritjes së qëllimit kriminal.

iv. Qëndrueshmëria dhe kompaktësia e madhe e vetë formës së posaçme të bashkëpunimit, e cila karakterizohet nga ndarja e roleve, financimi i aktivitetit kriminal, si dhe kryerjes së këtij aktiviteti kriminal.

Në lidhje me institutin material të bashkëpunimit, në të dyja format e tij, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin unifikues penal Nr.4, datë 15.04.2011, kanë arritur në përfundimin unifikues se: *“Sikurse u analizua më sipër, nga pikëpamja e anës objektive kërkohet që vepra penale të jetë kryer nga jo më pak se dy persona, pra të provohet që në kryerjen e saj të kenë marrë pjesë më shumë se një person, pavarësisht rolit dhe veprimeve të kryera nga secili prej tyre, të cilat çmohen dhe përcaktohen nga gjykatat e faktit referuar rrethanave të faktit, në përputhje me parashikimet e nenit 26 të Kodit Penal. Nga pikëpamja e anës subjektive kërkohet gjithashtu marrëveshja e këtyre personave në kryerjen e veprës penale”.*

Për sa sipër, në të njëjtin vendim unifikues, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin unifikues se: *“Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se që të ndodhemi në kushtet e bashkëpunimit duhet të bashkekzistojnë si kushte sine qua non:*

- 1. dy ose më shumë subjekte (pluralitet personash);*
- 2. realizimi i faktit kriminal në të gjithë elementet e tij materiale;*
- 3. dhënia e një kontributi rilevant në kryerjen e veprës penale nga secili prej bashkëpunëtorëve;*
- 4. ana subjektive, të paktën në formën e saj minimale, që është dijenia e të paktën njërit prej bashkëpunëtorëve për të bashkëpunuar me të tjerët në kryerjen e faktit kriminal. Kolegjet e Bashkuara theksojnë se karakteristikë e veprës penale të kryer në bashkëpunim është uniteti i anës subjektive të veprës penale të kryer në bashkëpunim. Verifikimi i katër elementeve të mësipërm bën që vepra penale të cilësohet e kryer në bashkëpunim, pavarësisht rolit që ka kryer secili prej bashkëpunëtorëve në realizimin e veprës*

¹⁴ Nenet 116 dhe 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

¹⁵ Organizata terroriste.

¹⁶ Organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal.



penale me veprimet apo mosveprimet e tij dhe pavarësisht përgjegjësisë penale që ai mban për këto veprime a mosveprime, përcaktimi i të cilave i takon rrethanave të faktit të provuara në gjykim”.

Kolegjet e Bashkuara theksojnë se parimi i autonomisë së përgjegjësisë shfaqet në bashkëpunimin e dy ose më shumë personave në kryerjen e veprës penale në formën e dhënies të secilit prej tyre të një kontributi material ose moral në kryerjen e veprës penale. Në këtë drejtim doktrina ka pranuar se për të qenë në kushtet e bashkëpunimit, «... mjafton që pjesëmarrësi të ketë influencë mbi një detaj të veprimit kriminal të ndërmarrë, qoftë lidhur me të mirën apo të drejtën e mbrojtur, qoftë lidhur me planin organizues ...» Në këtë logjikë përfshihen si veprimet *ex ante*, ashtu edhe ato *ex post* të autorit në kryerjen e veprës penale, me kushtin që të kenë ndikuar apo të kenë synuar pasojën kriminale.¹⁷

(iii).Mungesa e konkurimit midis 186 dhe 248.

Gjykata vlerëson se, elementi i fundit i jep veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, natyrën e një vepre penale, me karakter të përgjithshëm (*lex generalis*), e cila do të aplikohet në të gjitha ato raste kur, nga veprimet apo mosveprimet e një funksion publik, nuk konstatohen elementë të ndonjë figure tjetër vepre penale konkrete (*lex specialis*), e cila sidoqoftë konsumohet gjatë ose për shkak të detyrës së këtij funksionari.

Gjykata çmon se, jo vetëm *prima facie*, por edhe në substancë, kjo figurë vepre penale e përjashton logjikisht dhe *ipso lege*, konkurrimin me veprën penale të “Falsifikimit të dokumentave”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pasi elementët e saj janë pjesë përbërëse e kësaj vepre penale dhe pikërisht për këtë shkak, janë shkëputur nga ana e ligjvënësit, duke e shfaqur si një figurë konkrete të veprës penale, e kryer nga personi zyrtar, i cili ka për detyrë që të lëshojë dokumentin, duke cënuar një raport juridik ekskluziv të mbrojtur nga ligjvënësi, i cili konsiston në garantimin dhe respektimin e ligjshmërisë së lëshimit të dokumenteve zyrtare nga ana e organit administrativ, i cili ka si kompetencë dhe detyrë lëshimin e tij.

(iv).Mungesa e bashkëpunimit midis subjektit të posaçëm dhe subjektit të përgjithshëm.

Pavarësisht faktit se, nga ana objektive dhe subjektive, mund të rezultojë e provuar dijenia e të dy subjekteve, në lidhje me kundraligjshmërinë e veprimeve përkatëse, të kryera në mënyrë të pavarur nga ana e tyre dhe dëshira e përbashkët për ardhjen e pasojës kriminale, si dhe për realizimin e qëllimit të përbashkët kriminal, nuk mund të arrijmë në përfundimin se, figura e veprës penale konkrete, e cila eventualisht është e ndryshme për secilin subjekt, është kryer në bashkëpunim midis subjektit të përgjithshëm dhe atij të posaçëm.

Në arritjen e këtij përfundimi, gjykata i referohet me analogji edhe vendimit unifikues penal 01, datë 12.03.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, i cili trajton përgjegjësinë penale të punonjësit të doganës, që kryen kontrabandë, në bashkëpunim me një subjekt të përgjithshëm, sipas së cilit: “Eshte e vertete qe, ashtu sikurse pretendohet ne rekursin e paraqitur nga organi i prokurorise, (pretendim ky i perseritur edhe nga perfaqesuesi i ketij organi gjate gjykimit te ceshtjes ne Gjykatën e Lartë) kur vepra penale

¹⁷ Vendimi Unifikues Penal Nr.4, datë 15.04.2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

kryhet ne bashkepunim, si rregull, bashkepunetoret duhet te pergjigjen per vepren penale te parashikuar nga e njejta dispozite e Pjeses se Posacme te Kodit Penal. Por, kjo ka te beje me pergjegjesine penale te bashkepunetoreve ne kryerjen e veprave penale ne rastet kur ndodhemi para ndarjes klasike te roleve, ne organizatore, shtytes dhe ndihmes dhe jo edhe kur shtrohet problemi i pergjegjesise penale te bashkezekutoreve te nje vepre penale, ku, sic u permend, ndodhemi perpara ndarjes se puneve midis pjesemarrsesve ne nje veprimtari te caktuar kriminale, sikurse ne rastin ne gjykim dhe jo perpara ndarjes se roleve.”

Në rrethanat e përmendura më lart Gjykata vlerëson se provohet plotësisht se nga përfituesit e këtyre pronave të pandehurit **Raimond Mëzi dhe Lefter Gjergji** janë kryer veprat penale “Falsifikimi i dokumentave” parashikuar nga neni 186/2 dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale” parashikuar nga neni 287/3 i Kodit Penal

Mbi bazën e të dhënave të mësipërme provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri Raimond Mëzi, në bashkëpunim me të pandehurën Blerina Dhrami (Brahimi) dhe persona të pidentifikuar dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka përfituar, regjistruar dhe tjetërsuar një sipërfaqe prone prej 220 Ha, në vendin e quajtur Karaburun, Vlorë, si dhe një sipërfaqe prone prej 89 Ha, në vendin e quajtur “Shen Velash”, Vlorë, me dokumente tërësisht të falsifikuara. Provohet se dokumentet e falsifikuara mbi bazën e të cilës është përfituar kjo pasuri është e gjithë dosja gjyqësore që i përket vendimit gjyqësor civil nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, si dhe e gjithë dosja gjyqësore që i përket vendimit gjyqësor civil nr. 2217, datë 29/12/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Rezulton e provuar se këto dy dosje gjyqësore dhe aktet e ndodhura në to janë tërësisht të falsifikuara, si dhe janë futur në kundërshtim me ligjin në arkivën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Për të fshehur këtë veprimtari të kundërligjshme, rezulton se të dhënat e pasqyruara në këto dosje gjyqësore janë pasqyruar edhe në tre regjistra që ndodheshin të administruara në arkivën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Konkretisht janë pasqyruar të dhënat e këtyre dosjeve gjyqësore në Regjistrin Civil Themeltar, në Numratorin Civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në Indeksën e Vendimeve Civile të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, regjistra që ndodheshin të arkivuara në mjedise të ndryshme të arkivës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Gjithashtu provohet se edhe dosjet fizike që u përkasin vendimeve të mësipërme të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë janë sistemuar dhe arkivuar në vendin përkatës ku ndodheshin dosjet gjyqësore që i përkisnin muajit dhjetor të vitit 2000 dhe muajit dhjetor të vitit 2003. Rezulton e provuar se pasi janë falsifikuar dosjet e mësipërme gjyqësore dhe janë bërë pjesë të arkivit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i pandehuri Raimond Mëzi në bashkëpunim me persona të pidentifikuar dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Blerina Dhrami (Brahimi), ka arritur të rregjistrojë pronën e përfituar mbi bazën e dokumenteve të falsifikuara, si dhe ka kryer veprime juridike me qëllim fshjen e origjinës së paligjshme të kësaj prone të paluajtshme. Për rrjedhojë provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri Raimond Mëzi ka konsumuar elementët e veprave penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, që ka sjellë pasoja të rënda dhe të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 186/2 dhe 287/3 dhe 25 të Kodit Penal.

Fajësia në ngarkim të Raimond Mëzi provohet nga provat e cituara në mënyrë të hollësishme dhe analiza e tyre e përshkruar më lart (fq 11-28 e këtij vendimi).

Bazuar në të dhënat e mësipërme provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se dhe i pandehuri Lefter Gjergji në bashkëpunim me të pandehurën Blerina Dhrami (Brahimi) dhe persona të pidentifikuar dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Z.R.K.K.P.Vlorë ose A.K.K.P. Tiranë ka përfituar nëpërmjet dokumenteve të falsifikuara një sipërfaqe prone prej 330,000 m², tokë kullotë, pranë bregdetit të Palasës, Himarë, në vendin e quajtur "Adhendra". Më pas, nga viti 2012 e në vijim, pjesën më të madhe të kësaj toke e ka shitur apo dhuruar tek persona të tjerë, me qëllim mbulimin e origjinës së saj të paligjshme. Rezulton e provuar se i pandehuri Lefter Gjergji, me ndihmën e personave të pidentifikuar dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka arritur që të falsifikojë aktet e dosjes gjyqësore që i përkasin vendimit nr.1568, datë 02.10.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, si dhe ka falsifikuar vendimin nr.1568, datë 02.10.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Provohet se i pandehuri Lefter Gjergji ka falsifikuar edhe vendimin nr. 168, datë 14.06.2006; nr. 168 prot., datë 19.06. 2006, të Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Qarkut Vlorë. Pas falsifikimit të këtyre dokumenteve, i pandehuri Lefter Gjergji në bashkëpunim me të pandehurën Blerina Dhrami (Brahimi), ka regjistruar pasurinë e mësipërme në regjistrat publik pranë ZVRPP Vlorë, si dhe ka kryer veprime juridike mbi këtë pasuri, me qëllimin e vetëm fshehjen e origjinës së paligjshme të kësaj pasurie. Për rrjedhojë provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri Lefter Gjergji ka konsumuar elementët e veprave penale "Falsifikimi i dokumenteve", të kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", që ka sjellë pasoja të rënda, parashikuar nga nenet 186/2 dhe 287/3 të Kodit Penal.

Fajësia në ngarkim të Lefter Gjergji provohet nga provat e cituara në mënyrë të hollësishme dhe analiza e tyre e përshkruar më lart (fq 29-40 e këtij vendimi).

Vepra penale "Falsifikimi i dokumentave" parashikuar nga neni 186/2 është kryer në bashkëpunim (nga secili prej këtyre të pandehurve ,të cilët nuk kanë lidhje me njëri tjetrin) për shkak se këto akte janë falsifikuar dhe janë kryer veprimet për krijimin e dosjeve Nr.1360 vendimi datë 29.12.2000,Nr 2217 vendimi datë 29.12.2003,(për Raimond Mëzi),falsifikimin e akteve në dosjen me Nr.1568 vendimi datë 02.10.2003(në emër të Th Gjergji), futjen dhe regjistrimet në regjistrat përkatës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe dosjen Nr. 168 vendimi datë 14.07.2006 të KVKKPronave Qarku Vlorë në emër të subjektit Theotoq Gjergji, regjistrimin e tyre pranë ZVRPPalujtshme Vlorë,veprime të cilat nuk mund të kryheshin nga një person i vetëm,pa bashkëpunimin me punonjësve të këtyre institucioneve.

Nisur nga shumat e transaksioneve të kryera Gjykata vlerëson të bazuar akuzën e paarshikuar nga neni 287/3 i Kodit Penal (me pasoja të rënda).

Ne lidhje me të pandehurin **Enkes Hysendhima** gjykata arrin në përfundimin se nuk provohet kryerja e veprave penale nga ana e këtij të pandehuri.

Organi i akuzës ka arritur në konkluzionin se:

“Mbi bazën e vendimit të gjykatës, më datën 31/05/2016, është kryer kontrolli i zyrës së avoktit Enkes Hysendhima. Gjatë kontrollit të zyrës janë gjetur dhe sekuestruar dokumente e prova materiale që lidhen me veprën penale. Konkretisht janë sekuestruar disa copa fletësh të grisura, ku nga bashkimi i tyre formohet një çertifikatë për vërtetim pronësie në emër të shtetasës Renata Troqe, një vërtetim nga dokumentet hipotekore në emër të shtetasit Gëzim Bajrami, që mban vulën e noteres Belona Seraj, si dhe një plan rievimi që mban vulën e noteres Belona Seraj. Gjithashtu nga kontrolli i ushtruar në zyrën e avokatit Enkes Hysendhima është sekuestruar kerkesë padia e shtetasve Malo Bodo dhe Isuf Bodo, kundër të paditurve Raimond Mëzi, etj, si dhe të gjitha provat e aktet që i janë bashkëngjitur kësaj padie. Po ashtu, është sekuestruar vendimi gjyqësor nr. 2762, datë 19/12/2005 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, bashkë me aktet përkatëse të dosjes gjyqësore. Ky vendim gjyqësor i përket kërkuesit Isuf Bodo me objekt vërtetimin e faktit juridik të bashkëpronësisë së shtetasve Sadik, Jemin e Shyqyri Bodo, për një sipërfaqe prone prej 315 ha, dhe të një sipërfaqe prone prej 188 ha, që ndodhen në gadishullin e Karaburunit, pra pikërisht për pronën objekt hetimi prej 220 ha. Nga këto të dhëna provohet bashkëpunimi ndërmjet të pandehurve Raimond Mëzi dhe Enkes Hysendhima.

... rezulton e provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri Enkes Hysendhima, në bashkëpunim me të pandehurit Raimond Mëzi, Donika Besimaj dhe Blerina Dhrami (Brahimi), ka regjistruar dy pronat e mësipërme pranë ZVRPP Vlorë, si dhe ka kryer veprime juridike mbi këto pasuri, me qëllim fshehjen e origjinës së paligjshme të tyre. Rezulton e provuar se i pandehuri Enkes Hysendhima, fillimisht ka falsifikuar aktet dhe vendimet e dy dosjeve gjyqësore të mësipërme, të cilat në bashkëpunim me të pandehurit Raimond Mëzi dhe Donika Besimaj, i kanë bërë pjesë të arkivës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Pasi këto dosje dhe vendime gjyqësore tërësisht të falsifikuara, janë pasqyruar sikur ndodheshin në arkivën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, rezulton se e pandehura Donika Besimaj, u ka vënë në dispozicion kopje të këtyre dy dosjeve gjyqësore dhe vendimeve gjyqësore të pandehurve Enkes Hysendhima dhe Raimond Mëzi. Mbi bazën e këtyre dokumenteve tërësisht të falsifikuara, të pandehurit Enkes Hysendhima dhe Raimond Mëzi, në bashkëpunim me të pandehurën Blerina Dhrami (Brahimi), kanë arritur që të regjistrojnë këto dy vendime gjyqësore ne regjistrat publik pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë. Provohet se pasi të pandehurit Enkes Hysendhima dhe Raimond Mëzi, janë pajisur nga e pandehura Blerina Dhrami (Brahimi) me dokumentet vërtetim nga dokumentet hipotekor për pasuritë e regjistruara mbi bazën e dy vendimeve gjyqësore tërësisht të falsifikuara, këta të fundit në bashkëpunim me njëri tjetrin kanë tjetërsuar pasurinë e përfituar mbi bazën e dokumenteve të falsifikuara, duke konsumuar veprën penale të parashikuar nga neni 287/3 e 25 të Kodit Penal. Për rrjedhojë provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri Enkes Hysendhima ka konsumuar elementët e veprave penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, që ka sjellë pasoja të rënda dhe të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 186/2 dhe 287/3 dhe 25 të Kodit Penal”.

Gjykata arrin në përfundimin se:

Nuk provohet falsifikimi apo dijenia e të pandehurit Enkes Hysendhima në lidhje me përmbajtjen e eventualisht të falsifikuar të dokumentave të pronësisë në emër të shtetasit Raimond Mëzi. Sikurse është arsyetuar më lart këto dokumenta janë falsifikuar para rregjistrimit të tyre në datë 12.10.2012. Nga provat e paraqitura nga akuza nuk rezulton që në këto kohë të ketë pasur njohje e aq me tepër marrveshje midis të pandehurit Enkes Hysendhima, Raimond Mëzi, Blerina Brahimi (Dhrami) apo ndonjë punonjësi që kishte akses në arkivën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

I pandehuri Enkes Hysendhima në atë periudhë punonte si jurist në Bashkinë Orikum.

Nga akti i ekspertimit grafik të shkrimit dhe nënshkrimit, nga ana e ekspertit nuk u arrit të konkludohej me një përfundim objektiv dhe kategorik lidhur me autoresinë e të pandehurit Enkes Hysendhima, për kryerjen e veprës penale të "Falsifikimit të dokumentave", në asnjërin nga format e parashikuara në ligj;

Nga aktet bashkëlidhur kërkesës për gjykim dhe të administruar në fashikullin gjyqësor, nuk rezulton i provuar fakti se dokumentacioni i kontestuar është depozituar prej të pandehurit, pasi aktet shkresore të administruara gjatë hetimeve paraprake, provojnë tërësisht të kundërtën;

I pandehuri Enkes Hysendhima transaksionet e pronave të shtetasit Raimond Mëzi, i ka kryer në kuader të veprimeve të lejuara dhe të kërkuara nga i përfaqësuarit prej tij, nëpërmjet prokurave përkatëse të lëshuara në emër të tij pas datës 11.08.2014.

Fakti që në zyrën e tij janë gjeur kërkesëpadi dhe dokumenta që i përkasin Isuf Bodo nuk provon asgjë në lidhje me akuzën. Rezulton e provuar se ky proces gjyqësor ka filluar pas zgjedhjes si avokat i të pandehurit Enkes Hysendhima nga i pandehuri Raimond Mëzi dhe fakti që në zyrën e tij janë gjetur kërkesëpadi dhe akte të pronësisë së Isuf Bodo, duke qënë përfaqësues i palës në gjykim është plotësisht i justifikuar dhe i ligjshëm.

Gjatë hetimeve paraprake të kryera në funksion të këtij procedimi penal, nuk rezultoi që i pandehuri Enkes Hysendhima, të ketë patur për vete apo për të tretë perfitime materiale si rrjedhojë e transaksionit të kryer për llogari të të përfaqësuarit prej tij. Nuk janë evidentuar as pasuri e paluajtshme dhe as shumë të hollash të përfituara nga ky i pandehur si rezultat i këtyre transaksioneve ose ndonjë veprimi tjetër të kryer prej tij brenda tagrave të prokurave apo në kapërcim të tyre. Veprimet e kryera prej tij në lidhje me tjetërsimin e pronave kanë qënë brenda tagrave të prokurave dhe shumë e paguara kanë kaluar në favor të të pandehurit Raimond Mëzi, fakt të cilin ky i pandehur e ka pohuar dhenë kërkimet përfundimtare.

Në këto rrethana Gjykata vlerëson se nuk provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri E Hysendhima ka falsifikuar dosjen gjyqësore që i përket vendimit gjyqësor civil nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, dosjen gjyqësore që i përket vendimit gjyqësor civil nr. 2217, datë 29/12/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë apo të ketë pasur dijeni se ato kanë qënë të falsifikuara si dhe të ketë kryer veprime për rregjistrimin e tyre pranë Z.V.R.P. Paluajtshme Vlorë.

Në rrethanat kur nuk provohet kryerja e veprës penale "Falsifikimi i dokumentave" parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal në formën e falsifikimit apo përdorimit të tyre rrjedhimisht nuk provohet as kryerja e veprës penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" parashikuar nga neni 287/3 i Kodit Penal në kushtet kur gjatë hetimit dhe gjyqimit nuk është provuar se ai ka përfituar për vete apo persona të tretë të lidhur me të nga produktet e kësaj vepre penale, pasuri të paluajtshme në natyrë ose në shuma të hollash si rezultat i transaksioneve të kryera me pasurinë.

Akuza mbështetet kryesisht në deklaratimet e bashkëtpandehurit Raimond Mëzi, deklaratimet të cilat janë kontradiktore. Në kërkimet përfundimtare ai ka deklaruar se dokumentat i ka marrë ai dhe ja ka dhënë avokatit në vitin 2014 dhe vlerat e përfituara nga shitjet i ka tërhequr ai.

Në këtë gjykim Gjykata arrin në përfundimin se nuk ka prova të mjaftueshme për të konkluduar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri Enkes Hysendhima ka konsumuar elementët e veprave penale “Falsifikimi i dokumentave” parashikuar nga neni 186/2 dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” parashikuar nga neni 287/3 i Kodit Penal dhe për këtë shkak akuza ndaj tij vleresohet e dyshimtë.

K.Pr.Penale parashikon:

Neni 4

“1. I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formes së prerë. **Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit.**

2. Gjykata jep vendim fajësie kur i pandehuri rezulton fajtor për faktin penal që i atribuohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm”.

Neni 390

Dënimi i të pandehurit

1. Kur fajësia e të pandehurit provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, gjykata jep vendim dënimi, duke caktuar llojin dhe masën e dënimit.

2. Gjykata nuk mund të bazojë vendimin e fajësisë vetëm mbi deklaratimet e bëra nga personi, i cili, me vullnetin e tij, nuk ka pranuar të pyetet nga i pandehuri ose nga mbrojtësi i tij në asnjërin nga fazat e procedimit.

3. **Gjykata nuk mund të bazojë vendimin e fajësisë vetëm ose kryesisht në deklaratimet e bashkëtpandehurit, apo dëshmitë e marra nëpërmjet teknikave të veçanta për fshehjen e identitetit të dëshmitarit, sipas nenit 361/b të këtij Kodi”.**

Në rrethanat e përmendura më lart Gjykata vlerëson i pandehuri duhet të deklarohet i pafajshëm bazuar në nenin 388/1 të Kodit Procedurës Penale që parashikon:

“1. Gjykata merr vendim pafajësie kur;

d); nuk provohet se i pandehuri e ka kryer veprën që akuzohet”.

Në lidhje me të pandehurën **Blerina Dhrami (Brahimi)** Gjykata vlerëson se provohet plotësisht se ajo e ka kryer veprën penale “Falsifikimi i dokumentave” në bashkëpunim dhe nga personi që ka për detyrë parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal dhe për këtë shkak e vlerëson të bazuar akuzën për këtë veprë penale.

Rezulton e provuar se e pandehura Blerina Dhrami (Brahimi), ka regjistruar të tre pasuritë e mësipërme në regjistrat publik pranë ZVRPP Vlorë. Regjistrimi i këtyre pasurive është kryer në kundërshtim me ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, si dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij. Provohet, se i pandehuri Raimond Mëzi, nuk ka aplikuar ndonjëherë për regjistrimin e dy vendimeve gjyqësore, por për regjistrimin e këtyre vendimeve gjyqësore është përdorur aplikimi i paraqitur nga shtetasi Nesti Bifsha, aplikim i cili nuk ka lidhje me pronën e regjistruar në favor të pandehurit Raimond Mëzi. Gjithashtu, rezulton se e pandehura Blerina Dhrami (Brahimi), ka regjistruar pronën në favor të pandehurit Lefter Gjergji, duke mos qenë specialiste e kësaj zone, si dhe nuk ekziston asnjë akt i shkruar apo ndonjë dokument i mbajtur për evidentimin e dokumenteve të dorëzuara nga specialisti Arlind Limaj tek e pandehura Blerina Dhrami (Brahimi). Nga të gjitha këto të dhëna, del qartë



se e pandehura Blerina Dhrami (Brahimi), kishte dijeni se dokumentet e paraqitura si titull pronësie për regjistrimin e pronës, ishin të falsifikuara, por në kundërshtim me ligjin ka regjistruar tre sipërfaqet e pronës objekt hetimi.

Me anë të këtyre dokumenteve të falsifikuara të futura në dosjen e vertetimit të faktit juridik me vendim gjyqësor nr. 1568, datë 02.10.2003, të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, si dhe dosjen e Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave nr. 115, datë 15.12.2005, në emër të subjektit Theotoq Gjergji, është regjistruar prona me titull pronësi të falsifikuar në ZVRPP Vlorë, në emër të trashëgimtarëve të shtetasit Theotoq Gjergji.

Nga dokumentet e administruara pranë ZVRPP Vlorë, rezulton se, për regjistrimin fillestar të kësaj prone ka aplikuar shtetasi Arben Ruçi dhe personi i "autorizuar" prej tij Faik Aruni, pa asnjë prokurë të administruar në praktikë. Nga këta shtetas është aplikuar dy herë në vitin 2011 pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, tek specialisti Arlind Limaj, për regjistrimin e pasurisë së mësipërme të njohur dhe kthyer mbi bazën e vendimit nr. 168, datë 19.06.2006, të Komisionit Vendor të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Vlorë, shtetasit Theotoq Gjergji. Aplikimet mbajnë numër 830, muaji 08/2011 dhe nr. 839, muaji 07/2011. Më pas, nga ZVRPP Vlorë mbi bazën e kopjes së vendimit nr. 168, datë 19.06.2006, të Komisionit Vendor të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Vlorë, shoqëruar me kopjen e planvendosjes së pronës, të derguara nga Agjencia e Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Tiranë me shkresat nr. 3776/1 prot., datë 18.08.2011 dhe nr. 3776/3 prot., datë 27.09.2011, është kryer regjistrimi i pasurisë së mësipërme me sipërfaqe 33 (tridhjetetë) Ha, me hipoteke nr. 84, datë 23.03.2012, zona kadastrale 2863, në emër të shtetasit Theotoq Gjergji. Rezulton se regjistrimi i kësaj pasurie është kryer prej shtetasës Blerina Dhrami (Brahimi), e cila nuk ka qenë specialiste që mbulonte zonën e Palasës, por zonën e Ujit të Ftohtë, Vlorë. Nuk ka asnjë akt të shkruar apo ndonjë dokument të mbajtur për evidentimin e dokumenteve të dorëzuara nga specialisti Arlind Limaj tek specialistja Blerina Dhrami (Brahimi). Shtetasi Arlind Limaj nuk ka shpjeguar rrethanat e marrjes dhe përpunimit të kësaj praktike nga specialistja Blerina Dhrami (Brahimi), kurse shtetasi Eduart Dervishaj, i cili ka qenë Regjistruar i Z.V.R.P.P. Vlorë deri në muajin dhjetor 2011, ka shpjeguar se nuk ka urdhëruar dhe as nuk është në dijeni të kalimit dhe përpunimit të kësaj praktike nga shtetasi Arlind Limaj tek shtetasja Blerina Dhrami (Brahimi), pasi kjo nuk lejohej.

Nga hetimet e kryera, rezulton se para aplikimit në ZVRPP Vlorë për regjistrimin fillestar të kësaj pasurie, Agjencia e Trajtimit të Pronave Tiranë, mbi bazën e kërkesës së shtetasit Arben Ruçi, me shkresën nr. 2146, prot. datë 25.07.2011, i ka dërguar këtij të fundit (Arben Ruçi) dokumentacionin e administruar në dosjen nr. 115, datë 15.12.2005, në emër të subjektit Theotoq Gjergji, të përbërë gjithësej nga 18 fletë. Kopja e këtij dokumentacioni, i cili është dorëzuar pranë ZVRPP Vlorë, është i përbërë nga 22 fletë, pra tre fletë me shumë sesa janë dërguar nga Agjencia e Trajtimit të Pronave shtetasit Arben Ruçi. Kjo rezulton nga shkresa dhe dokumentacioni bashkëlidhur saj, që ZVRPP Vlorë i ka dërguar për konfirmim Agjencisë së Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Tiranë me shkresën nr. 4511 prot., datë 29.07.2011. Këto dokumente kanë dalë nga ZVRPP Vlorë me nënshkrimin e specialistit Arlind Limaj.

Ajo në kundërshtim me detyrën e saj (pronat e rregjistruara në emër të Raimond Mëzi dhe Lefter Gjergji) kanë qenë jashtë zonës që ajo mbulonte si juriste në Z.V.R.P.P. Vlorë.

Për regjistrimet fillestare e kryera nuk ka pasur aplikim nga vetë pronarët ose përfaqësues të tyre me prokurë. Për aplikimin e pronave të Raimond Mëzi të cilat janë rregjistruar në datë 12.10.2012 në dosje është futur aplikimi i shtetasit Nesti Bifsha i datës 19.11.2012 që jo vetëm nuk ka lidhje me këtë pronë, por është hequr nga dosje e këtij shtetasi dhe mban një datë 38 ditë pas rregjistrimit të këtyre pronave.

Gjithashtu rezulton e provuar se e pandehura Blerina Dhrami (Brahimi), pasi ka regjistruar pasuritë e mësipërme në kundërshtim me ligjin dhe përmes përdorimit të dokumenteve të falsifikuara, ka pajisur të pandehurit Lefter Gjergji, Raimond Mëzi me dokumentet vertetim nga dokumentet hipotekorë, në të cilat është pasqyruar pronësia në emër të këtyre shtetasve. Mbi bazën e këtyre dokumenteve të lëshuara nga e pandehura Blerina Dhrami (Brahimi), dokumente në të cilat janë pasqyruar të dhënat e dokumenteve të falsifikuara, të pandehurit Lefter Gjergji dhe Raimond Mëzi kanë arritur ta ndajnë dhe më pas ta tjetërsojnë tek personat e tretë, pasurinë e përfituar me dokumente të falsifikuara.

Për rrjedhojë provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se e pandehura Blerina Dhrami (Brahimi) ka konsumuar elementët e veprave penale "Falsifikimi i dokumenteve", të kryer në bashkëpunim dhe nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin parashikuar nga nenet 186/3 e 25.

Bazuar në analizën e bërë më lart në lidhje me figurat e veprave penale dhe praktikën gjyqësore, Gjykata vlerëson se kjo e pandehur duhet të deklarohet e pafajshme për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës" për shkak se është i njëjti fakt penal që ajo është deklaruar fajtorë për veprën penale "Falsifikimi i dokumentave" nga personi që e ka për detyrë parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal.

Në lidhje me të pandehurën **Donika Besimaj** gjykata arrin në përfundimin se nuk provohet kryerja e veprës penale "Falsifikimi i dokumentave" nga ana e kësaj të pandehure.

Akuza ka arritur në përfundimin se:

"Bazuar në të dhënat e mësipërme rezulton e provuar se e pandehura Donika Besimaj, në bashkëpunim me të pandehurit Lefter Gjergji, Raimond Mëzi dhe Enkes Hysendhima, kanë falsifikuar aktet e tre dosjeve të mësipërme gjyqësore, duke i bërë pjesë të arkivës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Rezulton e provuar se dy dosjet gjyqësore me palë paditëse Raimond Mëzi, janë tërësisht të falsifikuara, dosje të cilat janë falsifikuar nga e pandehura Donika Besimaj në bashkëpunim me të pandehurit Raimond Mëzi dhe Enkes Hysendhima. Provohet se e pandehura Donika Besimaj, ka marrë fletëhirrje nga dosje të tjera të arshivuara në arkivën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të cilat i ka përdoruar për falsifikimin e këtyre dy dosjeve gjyqësore. Ndërsa në lidhje me dosjen gjyqësore me kërkues Theotoq Gjergji, provohet se janë falsifikuar provat dhe aktet e kësaj dosje, si dhe vendimi gjyqësor, dosje e cila ka qenë e administruar në arkivën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Gjithashtu rezulton se të tre vendimet gjyqësore të falsifikuara janë administruar prej të pandehurës Donika Besimaj në librin e numratorit të vendimeve, si dhe janë pasqyruar të dhënat e këtyre vendimeve në të gjitha regjistrat përkatës, të cilët ndodheshin të administruara në arkivën e Gjykatës së Rrethit

Gjyqësor Vlorë. Konkretisht janë pasqyruar të dhënat e këtyre dosjeve në Regjistrin Civil Themeltar, në Numratorin Civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në Indeks in e Vendimeve Civile të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, regjistra që ndodheshin të arkivuara në mjedise të ndryshme të arkivës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Gjithashtu provohet se dosjet gjyqësore të falsifikuara janë sistemuar dhe arkivuar në vendin përkatës ku ndodheshin dosjet gjyqësore që i përkisnin muajit dhjetor të vitit 2000 dhe muajit dhjetor të vitit 2003. Me këtë veprime, e pandehura Donika Besimaj ka konsumuar elementët e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Konkretisht këto veprime janë kryer në kundërshtim me ligjin nr. 8436, datë 28/12/1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 7381, datë 08/05/1990 “Për krijimin e Ministrisë së Drejtësisë”, si dhe nenit 23 të Urdhërit nr. 1830, datë 03/04/2001 të Ministrisë së Drejtësisë “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e administratës gjyqësore”, rregullore e cila ka dalë në zbatim të dy ligjeve të mësipërme. Gjithashtu rezultoi se pas falsifikimit të tre dosjeve të mësipërme gjyqësore, e pandehura Donika Besimaj, ka pajisur me kopje të njësuara të akteve të këtyre dosjeve dhe vendimeve gjyqësore përkatëse të pandehurit Lefter Gjergji, Raimond Mëzi dhe Enkes Hysendhima, duke i paraqitur këto dokumente sikur kanë dalë nga Arkiva e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Për rrjedhojë e pandehura Donika Besimaj, ka konsumuar edhe elementët e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve” të kryer më shumë se një herë dhe në bashkëpunim, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal. Sa mësipër provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se e pandehura Donika Besimaj ka konsumuar elementët e veprave penale “Falsifikimi i dokumenteve” të kryer më shumë se një herë dhe në bashkëpunim dhe “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga nenet 186/2 dhe 248 të Kodit Penal”.

Gjykata vlerëson se gjatë gjykimit faktet e pretenduara nga akuza në lidhje me veprën penale “Falsifikimi i dokumentave” parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal se ka falsifikuar dosjen gjyqësore që i përket vendimit gjyqësor civil nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, dosjen gjyqësore që i përket vendimit gjyqësor civil nr. 2217, datë 29/12/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, dosjen gjyqësore që i përket vendimit gjyqësor civil nr. 1568, datë 02.10.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë si dhe të ketë kryer shënimet përkatëse në regjistrat e Gjykatës apo të ketë pasur dijeni se ato kanë qenë të falsifikuara nuk rezultuan të provuara.

-Akuza nuk ka arritur të provojë faktin se kur janë kryer këto falsifikime dhe janë bërë pjesë e Arkivës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke patur parasysh se e pandehura Donika Besimaj ka filluar punë në fillim të vitit 2008.

-Nga akt ekspertimet përkatëse ka rezultuar konkluzioni kategorik se shënimet në regjistrat përkatës dhe gjithë dokumentat e falsifikuar nuk janë bërë prej të pandehurës ose familjarve të saj.

Gjithashtu nuk ka as indicje në lidhje me njohjet dhe bashkëpunimin e saj më të pandehurit e tjerë Raimond Mëzi dhe Lefter Gjergji.

Kjo e pandehur vetëm sa ka paisur me dokumentat që ndodhen në arkivë (kopje vendimi dhe dosje gjyqësore) të pandehurit Raimond Mëzi dhe Lefter Gjergji (ose persona të dërguar prej tyre)



Në këto rrethana Gjykata vlerëson se nuk provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se e pandehura Donika Besimaj ka falsifikuar dosjen gjyqësore që i përket vendimit gjyqësor civil nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, dosjen gjyqësore që i përket vendimit gjyqësor civil nr. 2217, datë 29/12/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, dosjen gjyqësore që i përket vendimit gjyqësor civil nr. 1568, datë 02.10.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë si dhe të ketë kryer shënimet përkatëse në rregjistrat e Gjykatës apo të ketë pasur dijeni se ato kanë qenë të falsifikuara

Në këtë gjykim Gjykata arrin në përfundimin se nuk ka prova të mjaftueshme për të konkluduar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se e pandehura Donika Besimaj ka konsumuar elementët e veprave penale "Falsifikimi i dokumentave" parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal dhe për këtë shkak akuza ndaj saj vlerësohet e dyshimtë.

K.Pr.Penale parashikon:

Neni 4

"1.I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formes së prerë.Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit.

2.Gjykata jep vendim fajësie kur i pandehuri rezulton fajtor për faktin penal që i atribuohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm".

Neni 390

Dënimi i të pandehurit

1. Kur fajësia e të pandehurit provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, gjykata jep vendim dënimi, duke caktuar llojin dhe masën e dënimit.

2. Gjykata nuk mund të bazojë vendimin e fajësisë vetëm mbi deklaratimet e bëra nga personi, i cili, me vullnetin e tij, nuk ka pranuar të pyetet nga i pandehuri ose nga mbrojtësi i tij në asnjërin nga fazat e procedimit.

3. Gjykata nuk mund të bazojë vendimin e fajësisë vetëm ose kryesisht në deklaratimet e bashkëtpandehurit, apo dëshmitë e marra nëpërmjet teknikave të veçanta për fshehjen e identitetit të dëshmitarit, sipas nenit 361/b të këtij Kodi".

Në rrethanat e përmendura më lart Gjykata vlerëson e pandehura duhet të deklarohet e pafajshme bazuar në nenin 388/1 të Kodit Procedurës Penale që parashikon:

"1.Gjykata merr vendim pafajësie kur;

d);nuk provohet se i pandehuri e ka kryer veprën që akuzohet".

Në lidhje me kryerjen e veprës penale "Shpërdorimi i detyrës" parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal ,gjykata vlerëson se në veprimet dhe mosveprimet e të pandehurës Donika Besimaj konstatohen elementët e kryerjes së kësaj vepre penale

Ashtu sikurse ka pohuar vetë e pandehura Donika Besimaj,ajo i dorëzonte çelesat e kësaj arshive pa inventar në kohën e Lejes se zakonshme(që,ku zevendesohet në këtë detyrë, pa kryer më parë inventar.

Gjithhashtu rezulton se e pandehura nuk ka përmbushuar detyrën funksionale në lidhje me mënyrën e administrimit të rregjistrave përkatës që ndodhen në arkivë,apo në kohën e marrjes së detyrës të ketë evidentuar parrgullsitë e këtyre dosjeve ,të cilat rezultojnë se kanë pasur mangësi në lidhje me dhënien e vendimit formë të prerë.Kopja e vendimit që është në dosjen gjyqësore me Nr.1568 datë 02.10.2003 nuk ka shënimin përkatës se vendimi ka marrë



formë të prerë dhe nga ana e të pandehurës nuk rezulton të ketë ndonjë shënim në lidhje me këtë fakt.

Llojin e dënimit të kërkuar nga organi i akuzës për të pandehurit që duhet të deklarohen fajtorë, gjykata e vlerëson të bazuar dhe në përputhje me nparashikimet e neneve 186/2, 186/3, 248 dhe 287/3 të Kodit Penal

Në lidhje me masat e dënimit gjykata mban parasysh:

Për të pandehurin Raimond Mëzi:

-Rrezikshmërinë e veprave penale të kryera prej tij,ku vepra penale e parashikuar nga neni 287/3 i Kodit Penal parashikon një masë të lartë dënimi.

-Rrezikshmërinë shoqërore të vetë të pandehurit ku rezulton i padënuar, rolin e tij në kryerjen e këtyre veprave penale duke patur parasysh mekanizmin e kryerjes së tyre.

-Kryerjen e veprës penale në bashkëpunim dhe më shume se një herë për veprën penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal dhe pasojën e rëndë për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal

-Faktin se falsifikimi është kryer në dokumentacionin e institucioneve të rëndësishme si Gjykata, Arkivi, K.K.K.Pronave ,Z.V.R.P.Paluaajtshme.

-Pasojat e ardhura nga vepra penale ku nëpërmjet dokumentave tërësisht të falsifikuara janë përfituar sipërfaqe të mëdha kullote në bregdet.

-Rrethanat ekonomike dhe familjare ku rezulton se ka një nivel të ulët arsimor.

-Qëndrimin e mbajtur gjatë hetimit dhe gjykimit të çështjes.

Për të pandehurin Lefter Gjergji:

-Rrezikshmërinë e veprave penale të kryera prej tij,ku vepra penale e parashikuar nga neni 287/3 i Kodit Penal parashikon një masë të lartë dënimi.

-Rrezikshmërinë shoqërore të vetë të pandehurit ku rezulton i padënuar, rolin e tij në kryerjen e këtyre veprave penale duke patur parasysh mekanizmin e kryerjes së tyre.

-Kryerjen e veprës penale në bashkëpunim dhe më shume se një herë për veprën penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal dhe pasojën e rëndë për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal

-Faktin se falsifikimi është kryer në dokumentacionin e institucioneve të rëndësishme si Gjykata, Arkivi, K.K.K.Pronave ,Z.V.R.P.Paluaajtshme.

-Pasojat e ardhura nga vepra penale ku nëpërmjet dokumentave tërësisht të falsifikuara janë përfituar sipërfaqe të mëdha kullote në bregdet.

-Rrethanat ekonomike dhe familjare ku rezulton se është me arsim të lartë.

-Qëndrimin mohues e mbajtur gjatë hetimit dhe gjykimit të çështjes.

Për të pandehurën Blerina Dhrami(Brahimi):

-Rrezikshmërinë e veprës penale të kryer prej saj.

-Rrezikshmërinë shoqërore të vetë të pandehurës ku rezulton i dënuar, rolin e saj në kryerjen e veprës penale duke patur parasysh mekanizmin e kryerjes së saj dhe faktin se e ka kryer duke shfrytëzuar detyrën si punonjëse e shtetit.

-Kryerjen e veprës penale në bashkëpunim dhe më shume se një herë për veprën penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal dhe pasojën e rëndë për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal

-Faktin se falsifikimi është kryer në dokumentacionin e institucioneve të rëndësishme si Gjykata, Arkivi, K.K.K.Pronave ,Z.V.R.P.Paluaajtshme.

-Pasojat e ardhura nga vepra penale ku nëpërmjet dokumentave tërësisht të falsifikuara janë përfituar sipërfaqe të mëdha kullote në bregdet.

-Rrethanat ekonomike dhe familjare ku rezulton se është me arsim të lartë.

- Faktin që i është shmangur hetimit dhe gjykimin të çështjes.

Për të pandehurën Donika Besimaj:

-Rrezikshmërinë e veprës penale të kryer prej saj.

-Rrezikshmërinë shoqërore të vetë të pandehurës ku rezulton e padënuar, rolin e saj në kryerjen e veprës penale duke patur parasysh mekanizmin e kryerjes së saj dhe faktin se me veprimet dhe mosveprimet e saj u ka krijuar mundësinë personave të tjerë të kryejnë falsifikimet në dokumentacionin e gjykatës.

-Pasojat e ardhura nga vepra penale ku nëpërmjet dokumentave tërësisht të falsifikuara janë përfituar sipërfaqe të mëdha kullote në bregdet.

-Rrethanat ekonomike dhe familjare ku rezulton se është në moshë relativisht të madhe.

-Qëndrimin e mbajtur gjatë hetimit dhe gjykimin të çështjes.

Gjykata vlerëson të bazuar dhe kërkimin e organit të akuzës për aplikimin e dënimit plotësues të parashikuar nga neni 35 i Kodit Penal ndaj të pandehurave Blerina Dhrami (Brahimi) dhe Donika Besimaj si dhe aplikimin e neni 36 të Kodit penal në lidhje me pasuritë e sekuestruara.

Gjykata vlerëson që për të pandehurën Donika Besimaj të aplikojë dënimin alternativ të parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal.

Neni 59 i K.Penal ,ndryshuar me ligjin 36/2017 (i cili ka hyrë në fuqi në datë 20.05.2017) parashikon:

Për shkak të rrezikshmërisë së paktë të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burg deri në pesë, vjet, mund të urdhëroj, që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale.

Gjykata urdhëron që i dënuari të përmbushë një apo më shumë detyrime, të parashikuara në nenin 60 të këtij Kodi.

Për dënimet e dhëna deri në dy vjet burgim ,të pezulluara nga gjykata,afati i provës është sa dyfishi i kohës së dënimit me burgim të dhënë nga gjykata.

Afati i provës ,më përjashtim të rregullit të parashikuar në paragrafiin 3 të këtij neni është 24 muaj deri në pesë vjet.Afati i provës fillon nga e nesërmja e shpalljes së vendimit të gjykatës që ka dhënë vendimin për pezullimin e dënimit me burgim”.

Kushtet qe parashikon neni 59 i Kodit Penal për aplikimin e pezullimit të dënimit janë taksative dhe kumulative. Gjykata ka kompetencën për të vlerësuar përfundimisht rrezikshmërinë e personit dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale.

Alternativat e dënimit me burgim mund të përkufizohen si: Sanksione penale të vendosura nga shteti, që konsistojnë në vuajtjen e dënimit me burgim në një mënyrë të ndryshme nga sistemi tradicional i qelisë, duke patur parasysh që për autorë dhe vepra me rrezikshmëri të ulët shoqërore, riedukimi dhe risocializimi I tyre do të ishte më efektiv në gjirin e komunitetit.

Është e rëndësishme të kuptohet thelbi i qëllimit të pezullimit, i cili nuk është dhënia e një privilegji për persona të caktuar, por si një mundësi që iu jepet personave që kanë kryer veprë penale, për ta kuptuar gabimin e tyre dhe këtë ta demonstrojnë me veprimet dhe sjelljen e tyre në komunitet.

Kjo mundësi qëndron në faktin që ndaj këtyre personave dënimi nuk ekzekutohet në mënyrën tradicionale, që do të sillte privimin e plotë të lirisë, por duke i kufizuar disa liri dhe të drejta dhe duke e lënë të lirë në komunitet, por në provë dhe nën mbikëqyrjen e organeve kompetente.

Ashtu si për parandalimin e përgjithshëm dhe për parandalimin e posaçëm të individit, metodat që janë përdorur për arritjen e këtij qëllimi kanë evoluar në raport me evoluimin e vetë shoqërisë. Ndërsa në fillim e vetmja metodë për të parandaluar personin që kishte kryer një veprë penale nga kryerja sërish e saj ishte ndëshkimi i tij, sot kjo metodë ka ndryshuar tërësisht.

Aktualisht fokusi kryesor i programeve të parandalimit të posaçëm i referohet aspekteve me karakter social, ku kujdesi më i madh i kushtohet personave të dënuar gjatë vuajtjes së dënimit dhe më pas. Sot sugjerohet që të bëhet një studim i hollësishëm i personalitetit të personit të dënuar në momentin që ai hyn në një institucion penitenciar në mënyrë që ai të trajtohet në mënyrë individuale, që të arrihen rezultate sa më konkrete dhe ky person të jetë sa më i përgatitur për një jetë në përputhje me normat ligjore në fuqi.

Duke iu kthyer rastit në shqyrtim gjykata çmon se ndodhemi përpara kushteve të parashikuara nga neni 59 i Kodit Penal dhe konkretisht:

Sipas nenit 59 të Kodit Penal kërkohet që i pandehuri të ketë rrezikshmëri të paket shoqërore. Ajo nuk rezulton i dënuar dhe me precedent të mëparshëm penalë.

Rezulton e provuar se e pandehura është në moshë 58 vjeç.

Gjendjen shëndetësore të të pandehurës ku rezulton e provuar se ka probleme shëndetësore të vazhdueshme.

Gjykata në caktimin e masës dhe llojit të dënimit merr parasysh dhe efektin që do të ketë ky dënim si në sjelljen e mëvonshme të të pandehurit ashtu dhe në efektin parandalues të këtij dënimi

Njëkohësisht Gjykata mban parasysh dhe faktin se gjykimi i kësaj çështje penale u zhvillua me procedurën për gjykimin e shkurtuar.

PËR KETO ARSYE

Gjykata në bazë të neneve 379,388 e 390 të K.Pr.Penale

VENDOSI

1.Deklarimin fajtor të të pandehurit **Raimond Mëzi** për kryerjen e veprës penale "Falsifikimi i dokumentave" kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë dhe në bazë të nenit 186/2 të Kodit Penal e dënon me 4(katër) vjet burgim.

- Deklarimin fajtor të të pandehurit **Raimond Mëzi** për kryerjen e veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” dhe në bazë të nenit 287/3 të Kodit Penal e dënon me 16(gjashtëmbëdhjetë) vjet burgim

-Në bazë të nenit 55 te Kodit Penal në bashkim të dënimeve i pandehuri **Raimond Mëzi** dënohet me 18(tetëmbëdhjetë) vjet burgim

-Në aplikim të nenit 406 te KPrP ulet 1/3 e dënimit dhe i pandehuri **Raimond Mëzi** dënohet përfundimisht me 12(dymbëdhjetë) vjet burgim

2.Deklarimin fajtor të të pandehurit **Lefter Gjergji** për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumentave” kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë dhe në bazë të nenit 186/2 të Kodit Penal e dënon me 4(katër) vjet burgim.

- Deklarimin fajtor të të pandehurit **Lefter Gjergji** për kryerjen e veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” dhe në bazë të nenit 287/3 të Kodit Penal e dënon me 16(gjashtëmbëdhjetë) vjet burgim

-Në bazë të nenit 55 te Kodit Penal në bashkim të dënimeve i pandehuri **Lefter Gjergji** dënohet me 18(tetëmbëdhjetë) vjet burgim

-Në aplikim të nenit 406 te KPrP ulet 1/3 e dënimit dhe i pandehuri **Lefter Gjergji** dënohet përfundimisht me 12(dymbëdhjetë) vjet burgim

3.Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Enkes Hysendhima** i akuzuar për kryerjen e veprave penale “Falsifikimi i dokumentave” kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” parashikuar përkatësisht nga nenet 186/2 dhe 287/3 të Kodit Penal,për shkak se nuk provohet se i ka kryer veprat penale për të cilën akuzohet.

4.Deklarimin fajtor të të pandehures **Blerina Dhrami (Brahimi)** për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumentave” kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë nga personi që ka për detyrë dhe në bazë të nenit 186/3 të Kodit Penal e dënon me 6(gjashtë) vjet burgim.

-Deklarimin e pafajshme të të pandehurës **Blerina Dhrami (Brahimi)** e akuzuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal,për shkak se fakti nuk përbën veprën penale për të cilën akuzohet.

-Në aplikim të nenit 406 te KPrP ulet 1/3 e dënimit dhe e pandehura **Blerina Dhrami (Brahimi)** dënohet përfundimisht me 4(katër) vjet burgim

-Në bazë të nenit 35 të Kodit Penal të pandehurës **Blerina Dhrami (Brahimi)** i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një periudhe prej 3(tre) vjet.

5.Deklarimin fajtor të të pandehures **Donika Besimaj** për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe në bazë të nenit 248 të Kodit Penal e dënon me 3(tre) vjet burgim.



-Deklarimin e pafajshme të të pandehurës **Donika Besimaj** e akuzuar për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumentave” kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal,për shkak se nuk provohet se e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

-Në aplikim të nenit 406 të KPrP ulet 1/3 e dënimit dhe e pandehura Donika Besimaj dënohet përfundimisht me 2 (dy) vjet burgim

-Në bazë të nenit 59 të Kodit penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim për të pandehurën Donika Besimaj për një afat 2 (dy) vjet.

-Urdhërohet e pandehura që gjatë kohës së provës të paraqitet në shërbimin e provës dhe të marrë pëlqimin për ndryshimin e vendbanimit apo lëvizjet e shpeshta brenda vendit.

-Në bazë të nenit 35 të Kodit Penal të pandehurës **Donika Besimaj** i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një periudhe prej 2(dy) vjet.


Vuajtja e dënimit për të pandehurit Raimond Mëzi dhe Lefter Gjergji fillon nga data e ndalimit të tyre dhe ekzekutimi i kohës së pavuajtur të dënimit të kryhet në një burg të sigurisësë zakonshme.

Për të pandehurën Blerina Dhrami vuajtja e dënimit për pjesën e pavuajtur fillon nga data e ekzekutimit dhe të kryhet në një institucion të posaçëm të vuajtjes së dënimit për gratë.

Në bazë të nenit 389 të K.Pr.Penale urdherohet heqja e masës së sigurimit “Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore” për të pandehurit Enkes Hysendhima dhe Donika Besimaj.

6.Në aplikim të neneve 190/1 dhe 391 të K.Pr.Penale, të deklarohet falsiteti i dokumenteve që i janë bashkuar fashikullit të gjykimin dhe të disponohet në lidhje me to, e konkretisht në lidhje me këto dokumente:

- Të gjitha aktet e dosjes gjyqësore civile që i përkasin vendimit nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, bashkë me vendimin, të cilat të asgjësohen.
- Vendimi gjyqësor civil nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i cili të asgjësohet.
- Të dhënat e pasqyruara në Regjistrin themeltar civil të vitit 2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në lidhje me vendimin nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Pas kryerjes së këtij veprimi, Regjistri themeltar civil i vitit 2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të kthehet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.
- Të dhënat e pasqyruara në numratorin e vendimeve civile të viteve 1999-2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në lidhje me vendimin nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Pas kryerjes së këtij veprimi, Numratori i vendimeve civile të viteve 1999-2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të kthehet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.



- Të dhënat e pasqyruara në Indeks in e vendimeve gjyqësore civile të viteve 1999-2000-2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në lidhje me vendimin nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Pas kryerjes së këtij veprimi Indeksi i vendimeve gjyqësore civile të viteve 1999-2000-2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të kthehet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.
- Të gjitha aktet e dosjes gjyqësore civile që i përkasin vendimit nr. 2217, datë 29/12/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, bashkë me vendimin, të cilat të asgjësohen.
- Të dhënat e pasqyruara në Regjistrin themeltar civil të vitit 2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në lidhje me vendimin nr. 2217, datë 29/12/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Pas kryerjes së këtij veprimi, Regjistri themeltar civil i vitit 2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të kthehet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.
- Të dhënat e pasqyruara në Regjistërin themeltar civil të vitit 2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në lidhje me vendimin nr. 2217, datë 29/12/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Pas kryerjes së këtij, veprimi Regjistri themeltar civil i vitit 2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të kthehet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.
- Të dhënat e pasqyruara në Numratorin civil të vitit 2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në lidhje me vendimin nr. 2217, datë 29/12/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Pas kryerjes së këtij veprimi, Numratori civil i vitit 2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të kthehet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.
- Të dhënat e pasqyruara në Volumin e vendimeve të vitit 2003 që fillon nga vendimi nr. 1500, datë 23/09/2003 deri në vendimin nr. 1600, datë 07/10/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në lidhje me vendimin nr. 1568, datë 02/10//2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Pas kryerjes së këtij veprimi, Volumi i vendimeve të vitit 2003 që fillon nga vendimi nr. 1500, datë 23/09/2003 deri në vendimin nr. 1600, datë 07/10/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të kthehet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.
- Të gjitha aktet e dosjes gjyqësore civile që i përkasin vendimit nr. 1568, datë 02/10//2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, bashkë me vendimin, të cilat të asgjësohen.
- Të gjitha aktet dhe praktikën në lidhje me dhënien e vendimit nr. 168, datë 14/06/2006 të KVKKPronave Qarku Vlorë në emër të subjektit Theotoq Gjergji, të cilat të asgjësohen.
- Të dhënat e pasqyruara në regjistrat publik pranë ZVRPP Vlorë, mbi bazën e vendimit nr. 1360, datë 29/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
- Të dhënat e pasqyruara në regjistrat publik pranë ZVRPP Vlorë, mbi bazën e vendimit gjyqësor nr. 2217, datë 29/12/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

- Të dhënat e pasqyruara në regjistrat publik pranë ZVRPP Vlorë, mbi bazën e vendimit gjyqësor nr. 1568, datë 02/10/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

7. Në bazë të nenit 36/b të Kodit Penal, të konsfiskohen dhe të kalojnë në favor të shtetit dhe të fshihen nga regjistri i ZVRPP Vlorë, produktet e veprës penale të "Falsifikimit të dokumenteve", të cilat janë nën masën e sigurimit të sekuestros preventive me vendimin nr.257, datë 30/01/2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, e konkretisht të:

- Pasurisë së paluajtshme prej 220 (dyqind e njëzet) Ha, të regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 421, datë 12/10/2012, ZK 1568, në emër të shtetasit Rajmond Mezi, me përshkrimin "Një sipërfaqe kullotë prej 220 ha, në vendin Karaburun sipas kufinjëve", me kufij V-Deji; J-Qafa e Gjeshtës; P-Përroi i Dhimë Kushtës dhe L-Udha, si dhe të të gjitha pasurive të paluajtshme të ndara dhe derivuara nga kjo pasuri e mësipërme dhe të cilat janë regjistruar në regjistrin hipotekor pranë ZVRPP Vlorë.

- Pasinë e paluajtshme prej 89 (tetëdhjetë e nëntë) Ha, të regjistruar në regjistrat publike të ZVRPP Vlorë, mbi bazën e vendimit gjyqësor të falsifikuar nr. 2217, datë 29/12/2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, si dhe të të gjitha pasurive të tjera të paluajtshme të regjistruara pranë ZVRPP Vlorë që rrjedhin prej pasurisë prej 89 Ha, që mund të kenë kaluar në emër të personave të tretë.

- Pasuritë e paluajtshme të llojit "kullotë" me sipërfaqe totale prej 33 (tridhjetetë) hektarë, ndodhur në zonën kadastrale nr. 2863, në vendin e quajtur "Dhrale – Adhendra", në fshatin Palase, Himarë, të regjistruara në nenin 84, dt. 23.03.2012, të regjistrin hipotekor të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Paluajtshme Vlorë, me titull pronësie "Vendimin nr. 168, datë 14.06.2006, të Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Qarkut Vlorë", si dhe të gjitha pasuritë që rrjedhin/derivojnë prej kësaj pasurie dhe që janë regjistruara në regjistrat hipotekor të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Paluajtshme Vlorë.

8-Në aplikim të nenit 190 dhe 224 të K.Pr.Penale, regjistrimet e kryera për numrin telefonik 067 20 60 444; numrin telefonik 069 58 64 034, numrin telefonik 069 64 60 624, numrin telefonik 067 20 66 666, numrin telefonik 069 75 75 975, numrin telefonik 069 68 23 125, numrin telefonik 069 86 82 975 dhe numrin telefonik 069 96 63 394, të vendosur në përgjim me vendimin nr. 70 datë 24/05/2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të asgjësohen, pasi vendimi të marrë formë të prerë.

- Në aplikim të nenit 190 dhe 224 të K.Pr.Penale, regjistrimet e kryera për numrin telefonik 069 47 58 570, të vendosur në përgjim me vendimin nr. 54 datë 29/04/2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të asgjësohen, pasi vendimi të marrë formë të prerë.

- Në aplikim të nenit 190 dhe 224 të K.Pr.Penale, regjistrimet e kryera për numrin telefonik 069 26 83 730, të vendosur në përgjim me vendimin nr. 56 datë 05/05/2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të asgjësohen, pasi vendimi të marrë formë të prerë.

-Në aplikim të nenit 190 dhe 224 të K.Pr.Penale, regjistrimet e kryera për numrin telefonik 069 26 83 730, të vendosur në përgjim me vendimin nr. 66 datë 19/05/2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të asgjësohen, pasi vendimi të marrë formë të prerë.

-Në aplikim të nenit 190 dhe 224 të K.Pr.Penale, regjistrimet e kryera për numrin telefonik 069 91 07 123 dhe për numrin telefonik 069 53 39 365, të vendosur në përgjim me vendimin nr. 59 datë 11/05/2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të asgjësohen, pasi vendimi të marrë formë të prerë.

-Në aplikim të nenit 190 dhe 224 të K.Pr.Penale, regjistrimet e kryera për numrin telefonik 069 48 77 305, të vendosur në përgjim me vendimin nr. 61 datë 12/05/2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të asgjësohen, pasi vendimi të marrë formë të prerë.

-Shpenzimet gjyqesore në ngarkim të të pandehurve.

-Kundër këtij vendimi mund të bëhet apelim në Gjykatën e Apelit Vlorë brenda 15 ditëve nga e nesërmja e shpalljes

U shpall në Vlorë më datë 27.03.2018.

GJYQATAR
LAURENT FUÇIA

Laurent Fuçia

GJYQATAR
ARBANA SELMANAJ

Arbana Selmanaj

GJYQATAR
ALBERT SPIRO

Albert Spiro

SEKRETARE
XHULJETA DINAJ

Xhuljeta Dinaj